



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit
Fier**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR
I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË
NË DREJTORINË E UJTJES DHE KULLIMIT FIER**

TIRANË, SHKURT 2026

	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	1-6
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit	
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	8-10
2.	Identifikimi i çështjes	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve	
5.	Kriteret e vlerësimit	
6.	Standardet e auditimit	
7.	Metodat e auditimit	
8.	Dokumentimi i auditimit	
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	10-10
2	-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:	
2.1	Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm.	11-13
2.2	Mbi zbatimin nga ana e Drejtorisë së Kullimit dhe Ujitjes, të detyrave, rregullave dhe kriterëve teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit.	13-17
2.3	Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, si dhe administrimi i vlerave materiale dhe monetare.	17-55
2.4.a	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta.	55-96
2.4.b	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të vogla	96-101
2.4.c	Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve.	101-122
IV	REKOMANDIME	123-133

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit.

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 98%, ku realizimin më të lartë e ka shpenzime për paga dhe sigurime, kapitale të trupëzuara, dhe 606 “ndihma në raste fatkeqësie dhe shpërblime”. Vihet re se për vitin 2024 art. (602) paraqiten 95%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier (Këtu e në vijim DUK Fier), është krijuar me VKM Nr. 437, datë 17.05.2017, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe kullimit Fier, Durrës, Fier dhe Korçë”. Këto struktura më parë ishin të organizuara si Borde Rajonale të Kullimit.

DUK Fier është strukturë në varësi të “Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” dhe financohen nga buxheti i shtetit, i miratuar për këtë ministri. Drejtor i DUK Fier është z. Th. S.. Zonat e shërbimit që përfshin Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier janë qarqet: Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Strukturat dhe organikat e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit miratohen nga Kryeministri.

Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, miratohen nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit Fier janë:

-Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në administrim të saj, brenda zonës përkatëse të shërbimit, në mënyrë që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit, si dhe të parandalojë përmbytjen.

- Drejtoria e Ujitjes dhe e Kullimit: a) pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitës; b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit (hidrovoret); c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja; ç) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe, kur është e nevojshme, kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre; d) merr masa specifike në rast përmbytjeje dhe thatësire të zgjatur; dh) merr masa për zbatimin e planit periodik dhe të azhurnuar të emergjencave nga përmbytja; e) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të; ë) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet.

Për vitin 2024 DUK Fier ka një buxhet të planifikuar në vlerën 612,463,151 lekë dhe të realizuar në vlerën 601,666,990 lekë, ose në masën 98%. Vlerën më të madhë të shpenzimeve buxhetor vjetore e zë zëri i investimeve (Ilog. 231), në vlerën 264,277,162 lekë, Ilog. 602 shpenzime operative në vlerën 191,022,956 lekë, Ilog. 600 paga në vlerën 124,697,872 lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

DUK Fier është institucion i rëndësishëm, pasi shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në administrim të saj, brenda zonës përkatëse të shërbimit. Për plotësimin e këtij qëllimi pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitës; shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit (hidrovorët); rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja;

mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja, etj. Nga vetë rëndësia që ka institucioni i DUK Fier, të cilat rrjedhin prej detyrave dhe përgjegjësi që ka, rrjedh edhe rëndësia që ka për Kontrollin e Lartë të Shtetit auditimi i këtij institucioni, me qëllim përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë së këtij institucioni, me kuadrin ligjor në fuqi, mbi të cilin zhvillon veprimtarinë, përmbushjen e detyrimeve ligjore të institucionit, evidentimin e parregullsive dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre, etj.

c. Qëllimi i auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi DUK Fier për periudhën prej 01.01.2024 deri më 30.06.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve të veprimtarisë kryesore, sipas programit të auditimit.

Qëllimi i këtij auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2024 deri më 30.06.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer mbi baze risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat si: verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem etj. Siguria e arsyeshme e auditimit ka ardhur kryesisht si rezultat i testeve thelbësore (punës mbi dokumentacion), edhe për arsye se institucioni ka shumë vite i pa audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe risku vlerësohet në nivelin mesatar.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve. Janë formuluar 12 gjetje dhe 16 rekomandime për masa organizative, 5 gjetje dhe rekomandime për shpërbllim dëmi në vlerën **1,161,114 lekë pa TVSH**.

2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

a-Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Planet e veprimit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve të ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmytjet, digave, hidrovoreve dhe makinerisë së rëndë nuk parashikonin qartë punimet, verifikimet dhe grafikun e kryerjes. Informacionet e sektorëve për ndjekjen e punimeve dhe mirëmbajtjeve ishin të përgjithshme, pa specifikime dhe detaje teknike dhe pa përpilimin e akteve të kontrollit.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtje e kanalit në dalje të hidrovorit nr. 3, Darzezë, Fier”, zhvilluar në vitin 2024, me fond limit 28,745,937 lekë, u konstatua se në kriteret e veçanta për kualifikim, seksioni i licencave profesionale, për realizimin e punimeve është kërkuar licenca N.P-9-B “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime” dhe licenca N.P-9-B “Punime topogjeodezike”, të cilat i përkasin vlerave të punimeve prej 21 deri në 50 milion lekë, duke u tejkualuar vlera e punimeve që parashikohen në preventiv lidhur me zërat për të cilat janë të nevojshme këto 2 licenca.

- E njëjta situatë është konstatuar edhe në procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi i Kalasë (Kaskada e Shelegarit)”, me fond limit 43,300,377 lekë, zhvilluar në vitin 2024, ku janë kërkuar tre licencave të kategorisë B (N.P-9-B “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime”, N.S-9-B “Punime Strukturore speciale”, N.S-18-B “Punime topogjeodezike”, niveli i të cilave tejkalon vlerën reale të punimeve të cilat lidhen me nevojën për këtë lloj licence

- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier administron dhe ka të evidentuara në pasqyrat financiare, llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 18 asete, si zyrat, ofiçinat, hidrovorët etj., të cilat nuk

janë të pajisura me çertifikatë pronësie, pasi për këto pasuri nuk janë marrë masa për regjistrimin e tyre në ASHK, në emër të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në pasqyrat financiare të vitit 2024 ka vlerën 38,730,520 lekë dhe përfshin garancitë e ngurtësuara të punimeve prej 5%. Për 6 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, për vlerën e garancisë së punimeve prej 6,601,936 lekë, ende nuk është bërë kalimi i fondeve nga llogaria e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier në llogarinë e kontraktorit.

- Llogaria 600 “Shpenzime personeli dhe shpërblime”, në ditarët e pagave dhe në pasqyrën e performancës financiare ka vlerën 127,349,819 lekë, ndërsa vlera vjetore e kësaj llogarie në sistemin e tatimeve (e-filling) është raportuar në vlerën 125,525,874 lekë, me diferencë midis tyre prej 1,823,945 lekë. Ky fenomen është edhe në llogarinë 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, e cila në ditarët e pagave dhe pasqyrat financiare ka vlerën 19,349,269 lekë, ndërsa në sistemin e tatimeve (e-filling) është raportuar në vlerën 21,015,389 lekë, me diferencë midis tyre prej 1,666,120 lekë.

- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” është e mbivlerësuar në vlerën 89,455,493 lekë, llogaria 215 “Mjete transporti”, është mbivlerësuar në vlerën 1,216,118 lekë, pasi për këto llogari janë aplikuar normat e amortizimit 5% në vend të normës 20%.

- Gjendja e magazinës së materialeve sipas inventarit fizik të bërë në fund të vitit 2024 dhe librave të magazinës është në vlerën 13,349,029 lekë, ndërsa gjendja e llogarisë 31 “Materiale” në pasqyrat financiare është në vlerën 15,349,029 lekë. Pra llogaria e materialeve në pasqyrat financiare është mbivlerësuar me një vlerë prej 2,000,000 lekë, duke krijuar mos përputhje midis tyre.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatua se në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për argumentimin e kriterëve të kapacitetit teknik, lidhur me numrin e punonjësve, profesionet përkatëse të tyre, numrin dhe llojin e makinerive, etj., janë dhënë argumentime ligjore, por jo argumentime teknike.

- Nga auditimi i projekteve të zbatimit në 8 (tetë) raste, me qëllim kontrollin e projektit për përputhshmërinë me detyrën e projektimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet dhe legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, nuk është kryer oponente teknike

b. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

- Nga grupet e kontrollit dhe inspektimit në teren mbi gjendjen e objekteve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, të merren masa që të hartohen raporte mbi gjendjen e objekteve nga përmytjet, ku të përshkruhet situata, masat e marra dhe rekomandime për përmirësime të situatës.

- Njësia e prokurimit të marrë masa që në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim të dokumenteve të tenderit, seksioni i licencave profesionale për realizimin e punimeve, vendosja e kërkesave për licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, të bëhet në përputhje me vlerën e zërit të punimeve që lidhet drejtpërdrejtë me licencën profesionale të kërkuar, sipas preventivit të punimeve dhe jo mbi bazën e vlerës totale të tenderit.

- Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për regjistrimin në ASHK dhe paisjen me çertifikatë pronësie, hartë treguese, kartelë pasurie në emër të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, të 18 aseteve të llojit ndërtesa, zyra, ofcina, hidrovore, etj.

- Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për njoftimin e 6 operatorëve ekonomikë, me qëllim paraqitjen prej tyre të dokumentacionit të nevojshëm për të bërë të mundur kalimin e fondeve të ngurtësuara të garancisë së punimeve prej 6,601,936 lekë, nga llogaria e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier në llogarinë e kontraktorve.
- Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, nëpërmjet korigjimeve të normave të amortizimit të aplikuara gabim në vitet e mëparshme, si dhe në vijim të aplikojë normat e duhura të amortizimit për këto llogari.
- Njësia e prokurimit, në procesverbalin e mbajtur për argumentimin e kriterëve për kualifikimin e operatorëve ekonomik, të dokumentoj argumentimin teknik të kriterëve të vendosura, duke shpjeguar arsyen e numrit të punonjësve të kërkuar, specialitet e kërkuara, lidhjen e kriterit me zërin përkatës të preventivit, grafikun dhe volumin e punimeve, kapacitetin mbajtës të mjeteve, etj.
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa që për të gjitha projektet e ndërtimit të objekteve publike, të kryej oponentin teknik pranë instituteve shtetërore, ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria përkatëse që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, me qëllim për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi dhe në përputhje me rregullat teknike të ndërtimit.

3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë, i kualifikuar.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, për periudhën janar 2024-qershor 2025 dhe në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar disa parregullsi, të përshkruara në paragraf. e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, situatë e cila justifikon dhënien e një opinionit të **kualifikuar**¹.

Baza për dhënien e opinionit:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesve”, pjesë e raportit të auditimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionit. Opinioni mbështetet mbi parregullsitë e konstatuara si vijon:

- Planet e veprimit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve të ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmytjet, digave, hidrovorve dhe makinerisë së rëndë, nuk parashikonin qartë punimet, verifikimet dhe grafikun e kryerjes. Informacionet e sektorëve për ndjekjen e punimeve dhe

¹SNA-705-Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

mirëmbajtjeve ishin të përgjithshme, pa specifikime dhe detaje teknike dhe pa përpilimin e akteve të kontrollit.

- Në dy procedura prokurimi u konstatua se në kriteret e veçanta për kualifikim, seksioni i licencave profesionale, për realizimin e punimeve janë kërkuar, respektivisht në një të procedurë dy dhe në procedurën tjetër tre licenca profesionale, niveli i të cilave tejkalon vlerën reale të punimeve që parashikohen në preventiv, lidhur me zërat për të cilat janë të nevojshme këto licenca, duke sjellë mos përputhja të nivelit të licencave të kërkuara me vlerën e zërave të punimeve në preventiv.

-Në procedurat e prokurimit publik, u konstatuan se në procesverbalin e mbajtur për argumentimin e kriterëve, për kapacitetin teknik janë dhënë argumentimet ligjore, por jo ato teknike.

- Nga auditimi i projekteve të zbatimit, në tetë raste, me qëllim kontrollin e projektit për përputhshmërinë me detyrën e projektimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet dhe legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, nga Autoriteti Kontrakt, nuk është kryer oponenta teknike.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, në pesë raste kanë rezultuar punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën 1,161,114 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 714/2, datë 03.07.2025, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 04.07.2025 deri më datë 26.11.2025, në subjektin DUK Fier u krye Auditimi i Përputhshmërisë, i cili mbuloi periudhën prej 01.01.2024 deri më 30.06.2025.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

- 1.B. M., (Përgjegjës Grupi);
- 2.S. M., auditues;
- 3.E. Ç., auditues;
- 4.E. K., auditues;
- 5.Q. M., auditues.
- 6.B. Sh., auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Në auditimin e përputhshmërisë **objektivi** është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

Qëllimi i auditimit: Të vlerësohen dhe evidentohen shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si dhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve; dhënia e rekomandimeve për përmirësime të punës.

Identifikimi i çështjes: Sipas veprimtarisë së subjektit, janë vlerësuar fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimit e auditimit, të miratuara në programin e auditimit, si më poshtë:

Vlerësimi i nivelit të implementimit të pesë komponentëve të MFK;

Mbi zbatimin e detyrave, rregullave dhe kritereve teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit.

Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, si dhe administrimi i vlerave materiale dhe monetare.

Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i DUK Fier është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, administrimi i vlerave materiale dhe monetare, zbatimin e detyrave, rregullave dhe kritereve teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimin e kontratave të punimeve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, etj.

Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme, e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë që auditohet) dhe kryesisht:

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.152, datë 30.5.2013 “ Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.24/2017 “Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit”;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 437, datë 17.5.2017 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Fier, Durrës, Fier dhe Korçë”;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi page të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.
- VKM nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr.12, datë 30.12.2019 i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”.
- Udhëzim i MFE Nr.7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. i ndryshuar”.
- Udhëzimi nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore".
- Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; i ndryshuar.
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit Fier”;
- Akte të tjera ligjore/nënligjore në funksion të institucionit.

Standardet e auditimit të aplikuar: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit IFAC;

Metodat e auditimit: Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Auditimi është kryer me zgjedhje, bazuar në rrishtun e vlerësuar.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (rreth në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga testet e kontrolleve, ose procedurat thelbësore të cilat përfshijnë testet e detajeve dhe procedurat analitike). Metodat kryesore të auditimit që u përdorën: ri performanca, kërkimi i të dhënave nëpërmjet pyetësorëve, intervistimet, llogaritjet (kontrollet aritmetike të shumave), inspektimi (ekzaminimi i dokumentacionit financiar, fatura, regjistrime dhe dokumente etj.), konfirmim nga të tretët, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

Dokumentimi i auditimit: Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar dokumentet standarde deri në këtë fazë të auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier (Këtu e në vijim DUK Fier), është krijuar me VKM Nr. 437, datë 17.05.2017, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe kullimit Fier, Durrës, Fier dhe Korçë”. Këto struktura më parë ishin të organizuara si Borde Rajonale të Kullimit.

DUK Fier është strukturë në varësi të “Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” dhe financohen nga buxheti i shtetit, i miratuar për këtë ministri. Drejtor i DUK Fier është z. Th. S.. Zonat e shërbimit që përfshin Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier janë qarqet: Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Strukturat dhe organikat e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit miratohen nga Kryeministri.

Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, miratohen nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit Fier janë:

-Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja në administrim të saj, brenda zonës përkatëse të shërbimit, në mënyrë që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit, si dhe të parandalojë përmbytjen.

- Drejtoria e Ujitjes dhe e Kullimit: a) pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitës; b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit (hidrovoret); c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja; ç) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe, kur është e nevojshme, kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre; d) merr masa specifike në rast përmbytjeje dhe thatësire të zgjatur; dh) merr masa për zbatimin e planit periodik dhe të azhurnuar të emergjencave nga përmbytja; e) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të; ë) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet.

DUK Fier për vitin 2024 ka një buxhet vjetor prej 601,666,990 lekë, prej të cilit 143 milion lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime, 191 milion lekë shpenzime operative, 264 milion lekë shpenzime për investime, të cilat zënë rreth 44% të totalit të shpenzimeve.

-Struktura e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier është e përbërë nga Drejtori i Drejtorisë, Sektori Financës dhe Shërbimeve 5 punonjës, Sektori Teknik Fier 7, Sektori teknik Lushnje 34, Sektori Teknik Vlorë-Sarandë 43, Sektori Teknik Gjirokastrë 4, Sektori i Hidrovor-Makinerve 48, i cili ka edhe numrin më të lartë të punonjësve. Numri total sipas strukturës të miratuar për vitin 2024 është 142 punonjës.

2-Përshkrimi sipas drejtimit të auditimit.

2.1. Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm.

Ky auditim u krye për të verifikuar nëse janë zbatuar parimet, kriteret, rregullat, në zbatim ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaria dhe kontrollet, kanë ndikuar në planifikimin dhe përdorimin i burimeve financiare duke bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si

dhe në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Më poshtë rendisim punën e bërë nga ky Institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të Institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”.

Në lidhje me parimet 1-6,

Institucioni ka hartuar rregulloren e brendshme, e cila ndër të tjera përcakton strukturën organizative, funksionet dhe raportet hierarkike të drejtuesve e sektorëve, rregullat e bashkëpunimit ndërmjet njësive administrative, disiplinën e punës, procedurat e brendshme të komunikimit dhe administrimit dokumentar, si dhe kriteret, përgjegjësitë dhe detyrat funksionale të drejtuesve dhe punonjësve të institucionit.

Sa i përket vlerësimit periodik nuk është kryer vlerësim periodik duke qene se marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës dhe për rrjedhojë nuk është e parashikuar vlerësim periodik i punonjësve. Komisioni i etikës ngrihet sipas rastit.

Rregullorja e brendshme përcakton rolin mbikëqyrës të NA dhe vijat e raportimit; ka plan-veprim MFK dhe raporte periodike/vjetore buxhetore të dërguara në MFE.

Struktura është miratuar dhe përditësuar me përshkrime pune pa mbivendosje dhe me organigramë të publikuar. Objektivat dhe detyrat përcaktohen në nivele drejtorie, nivel sektori dhe funksionojnë raportimet vertikale/horizontale.

Vlerësimet e performancës kryhen rregullisht, dosjet e personelit janë të plota dhe rekrutimet ndjekin nevojat vjetore. Megjithatë, mungon një program strategjik e vjetor trajnimesh me buxhet të dedikuar.

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”.

Në lidhje me parimet 7-9.

Është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut 2024–2026 dhe Regjistrin e Risqeve 2024; janë përcaktuar rolet: Titullari dhe Koordinatori i Riskut, bashkërendimi dhe raportimi, si dhe grupet menaxhuese që identifikojnë, vlerësojnë dhe konsolidojnë risqet me plan-masa, të cilat shqyrtohen në GMS. Parashikohet monitorim periodik dhe mbledhje të rregullta me përgjegjësit për zbatim.

Pavarësisht kornizës së përgjithshme të riskut, nuk është zhvilluar vlerësim i posaçëm i riskut të mashtrimit dhe mungojnë politika/procedura anti-mashtrim (anti-fraud, anti-korrupsion), si dhe evidenca e monitorimit nga niveli i lartë. Në Rregulloren e Brendshme nuk janë të inkuorporuara detyrat e Koordinatorit të Riskut dhe të grupit të riskut, gjë që e dobëson formalizimin e komponentit.

Ndryshimet organizative, menaxheriale adresohen me përditësim dokumentacioni, caktim zëvendësuesish dhe udhëzime për marrjen e funksioneve. Kjo ruan vijimësinë operacionale dhe koherencën me rregullat e brendshme, duke kufizuar efektet e pasigurta në sistemin e kontrollit.

Komponenti “Aktivitetet e Kontrollit”.

Parimet 10-12.

Cikli financiar operon me ndarje funksionesh: angazhimet dhe urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ; kontrolli paraprak dokumentar kryhet nga financa (specialist përgjegjës sektori drejtor), më pas autorizimet dhe ekzekutimi bëhen në AFMIS me nënshkrime elektronike, NA, NZ, nëpërmjet Thesarit.

Prokurimet administrohen nga komisione të posaçme (fondi limit, specifikime, Vlerësimi i Ofertave, blerje të vogla, marrje në dorëzim mallrash), si dhe me regjistër vjetor prokurimesh dhe dosje të plota procedurash (gjurmë auditimi). Aktivitetet menaxhohen sipas kuadrit ligjor me regjistër dhe Excel; inventarizimi bëhet çdo vit me urdhra komisionesh dhe dokumentim shoqëruar. Shpenzimet kufizohen me limite mujore dhe kryhen rakordime periodike me Thesarin/bankat.

Në rregullore ndahen qartë detyrat dhe përgjegjësitë në të katër fazat e transaksionit (hartim-miratim-zbatim-monitorim). Kontrolli i integritetit të të dhënave financiare kryhet në nivele (kontabilizime, ditarë, PF, rakordime, listë-pagesa, urdhër-shpenzime) dhe verifikohet nga drejtuesit; PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Për investimet, funksionet e vlerësimit, kostimit, monitorimit mbulohen nga Drejtoria e Buxhetit, por procedurat operative të shkruara mungojnë.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”.

Parimet 13-15

DUK Fier siguron informacion financiar dhe operacional përmes raportimeve periodike 4-mujore dhe vjetore të buxhetit që dërgohen në MFE, si dhe analizave të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt fondeve të planifikuara. Procesi financiar zhvillohet përmes sistemit AFMIS, ku urdhër-shpenzimet miratohen elektronikisht nga, NZ, NA dhe ndërsa kontabilizimet kryhen në sistem. Transaksionet regjistrohen në SIFQ dhe rakordohen me Drejtorinë e Thesarit.

Komunikimi i brendshëm zhvillohet në mënyrë të kombinuar: elektronikisht (e-mail zyrtar, sistemet financiare dhe tabela Excel), me shkresa zyrtare dhe takime periodike. Evidencat e të ardhurave dhe shpenzimeve rakordohen çdo muaj me degën e Thesarit, sipas udhëzimeve standarde të MFE. Raportimi vertikal funksionon përmes informacioneve mujore që drejtorët e sektorëve përcjellin te Titullari, duke mundësuar analizë të vazhdueshme mbi realizimin financiar dhe operacional. Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar mënyrat e informimit dhe qarkullimit të dokumentacionit.

Komponenti. “Monitorimi”

Parimi 16

Monitorimi në DUK Fier realizohet përmes raportimeve periodike, mujore, tremujore, vjetore) dhe takimeve të rregullta ndërmjet titullarit dhe drejtuesve, në përputhje me planet e punës.

2.2.Mbi zbatimin nga ana e Drejtorisë së Kullimit dhe Ujitjes, të detyrave, rregullave dhe kritereve teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit, ju referuam dokumentacioni si më poshtë:

- Rregulloret e DUK
- Dokumentet e hartuara, shkresat përcjellëse, relacionet për mirëmbajtjen dhe funksionimit e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.
- Dokumente të tjera.

Me shkresën nr. 397 Prot., datë 09.08.2019, drejtori i DUK Fier ka dërguar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, rregulloren e integruar për miratim.

Më datë 14.10.2019, Ministri ka aprovuar rregulloren për organizimin dhe funksionimin e DUK Fier.

Më datë 30.12.2019, Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka aprovuar Udhëzimin nr. 12, “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”, ku janë detajuar procese të ndryshme mirëmbajtje dhe shërbimit.

Në lidhje me rregulloren e miratuar si dhe me Udhëzimin nr. 12, detyrat, rregulloret, standardet teknike të përcaktuar për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit janë të fokusuara në zërat që vijon si më poshtë.

Qëllimi i mirëmbajtjes është mbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja në kushte të përshtatshme të operimit, për rritjen e jetëgjatësisë së përdorimit të tyre, me kosto më të ulët të mundshme, pasi, pa një nivel të përshtatshëm të mirëmbajtjes, kjo infrastrukturë do të dëmtohet, operimi do të bëhet më i vështirë dhe do të kemi më pak ujë për ujitje, më pak mundësi për largimin e ujërave të kullimit dhe përmbytje më të shpeshta, me ndikim në uljen e prodhimeve bujqësore dhe të ardhurave të fermerëve.

Mirëmbajtja klasifikohet në 5 kategori kryesore:

- a) Mirëmbajtja rutinë (e përditshme) që përfshin punime të vogla të mirëmbajtjes, që duhen bërë çdo ditë mbi bazën e rregullave të caktuara.
- b) Mirëmbajtja periodike, përfshin punime mirëmbajtje të një shkalle të vogël, shpesh parandaluese, që nuk shfaqin ndonjë rrezikshmëri të lartë.
- c) Mirëmbajtja vjetore, përfshin punime të planifikuara si rezultat i inspektimeve/kontrolleve të kryera më parë, të cilat janë të konsiderueshme (punime të mëdha dhe që kërkojnë kohë për t’u realizuar).
- d) Mirëmbajtja emergjente, ka të bëjë me punime, që nuk mund të planifikohen.
- e) Mirëmbajtja e diferencuar, apo në pritje të krijimit të kushteve për t’u realizuar.

Cikli i mirëmbajtjes përbëhet nga:

- a) inspektimi i infrastrukturës/objekteve;
- b) matje e volumit të punimeve;
- c) preventivimi/kostimi i punimeve;
- d) përcaktimi i buxhetit;
- e) prioritetizimi i ndërhyrjeve të mirëmbajtjes;
- f) planifikimi i ndërhyrjeve prioritare për buxhetin disponibël;
- g) kontraktimi;
- h) kryerja e punimeve;
- i) mbikëqyrja e realizimit të punimeve;
- j) kolaudimi dhe marrja në dorëzim;
- k) pagimi i punimeve të kryera.

Në nenin 5 të rregullores së Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit Fier përcaktohen detyrat funksionale si vijon:

Detyrat e Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit, brenda zonës së vet të shërbimit:

1. Vënien në gatishmëri të infrastrukturës ujitëse, kulluese, hidrovoreve, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, sipas përcaktimeve të nenit 4;
2. Shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit, digat dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja, që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt, të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe të parandalojë përmbytjen;

3. Me fondet vjetore (shpenzime dhe investime), të planifikuara për infrastrukturën ujitëse, kulluese dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja, në administrim:
- a) pastron dhe mirëmban kanalet ujitëse dhe kulluese si dhe veprat e artit;
 - b) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe kullimit;
 - c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit, si dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja;
 - d) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe kur është e nevojshme kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre;
 - e) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të; merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet;
 - f) g) përmbush detyrat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore;
 - h) monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti;
 - i) harton grafikët e ujitjes dhe bashkëpunon për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, me strukturat përkatëse të menaxhimit të burimeve ujore.
4. Kryen kontrollet teknike të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja dhe ndërmerr veprimet përkatëse për ruajtjen e sigurisë dhe sjelljen e tyre në kushtet e projektit,

Përveç mbikëqyrjes së zakonshme gjatë shfrytëzimit të veprës dhe detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8681, datë 02.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 18.03.2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave" dhe udhëzimeve të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

Zonat nën ujitje dhe kullim si dhe mbrojtje nga përmytja, në administrim të Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit Fier, përbëhen nga :

1. Zona/Skema ujitëse FRU-1-1, Kanali Vjose Levan Fier, me sipërfaqe 16500 ha, kanale të parë 72 km shtrihet në bashkinë Fier;
2. Zona/Skema ujitëse LU-1-1 Rezervuari i Thanës, me sipërfaqja 26970 ha, kanale të parë 142 km shtrihet në bashkitë Lushnje dhe Divjakë;
3. Zona/Skema ujitëse VLU-3, Lumi Shashicë Llakatund Selenicë, me sipërfaqe 2400 ha, kanale të parë 55 km shtrihet në bashkitë Selenicë Vlorë;
4. Zona/Skema ujitëse DLU - 1 Lumi Bisticë, me sipërfaqja 2453 ha, kanale të parë 53 km shtrihet në bashkitë Delvinë;
5. Zona/Skema ujitëse SRU-4 Burimet Ksamil + KK2 Caush, me sipërfaqe 2800 ha, kanale të parë 30.16 km shtrihet në bashkinë Sarandë;
6. Zona/Skema ujitëse SRU-1 Rezervuari Janarit, me sipërfaqja 2500 ha, kanale të parë 19.7 km shtrihet në bashkinë Konispol;
7. Zona/Skema ujitëse GJU -1 Dropull i Poshtëm Rezervuari Doftisë, me sipërfaqja 2300 ha, kanale të parë 40 km shtrihet në bashkitë Dropull, Gjirokastër;
- Zona në Kullim
1. Zona/Skema e Kullimit Fusha e Hoxharës FRK -1,2,3,4, me sipërfaqe 22980 ha, shtrihet në bashkinë Fier;
2. Zona/Skema e Kullimit Fusha e Roskovecit FRK -7,8, me sipërfaqe 6500 ha, shtrihet në bashkinë Roskovec;
3. Zona/Skema e Kullimit Fusha e Myzeqesë FRK-9, me sipërfaqe 2000 ha, shtrihet në bashkinë Fier;
4. Zona/Skema e Kullimit Divjakë Karavasta FRK-5,6, me sipërfaqe 6000 ha, shtrihet në bashkinë Fier dhe Divjakë;
5. Zona/Skema e Kullimit Emisari Myzeqesë LUK 1, me sipërfaqe 21300 ha, shtrihet në bashkitë Lushnje dhe Divjakë;
6. Zona/Skema e Kullimit Emisari Tërbufit LUK 2, me sipërfaqe 5800 ha, shtrihet në bashkitë Lushnje dhe Divjakë;
7. Zona/Skema e Kullimit Divjakë Karavasta LUK 3, me sipërfaqe 5350 ha, shtrihet bashkinë Divjakë; në 8. Zona/Skema e

Kullimit Tërbuf -Hidrovor LUK 4, me sipërfaqe 6950 ha, shtrihet në bashkinë Divjakë; 9. Zona/Skema e Kullimit Tërbuf -Hidrovor LUK 5, me sipërfaqe 8500 ha, shtrihet në bashkitë Divjakë dhe Lushnje; 10. Zona/Skema e Kullimit Myzeqesë Vlorë, me sipërfaqe 1100 ha, shtrihet në bashkinë Vlorë; 11. Zona/Skema e Kullimit Myzeqe me Hidrovorin Akërnë, sipërfaqe 4500 ha, shtrihet në bashkinë Vlorë; 12. Zona/Skema e Kullimit me Hidrovorin Goricë, me sipërfaqe 1050 ha, shtrihet në bashkinë Vlorë; 13. Zona/Skema e Kullimit Llakatund VLK-4, me sipërfaqe 1600 ha, shtrihet në bashkinë Vlorë; 14. Zona/Skema e Kullimit Llakatund VLK-5, me sipërfaqe 1200 ha, shtrihet në bashkinë Selenicë; 15. Zona/Skema e Kullimit Dukat Tragjas, me sipërfaqe 1800 ha, shtrihet në bashkisë Vlorë; 16. Zona/Skema e Kullimit SRK-1, Fusha e Vurgut Cuke, dhe Fusha e Vurgut Pal me sipërfaqe 1250 ha, shtrihet në bashkitë, Sarandë dhe Finiq; 17. Zona/Skema e Kullimit SRK-2, Hidrovori Cuke Fusha e Vurgut, me sipërfaqe 1135 shtrihet në bashkitë, Sarandë dhe Finiq; ha, 18. Zona/Skema e Kullimit SRK-3, Fusha e Vagalatit, me sipërfaqe 310 ha, shtrihet në bashkinë, Finiq; 19. Zona/Skema e Kullimit SRK-4, Zona e Rezervuarit Pandelejmon, me sipërfaqe 610 ha, shtrihet në bashkinë Finiq; 20. Zona/Skema e Kullimit SRK-6, Hidrovori Butrintit Fusha e Vrinës, me sipërfaqe 685 ha, shtrihet në bashkinë Konispol; 21. Zona/Skema e Kullimit SRK-7, Fusha e Vrinës, Mursi Konispol, me sipërfaqe 1263 ha, shtrihet në bashkinë Konispol; 22. Zona/Skema e Kullimit SRK-11, Fusha e Janarit, me sipërfaqe 429 ha, shtrihet në bashkinë Konispol; 23. Zona/Skema e Kullimit DLK-1, Fusha e zonave Ardhasove, Caush, Krane, Fitore, Finiq, me sipërfaqe 1300 ha, shtrihet në bashkinë Finiq; 24. Zona/Skema e Kullimit DLK-2, Fusha e zonave Van, Shijan, Star, Mesapotam, Bajkaj, Palavli, me sipërfaqe 1100 ha, shtrihet në bashkitë Delvinë dhe Finiq; 25. Zona/Skema e Kullimit GJK 1, GJK 2, Kullimi i Fushës Dropull, me sipërfaqe 5600 ha, shtrihet në bashkinë Dropull; 26. Zona/Skema e Kullimit GJK 2, Kullimi Gjirokastër Valare, me sipërfaqe 1750 ha, shtrihet në bashkinë Gjirokastër; 27. Zona/Skema e Kullimit GJK 4, Kullimi Lunxheri Odrie, sipërfaqja 1000 ha, shtrihet në bashkinë Gjirokastër; 28. Zona/Skema e Kullimit GJK 5,6,7, Kullimi i Fushës Cepun, Mashkullore, Humelicë, Kardhiq, sipërfaqe 1100 ha, shtrihet në bashkinë Gjirokastër;

Nga shqyrtimi i planeve të punës së veprimtarisë, korrespondencave dhe relacionet e sektorëve me përgjegjësin e sektorit teknik dhe drejtorin e Drejtorisë së Kullimit dhe Ujitjes Fier u konstatua se kërkesat e rregullores së institucionit dhe të Udhëzimit nr. 12, *“Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”* nuk janë formalizuar në shkresa standarde të aprovuara nga titullari.

-Planet e punës të paraqitura nga përgjegjësat e sektorëve ishin në formate të ndryshme, të dërguara me email, jo të protokolluara dhe në ndonjë rast pa firmën e titullarit.

Planet e veprimit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve të ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmytjet, digave, hidrovoreve dhe makinerisë së rëndë nuk parashikonin qartë punimet, verifikimet dhe grafikun e kryerjes.

Në përgjithësi informacionet e sektorëve për ndjekjen e punimeve dhe mirëmbajtjeve ishin të përgjithshme, pa specifikime dhe detaje teknike.

Për sa më sipër mban përgjegjësi drejtori i DUK, dhe përgjegjësit e sektorëve, nisur nga detyrat që kanë në rregulloren e institucionit dhe nenet si vijon: *Neni 9, detyrat e Drejtorit të DUK a) Drejton dhe organizon veprimtarinë e DUK, për realizimin e detyrave për arritjen e objektivave të përcaktuara në programin vjetor; d) Përgatit planin e veprimit, programin vjetor dhe planin mujor të punës për DUK, si dhe përcakton detyra për sektorët përkatës; f) Evidenton dhe bën shpërndarjen e punëve, çështjeve dhe shkresave, që i drejtohen, ndjek dhe kontrollon punën, që*

bëhet nga përgjegjësit e sektorëve, për përcaktimin e dhënies së zgjidhjes ligjore dhe teknike, në afatet e caktuara; i) Mbikëqyr zbatimin e planit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve të ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytjet, digave, hidrovoreve dhe makinerisë së rëndë;

Detyrat e përgjegjësit të sektorit teknik: b) Drejton dhe organizon veprimtarinë e sektorit për realizimin e qëllimit dhe detyrave funksionale, dhe në bashkëpunim me sektorët e tjerë ndjek në vazhdimësi punën për gatishmërinë e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja, sigurinë e digave, hidrovoreve dhe makinerisë, në mënyrë që të respektohen afatet e vënies në gatishmëri dhe kolaudimit, të veprave ujitëse e kulluese siç përcaktohet në nenin 4. e) Përgatit planin e veprimit, programin vjetor dhe planin mujor të punës për sektorin mbi bazën e programeve të hartuara nga drejtori; h) Programon inspektime të gjendjes së infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, sipas akteve ligjore e nënligjore të cituara në nenin 1 dhe përcaktimeve në këtë rregullore;

Detyrat e përgjegjësit të sektorit hidrovor-makineri: b) Drejton dhe organizon veprimtarinë e sektorit për realizimin e qëllimit dhe detyrave funksionale; d) Miraton objektivat e vendit të punës për punonjësit që ka në varësi, kontrollon dhe ndjek realizimin e tyre; f) Përgatit planin e veprimit, programin vjetor dhe planin mujor të punës për sektorin; g) Përgjigjet për kryerjen e remonteve, riparimeve dhe difekteve elektrike dhe mekanike në vazhdimësi, si dhe kolaudimin e pajisjeve të hidrovoreve brenda datës 30 shtator; h) Harton grafikun e remontit të përgjithshëm dhe të pjesshëm duke siguruar paraprakisht bazën materiale të nevojshme, mbas miratimit të planit të remontit tek drejtori;

12. Përgjegjësit e sektorëve të zonave Lushnje, Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastër

b) Drejtojnë dhe organizojnë veprimtarinë e sektorit për realizimin e detyrave teknike përcaktuara nga përgjegjësi i sektorit teknik të DUK; d) Organizojnë punën e sektorit për mbikëqyrjen e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja në zonën e tyre sipas udhëzimeve të përgjegjësit të sektorit teknik; e) Mbi bazën e inspektimeve teknike parashikojnë sistematikisht nevojat për mirëmbajtje dhe investime dhe ja paraqet ato përgjegjësit të sektorit teknik; g) Ushtron kontrole të vazhdueshme së bashku me specialistët e sektorit, duke bërë sondazhe të vazhdueshme, për të nxjerr sipërfaqen reale të ujitur, problemet në kullim, gjendjen e argjinaturave dhe digave; h) Mbi bazën e kontrolleve dhe vlerësimeve të bëra në terren, përpilon informacion për përgjegjësin e sektorit teknik.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi drejtori i DUK Fier, z. Th. S., z. E. K., me detyrë përgjegjësi i Sektorit Teknik Fier; z. B. K., me detyrë përgjegjësi i Sektorit Hidrovor-Makinerive; z. F. D., me detyrë përgjegjësi i Sektorit Teknik Lushnje;

z. V. H., me detyrë përgjegjësi i Sektorit Teknik Vlorë; z. O. Sh., me detyrë përgjegjësi i Sektorit Teknik Sarandë dhe Gjirokastër.

2.3. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, si dhe administrimi i vlerave materiale dhe monetare.

Në zbatim të pikës 3.1 të Programit të Auditimit Nr.714/2 prot.i ndryshuar, datë 03.07.2025, "Auditim Përputhshmërie", në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier: lidhur me "Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, si dhe administrimi i vlerave materiale dhe monetare", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- PBA 2024-2026, 2025-2027;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2024 dhe 2025;

- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2024 dhe 2025 i rakorduar me Degën e Thesarit Fier;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2024 dhe 2025 i rakorduar me Degën e Thesarit Fier;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.
- Pasqyrat financiare të vitit 2024

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për vitin 2024 për përgatitjen e PBA 2024-2026 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me shkresën nr. 663 prot., datë 25.01.2024 për “buxhetin 2024-2026 në shpenzime korrente” dhe me shkresën nr. 2149/1 prot., datë 29.03.2024 për “buxhetin e vitit 2024-2026 në shpenzime kapitale (investime)” nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë dhe e Shërbimeve Mbështetëse.

PBA janë në zbatim të ligjit nr. 97/2023 “ Për buxhetin e vitit 2024” bazuar në Udhëzimin e MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe bazuar në shkresën miratuse të Ministrisë së Financave nr. 1325/4 datë 29.03.2024

Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier për vitin 2024 është 612,463,151 lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të DUK Fier për vitin 2024, realizohen nga buxheti i shtetit.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2024, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin.

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2024-2026, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 10,795 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në “Mirëmbajtje Hidrovori” dhe “Energjia për Hidrovoret”.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga MBZHR për kryerjen e funksioneve të veta.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e DUK Fier në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime bazuar kërkesave buxhetore të bëra nga DUK Fier në bazë të objekteve prioritare që ka pasur institucioni dhe miratuar me aktet normative nga MF. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime), janë shtuar fondet për Bajpasin e Hidrovorit të Tërbufit dhe janë çelur fonde për objekte të reja si mirëmbajtja e lumit Drino në Gjirokastrë dhe rehabilitimi i kanalit ujitës Llakatund Vlorë dhe janë bërë pikësime të ndryshme nëpërmjet këtij akti normativ. Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Fier dhe janë të raportuara periodikisht pranë drejtorisë së buxhetit në

MBZHR. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudhën 2024, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit, si dhe shkaqet e mosrealizimit të disa artikujve.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i DUK Fier ka pësuar ndryshime nëpërmjet rialokimit të fondeve buxhetore, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, janë të konfirmuara nga MBZHR.

Tabela Nr. 1. Ndryshimet buxhetore për vitin 2024

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024 dhe rishpërndarja e fondeve								
Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë		Buxheti + Shtesat	Pakësimet	Buxheti i Rishikuar	Buxheti Përfundimtar	Diferenca
	1	2	3	6=2+3+4-5	7			
600	109,112	6,370	9,630	125,112		125,112	124,698	414
601	18,088	700		18,788		18,788	18,788	-
602	205,000			205,000	3,740	201,260	191,023	10,237
606	61	2,820		2,881		2,881	2,881	-
230-231	241,273	80,340		321,613	57,191	264,422	264,277	145
Totali	573,534	90,230	9,630	673,394	60,931	612,463	601,667	10,796

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për vitin 2024 realizimi i buxhetit është në nivelin 98%, si dhe programet ekonomike që paraqiten me realizimi më të lartë janë artikujt 600 “Pagat e punonjësve”, 601 “Sigurimet shoqërore dhe 231 “Investimet”.

Programi me realizimin më të ulët është artikulli 602 “Shpenzime për mirëmbajtje”, -“energji elektrike për hidrovoret” e cila është konsumuar më pak (lidhet me punën e pompave të hidrovorëve) dhe mosrealizimi i procedurës për blerje Vaj-Graso për mjetet e rënda, sepse është një shpenzim që duhet bërë me blerje të përqendruar.

Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Fier, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë dërguar për çdo muaj “evidencat e realizimit të fondeve buxhetore” MBZHR-së dhe në datën 03.01.2025 është dërguar 12-mujori i përmbledhur i vitit 2024. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Fier, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit

për periudhën 2024-2026, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.2. Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2024

Art.	Emertimi	Plan Progrosiv	Fakti	Në %
600	Pagat e punonjesve	125,112,000	124,697,872	100%
601	Sigurime shoqerore	18,788,000	18,788,000	100%
602	Shuma shpenzime per mirembajtje	201,260,000	191,022,956	95%
606	Ndihme per raste fatkeqesive	2,881,000	2,881,000	100%
231	Investime artikulli	264,422,151	264,277,162	100%
	Totali	612,463,151	601,666,990	98%

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 98%, ku realizimin më të lartë e ka shpenzime për paga dhe sigurime, kapitale të trupëzuara, dhe 606 “ndihma në raste fatkeqësie dhe shpërblime”. Vihet re se për vitin 2024 art. (602) paraqiten 95%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. U konstatua se DUK Fier nuk ka detyrime të prapambetura deri në 31.12.2024, sipas tabelave më poshtë:

Detyrime 2024	Detyrimi në fillim të vitit 2024	Detyrimi i krijuar në 2024	Total detyrime	Shlyerja gjate 2024	Mbetja në 31.12.2024
Shpenzime Opeatvie 602	0	191,023,474	191,023,474	191,023,474	0
Total Detyrime	0	191023474	191023474	191023474	0

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor, për vitin 2024 u kontrolluan me përzgjedhje disa muaj (janar, mars, tetor, dhjetor) dhe pagesat janë kryer në mënyrë korekte dhe kanë bashkëlidhur dokumentacionin mbështetës si urdhër shpenzimet, faturat tatimore, situacionet e punimeve, kontratat e operatorëve, procesverbalet e marrjes pjesore në dorëzim, akt kolaudimi etj.

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se për vitin 2025 për përgatitjen e PBA 2025-2027 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me shkresën nr. 621/2 prot datë 07.02.2025 për “buxhetin 2025-2027 në shpenzime korrente” dhe me shkresën nr. 1732/1 prot datë 07.03.2025 për “buxhetin e vitit 2025-2027 në shpenzime kapitale (investime)” nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë dhe e Shërbimeve Mbështetëse

PBA janë në zbatim të ligjit nr. 97/2023 “ Për buxhetin e vitit 2025” bazuar në Udhëzimin e MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe bazuar në shkresën miratuese të Ministrisë së Financave nr. 1325/4 datë 29.03.2024

Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier për vitin 2025 është 672,546,702 lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të DUK Fier për vitin 2025, realizohen nga buxheti i shtetit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2025, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga MBZHR për kryerjen e funksioneve të veta.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë kësaj periudhe, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e DUK Fier në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime bazuar kërkesave buxhetore të bëra nga DUK Fier në bazë të objekteve prioritare që ka pasur institucioni dhe miratuar me aktet normative nga MF. Gjatë kësaj periudhe janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime), janë shtuar fondet për paga dhe sigurime, dhe janë bërë pakësime në shpenzimet operative.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Gjatë kësaj periudhe, buxheti i DUK Fier ka pësuar ndryshime nëpërmjet rialokimit të fondeve buxhetore, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, janë të konfirmuara nga MBZHR.

Tabela Nr.3. Ndryshimet buxhetore për vitin 2025

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024 dhe rishpërndarja e fondeve								
Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë		Buxheti + Shtesat	Pakësimet	Buxheti i Rishikuar	Buxheti Përfundimtar	Diferenca
	1	2	3	6=2+3+4-5	7			
600	118,800	12,000		130,800		130,800	69,669	
601	19,200	1,200		20,400		20,400	11,876	
602	205,000			205,000	1,395	203,604	95,475	
606								
230-231	317,742			317,742		317,742	219,665	
Totali	660,742	13,200		673,942	1,395	672,547	396,685	

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Diferenca mosrealizimi si 6-mujor nuk reflektohen në tabelë pasi fondet janë në vazhdim.

Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Fier, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Për periudhën janar-qershor 2025 është dërguar “evidenca e realizimit të

fondeve buxhetore” për 4-mujorin e parë të vitit MBZHR-së Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. DUK Fier nuk ka detyrime të prapambetura për vitin paraardhës, u konsaua se si 6-mujor ka detyrime të prapambetura në objektet e investimeve të cilat vijnë si pasoje e mungesës së fondeve buxhetore.

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë 6-mujorit të pare 2025.

Tabela Nr.4. Detyrimet e prapambetura për periudhën Janar-Qershor 2025

Detyrime 2025 Shpenzime operative 602	Detyrimi në fillim të vitit 2025	Detyrimi i krijuar deri në 30.06.2025	Total detyrime	Shlyerja gjate periudhës	Mbetja në 30.06.2025
Blerje karburant	-	26,387,720	26,387,720	26,387,720	-
Riparim dega lushnje	-	4,482,986	4,482,986	4,482,986	-
Energjia	-	51,082,397	51,082,397	51,082,397	-
Dieta	-	786,500	786,500	786,500	-
Uji,Posta Interneti	-	304,800	304,800	304,800	-
sigurimi jetes	-	990,000	990,000	990,000	-
pagese eksperti	-	424,412	424,412	424,412	-
Blerje kancelari	-	320,160	320,160	320,160	-
Transport aluvionesh	-	10,135,680	10,135,680	10,135,680	-
Sigurimi dhe taksat e makinave	-	354,254	354,254	354,254	-
Blerje libra hidrovore	-	104,167	104,167	104,167	-
Instalim energjie	-	101,955	101,955	101,955	-
Total Detyrime	-	95,475,031	95,475,031	95,475,031	-

Detyrime 2025	Detyrimi në fillim të vitit 2025	Detyrimi i krijuar deri në 30.06.2025	Total detyrime	Shlyerja gjate 2022	Mbetja në 30.06.2025
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrime për investime 231	0	167,375,481	167,375,481	0	167,375,481
Total Detyrime	0	167,375,483	167,375,481	0	167,375,481

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i

Detyrimet e prapambetura deri në 30.06.2025 janë në vlerën 167,375,481 lekë dhe rakordojnë me degën e Thesarit Fier, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr. 5. Situata Financiare për vitin 2025

(1) Kodi i Institucionit	(3) Emri i Furnitorit/ Kreditorit	(4) Nrimi i kontrates ne sistemin e thesarit	(5) Shuma e kontrates / marreveshjes / vendim gjyqi etj.	(6) Detajet e fatures / dokumentit financiar		(7) Sa kohe ka qe fatura eshte rregjistruar ne sistemin e thesarit			(8) Aresyej a perse eshte vonuar pagesa
				Numri i Fatures ne sistemin e thesarit	Data origjinale e Fatures	30-59 dit e	60-90 dit e	90 dit e	Munges fondesh
1005070									

1005070	N.	Mbrojtje nga Lumi Kalase (kaskada shelegarit)	16,951,012	323\2024, 35\2025	23.12.2024, 24.02.2025	X	X	Munges fondesh
	S.	Mbikqyrje Mbrojtje nga Lumi Kalase (kaskada shelegarit)	552,283	1\2025	13.03.2025	X		Munges fondesh
1005070	S.	Riparim I Argjinatures Mbrojtese te Kolaktorit K-17 Butrint	51,575,745	3\2025	09.01.2025		X	Munges fondesh
1005070	A.	Mbikqyrje Riparim I Argjinatures Mbrojtese te Kolaktorit K-17 Butrint	756,961	2\2025	18.03.2025	X		Munges fondesh
1005070	S.	Mbrojtje nga Lumi Kalase kaskada Vanes	3,754,326	6\2025	06.03.2025		X	Munges fondesh
1005070	M.	Riparim I Argjinatures Lumi Seman	69,735,485	8\2025	07.01.2025		X	Munges fondesh
1005070	G&L.	Riparim I Argjinatures Lumi Seman	1,333,325	65\2025	23.12.2024		X	Munges fondesh
1005070	Sh.	Mur mbajtes ne Kolektorin rroskovec Hoxhare	22,076,987	64\2024, 2\2025,	04.12.2024, 21.01.2025		X	Munges fondesh
1005070	H.	Mbikqyrje Mur mbajtes ne Kolektorin rroskovec Hoxhare	459,357	9\2025	20.3.2025	X		Munges fondesh
	V. Dh.	Mbikqyrje fabrika a kepuceve gjitokaster	180,000	10\2024	20.12.2024		x	Munges fondesh
Totali			167,375,481					

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, cfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit”.

“Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike nr.4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”2.

Detyrimet e prapambetura të krijuara deri në 30.06.2025 janë krijuar si mungesë e fondeve buxhetore, keto detyrime janë listuar në tabelën e mësipërme.

Konkluzion i përgjithshëm:

-Buxheti i DUK Fier dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për vitin 2024 dhe 2025;

Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuara nga MBZHR.

-Për vitin 2024 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 98%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Ndihmë në rast fatkeqësie”, duke vijuar me shpenzime për Paga dhe Sigurime Shoqërore, Kapitale të Trupëzuara si dhe realizimin më të ulët e kanë Shpenzimet për mirëmbajtje (opeative).

Vihet re se për vitin 2024 art. (602) Shpenzimet për mirëmbajtje (opeative) paraqitet 98%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe ligjore, rezulton se përgjatë periudhës objekt auditimi nuk ka vendime gjyqësore ndaj DUK Fier.

-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Fier, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se në periudhën e auditimit nuk ka pagesa të prapambetura.

a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin e MF nr.5, datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018.*”

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, me Udhëzimin e MF me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Konstatohet se veprimet kontabël janë azhornuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarë të mbajtur në programin excel, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

Pasqyrat Financiare janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat Financiare vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

Për vitin 2024 janë dorëzuar Pasqyrat Financiare të Aparatit të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier pranë Degës së Thesarit me shkresën nr. 35/2 Prot., datë 25.03.2025 “*Dërgim i pasqyrave financiare të vitit 2024*” protokolluar në degën e thesarit Fier me nr 254/1 datë 25.03.2025.

Gjithashtu, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

b. Vlerësimi nëse drejtat dhe detyrimet janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Në kuadër të standarteve të raportimit financiar (SNK 1) objektivi i pasqyrave për qëllime të përgjithshme është të sigurojnë informacion lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike që është i dobishëm për një grup të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve ekonomike. Pasqyrat financiare tregojnë gjithashtu dhe rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin e burimeve që u janë besuar. Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar (Kuadri konceptual).

Pasqyra financiare

Në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, Kapitulli V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore”, i ndryshuar. Pasqyrat Financiare kanë për qëllim që të japin një pamje të strukturuar të pozicionit financiar dhe transaksioneve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme, të sigurojnë informacion për pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare.

Qëllimi i përgjithshëm është që me informacionin që disponojnë, pasqyrat financiare, në radhë të parë të japin informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë apo institucionin raportues, nëpërmjet sigurimit të informacionit rreth burimeve financiare dhe alokimit të tyre, informacionit për mënyrën e financimit të aktiviteteve të njësisë dhe realizimit të kërkesave monetare, lidhur me aftësinë e njësisë për të financuar aktivitetet dhe për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet, informacionit për vlerësimin e performancës së njësisë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 dhe ato të vitit 2023 konstatohet se tepricat e pasqyruara në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në pasqyrat e vitit 2023 përputhen me tepricat në celje të vitit ushtrimor 2024 në pasqyrat e vitit 2024.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier konstatohet se:

1.Pasqyra e pozicionit financiar

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar tre pjesët përbërëse të saj paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2024

a-Të drejtat (Aktivet) 3,940,812 mijë lekë

b-Detyrimet (Pasivet) 75,975 mijë lekë

c-Fondet Neto (Aktivet neto) 3,864,837 mijë lekë

Aktivet neto plotësojnë rregullin Aktive – Pasive = Aktivet Neto 3,864,837 mijë lekë).

1.1. Të Drejtat

Të Drejtat, më datë 31 dhjetor të periudhës së auditimit pasqyrohen dhe përbëhen nga:

Tabela Nr.6.

Në lekë

Emërtimi	Ushtrimi i mbyllur 2024	Ushtrimi i mbyllur 2023	Pesha % per 2024	Pesha % per 2023	Ndryshimi 2024/2023
I. Aktivët Afatshkurtra	97,301,278	76,737,283	2%	2%	20,563,995
II. Aktivët Afatgjata	3,843,511,079	3,790,670,835	98%	98%	52,840,244
Totali	3,940,812,357	3,867,408,118	1	1	73,404,239

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi u konstatua se në vitin 2023 Aktivët e afatshkurtra kanë zënë 2% të totalit të Të Drejtave në vlerë 76,737,283 mijë lekë ndërsa Aktivët afatgjata kanë zënë 98% të totalit, në vlerë 3,790,670 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 ky raport nuk ka ndryshuar, aktivët e afatshkurtra kanë zënë 2% të totalit të Të Drejtave në vlerë 97,301,278 mijë lekë ndërsa aktivët afatgjata kanë zënë 98% të totalit, në vlerë 3,3,843,511 mijë lekë.

Ndryshimi në Aktivët afatshkurtra gjatë vitit 2024 është në rritje në vlerë me 20,563 mijë lekë. Ky ndryshim është efekt i rritjes së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, rritjes së inventarit qarkullues dhe llogarive të arkëtueshme, dhe konkretisht i rritjes së tepricës së mjeteve monetare, shtimit të inventarit qarkullues, rritjes së detyrimeve të debitorëve ndaj njësisë dhe rritjes së operacioneve me shtetin. Ndërsa ndryshimi në Aktivët afatgjata gjatë vitit 2024 ka ardhur në rritje me 1% sa i përket peshës specifike që zene aktivët afatgjata në raport me totalin e Të Drejtave dhe në rritje në vlerë me 52,840 mijë leke.

1.a Aktivët afatshkurtra (qarkulluese) AASH

Aktivët Afatshkurtra për vitin 2024 janë mbyllur me tepricë në shumën 97,301,278 lekë dhe përbëhen nga shuma e rubrikave që përfaqësojnë:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 38,730,520 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 21,325,936 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 37,244,822 lekë;

Tabela Nr.7.

Në lekë

Aktivët afatshkurtra	Ushtrimi I mbyllur 2024	Ushtrimi I mbyllur 2023	Ndryshimi
I. Aktivët Afatshkurtra	97,301,278	76,737,283	20,563,995
1. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	38,730,520	37,579,292	1,151,228
2. Gjendje inventari qarkullues	21,325,936	15,488,705	5,837,231
3. Llogari të arkëtueshme	37,244,822	23,669,286	13,575,536

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të periudhës objekt auditimi në fund të vitit ushtrimor mbyllet me tepricë në vlerë 38,730,520 lekë. Nga auditimi konstatohet Tepricat në mbyllje të vitit ushtrimor rakordojnë me rubrikën V “Teprica

në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të pasqyrës së fluksit monetar.

Nga rakordimi me degën e thesarit lidhur me llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, llogarinë nr.466 “Mjete në ruajtje” dhe llogaritë e të ardhurave nuk konstatohen mosrakordime. Llogaria nr.520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare objekt auditimi paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Tabela Nr.8

Në lekë

Disponibilitete ne thesar		Viti 2024
Mjete në ruajtje	38,730,520	
Gjendja ne Pasqyrat financiare (llog 520)	38,730,520	

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaritë e Klasës 3,

Aktivet qarkulluese përkufizohen si tërësia e aktiveve që i shërbejnë funksionimit të njërive të qeverisjes së përgjithshme, për një kohë relativisht të shkurtër, kryesisht për një vit ushtrimor. Sipas Pasqyrave të Pozicionit Financiar të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier në 31.12.2024, teprica e kësaj klase mbyllet në shumën 21,325,936 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 15,349,029 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” në shumën 5,976,907 lekë.

Tabela Nr.9

Në lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i		Ndryshimi
		mbyllur 2024	mbyllur 2023	
	2.Gjendje inventari qarkullues	21,325,936	15,488,705	5,837,231
31	Meriale	15,349,029	9,349,940	5,999,089
32	Inventar i imët	5,976,907	6,138,765	-161,858

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Diferencat me vitet e mëparshme përfaqësojnë lëvizjet e inventarit, konkretisht për vitin 2024-2023 ndryshimi është në shumën 5,837,231 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën (- 5,837,231) lekë.

Nga auditimi i librave të magazinës konstatohet se për vitin 2024 gjendja e inventarit është në shumën 13,349,029 lekë dhe korisponon me gjendjen fizike të materialeve, gjendja e llogarisë 31 “Materiale” në pasqyrën e pozicionit financiar është në shumën 15,349,029 lekë, ka një diferencë (mosrakordim midis pasqyrës financiare dhe gjendjes fizike të inventarit) në vlerë 2,000,000 lekë. Sipas komunikimit elektronik me Sektorin e Financës u pohua se vendosja më tepër e vlerës 2,000,000 lekë në pasqyrën e performancës është lapsus. Në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5 dhe 6.

Sipas inventarit të magazinës së datës 31.12.2024 gjendja e llogarisë 32 “Inventar i Imet” është në vlerë 5,976,07 lekë. Nuk konstatohen diferenca midis librave të inventarit fizik dhe llogarisë në pasqyrat financiare.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme përbëhet nga:

Tabela Nr.9

Në lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi I mbyllur 2024	Ushtrimi I mbyllur 2023	Ndryshimi
	3.Llogari të arkëtueshme	37,244,822	23,669,286	13,575,536
468	Debitorë të ndryshëm	4,902,900	4,902,900	0
4342	Operacione me shtetin (të drejta)	32,341,922	18,766,386	13,575,536

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin(Të drejta)” mbyllet me tepricën e pasqyruara në pasqyrat financiare në shumën 32,341,922 lekë. Kjo tepricë përfaqëson detyrimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, detyrimet e TAP si dhe detyrime të tjera. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e detyrimeve 42,435, 436 dhe 467. Llogaritë kundërparti të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin(Të drejta)” në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr.10

Në lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi i	Ushtrimi i	Ndryshimi
		mbyllur 2024	mbyllur 2023	
4342	Totali	32,341,922	18,766,386	13,575,536
42	Detyrime ndaj personelit	11,739,435	9,086,488	2,652,947
435	Sigurime Shoqërore	1,831,626	1,316,556	515,070
436	Sigurime Shëndetësore	201,479	156,080	45,399
467	Kreditore të ndryshem	18,569,382	8,207,262	10,362,120

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshem” përfaqëson detyrimet që kanë të tretët ndaj Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier e cila për periudhën e auditimit është mbyllur me tepricë në shumën 4,902,900 lekë. Konstatohet se detyrimet ndaj DUK Fier për vitin 2024 janë të pandyshuara në krahasim me vitin 2023. Kjo shumë e detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.11

Në lekë

Nr.	Lloji I Debitoreve	Debitoret 31.12.2023	Shtesa 2024	Paksime 2024	Gjendje debitore 31.12.2024
1	Sh.	4,902,900			4,902,900

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se debitori është shoqëria Sh.. Nga auditimi i vitit 2018 që ka kryer KLSH ndaj DUK Fier, është lënë rekomandim që të mblidhet kjo vlerë. DUK Fier ka hapur proces gjyqësor ndaj shoqërisë Sh. për mbledhjen e kësaj vlere, ky proces gjyqësor deri në periudhën e mbylljes së auditimit 30.06.2025 ndodhet në Gjykatën e Apelit.

1.1.b Aktivët Afatgjata

AAGJ përbëhen nga aktivet afatgjata jomateriale në shumën 75,672,004 leke, aktivet afatgjata materiale në shumën 3,767,839,075 lekë sipas tabelës se mëposhtme.

Tabela Nr.12

Në lekë

Emërtimi	Ushtrimi I mbyllur 2024	Ushtrimi I mbyllur 2023
II. Aktivët Afatgjatë	3,843,511,079	3,790,670,835
Aktivët afatgjatë jomateriale	75,672,004	89,025,887
Aktivët afatgjatë materiale	3,767,839,075	3,701,644,948

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Aktivët afatgjatë meriale përbëhen nga:

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” mbyllet me tepricë në shumën 75,672,004 lekë

Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” mbyllet me tepricë në shumën 218,459,618 lekë

Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” mbyllet me tepricë në shumën 2,965,663,110 lekë

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” mbyllet me tepricë në shumën 568,074,489 lekë

Llogaria 215 “Mjete transporti” mbyllet me tepricë në shumën 7,837,744 lekë

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” mbyllet me tepricë në shumën 1,614,837 lekë

Llogaria 24 “Aktivët afatgjatë të dëmtuara” mbyllet me tepricë në shumën 6,189,277 lekë

Tabela Nr.13

Në lekë

Referenca llogarive	Emërtimi	Ushtrimi I mbyllur 2024	Ushtrimi I mbyllur 2023
	2. Aktivët afatgjatë materiale	3,843,511,079	3,790,670,835
202	Studime dhe kërkime	75,672,004	89,025,887
212	Ndërtesa e konstruksione	218,459,618	212,419,406
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,965,663,110	2,879,011,566
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	568,074,489	593,273,744
215	Mjete transporti	7,837,744	8,277,033
218	Inventar ekonomik	1,614,837	2,148,171
28	Aktivët afatgjatë të dëmtuara	6,189,277	6,515,028

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaritë përbërëse të AAM analizohen si më poshtë:

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 75,672,004 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 89,025,887 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)” të vitit 2024, llogaria 202 është paksuar/amortizuar, llogaritur gjatë vitit në shumën 13,353,883 lekë. Është aplikuar metoda e amortizimit me “Vlere te mbetur” dhe norme amortizimi vjetore 15%.

Tabela Nr.14

Në lekë

Nr.	Emertimi i objektit	Teprica Neto 31.12.2023	Shtesa	Paksime/Riklasifikime	Teprica Neto 31.12.2024
202	Studime dhe kërkime	89,025,887	0	13,353,883	75,672,004
	Totali	89,025,887	0	13,353,883	75,672,004

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 218,459,618 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 212,419,406 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” të vitit 2024, llogaria 212 është shtuar me një vlerë prej 17,538,086 lekë dhe është paksuar/amortizuar, llogaritur gjate vitit në shumën 11,497,874 lekë. Është aplikuar metoda e amortizimit me “Vlere te mbetur” dhe norme amortizimi vjetore 5%.

Tabela Nr.15

Në lekë

Nr.	Emertimi i objektit	Teprica Neto 31.12.2023	Shtesa	Paksime Amortizimi vjetor	Teprica Neto 31.12.2024
212	Ndërtime e konstruksiione	212,419,406	17,538,086	11,497,874	218,459,618
	Totali	212,419,406	17,538,086	11,497,874	218,459,618

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 2,965,663,110 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 2,879,011,566 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” të vitit 2024, llogaria 213 është shtuar me një vlerë prej 242,739,076 lekë dhe është paksuar në shumën 156,087,532 lekë per amortizimin vjetor. Është aplikuar metoda e amortizimit me “Vlere te mbetur” dhe norme amortizimi vjetore 5%.

Tabela Nr.16

Në lekë

Nr.	Emertimi i objektit	Teprica Neto 31.12.2023	Shtesa	Paksime/Amortizimi vjetor	Teprica Neto 31.12.2024
213	Rruge, rrjete, vepra ujqor	2,879,011,566	242,739,076	156,087,532	2,965,663,110
	Totali	2,879,011,566	242,739,076	156,087,532	2,965,663,110

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 568,074,489 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 593,273,744 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi kjo llogari është shtuar me 4,000,000 lekë dhe është paksuar/amortizuar, llogaritur gjate vitit në shumën 29,199,255 lekë. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 5%.

Tabela Nr.17

Në lekë

Nr.	Emertimi i objektit	Teprica Neto 31.12.2023	Shtesa	Paksime/Amortizimi vjetor	Teprica Neto 31.12.2024
214	Instalime Teknike, makineri e paisje, vegla pune	593,273,744	4,000,000	29,199,255	568,074,489
	Totali	593,273,744	4,000,000	29,199,255	568,074,489

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të llogarisë 214 konstatohen se amortizimi për këtë llogari në regjister është 28,460,328 lekë ndërsa në pasqyrën e performancës për këtë llogari është zbritur/amortizuar në vlerën 29,199,255 lekë gjithashtu norma e amortizimit për këtë llogari mbi “Vlerën e mbetur” duhet të jetë 20%. Norma e aplikuar nga subjekti është në masën 5% është në

kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili sanksionon se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi.....”;

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

-Llogaria 215 “Mjete transporti”, në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 7,837,744 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 8,277,033 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi kjo llogari është paksuar/amortizuar, llogaritur gjatë vitit në shumën 439,289 lekë. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 5%.

Tabela Nr.18

Në lekë

Nr.	Emertimi i objektit	Teprica Neto 31.12.2023	Shtesa	Paksime Amortizimi vjetor	Teprica Neto 31.12.2024
215	Mjete transporti	8,277,033	-	439,289	7,837,744
	Totali	8,277,033	-	439,289	7,837,744

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të llogarisë 215 konstatohen aktive për të cilat se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 20%. Norma e aplikuar nga subjekti në masën 5% është në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 36 e cili sanksionon se: “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: ... Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi.....”;

Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit jap një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicioneve financiare. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 1,614,837 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 2,148,171 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi konstatohet se llogaria 218 është paksuar/amortizuar, llogaritur gjate vitit në shumën 533,334 lekë. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 25%.

Tabela Nr.19

Në lekë

nr .	Emertimi i objektit	Teprica 31.12.2023	Neto	Shtesa	Paksime Amortizimi vjetor	Teprica 31.12.2024	Neto
218	Inventar Ekonomik	2,148,171		0	533,334	1,614,837	
	Totali	2,148,171		0	533,334	1,614,837	

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

-Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” në fund të vitit 2024 pasqyrohet në vlerën neto 6,189,277 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet me vlerën neto 6,515,028 lekë e cila përfaqëson aktive afatgjata te dëmtuara.

Nga auditimi i pasqyrave “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për periudhën objekt auditimi konstatohet se llogaria 24 është paksuar/amortizuar, llogaritur gjatë vitit në shumën 325,751 lekë. Konstatohet se metoda e llogaritjes së amortizimit është me “Vlerë të mbetur” dhe me normë amortizimi 5%.

Tabela Nr.20

Në lekë

Nr.	Emertimi i objektit	Teprica Neto 31.12.2023	Shtesa	Paksime Amortizimi vjetor	Teprica Neto 31.12.2024
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	6,515,028	0	325,751	6,189,277
	Totali	6,515,028	0	325,751	6,189,277

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të llogarisë 24 konstatohen se kjo llogari përmban aktive të dëmtuara dhe nuk duhet të amortizohen. Norma e aplikuar nga subjekti është në masë 5%

Aplikimi i normave jo të sakta të amortizimit të trajtuara në seksionin e aktiveve ndikon rezultatin e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i Akumuluar)”. Efekti në pasqyren e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit te plote dhe te saktë te llogarive kontabel ne pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar te subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

1.2 Detyrimet

Llogaritë e klasës 4, në pjesën e detyrimeve të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier në datën 31 dhjetor të secilës periudhë kundrejt, punonjësve për paga, organeve tatimore për tatimin mbi pagat, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kreditorëve për mjetet ne ruajtje te cilat janë fondet e

ngurtësuar lidhur me garancitë e kontratave mes subjekteve dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, kreditorë të ndryshëm si dhe operacioneve me shtetin.

Detyrimet në datat e mbylljes së periudhave ushtrimore përbehen vetëm nga detyrimet afatshkurtra dhe paraqiten të përbëra nga:

Tabela Nr.21

Në lekë

Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi I mbyllur 2024	Ushtrimi I mbyllur 2023
	I. Detyrimet Afatshkurtra	75,975,342	61,248,578
42	Detyrime ndaj personelit	11,739,435	9,086,488
435	Sigurime Shoqërore	1,831,626	1,316,556
436	Sigurime Shëndetësore	201,479	156,080
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	38,730,520	37,579,292
467	Kreditorë të ndryshëm	18,569,382	8,207,262
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	4,902,900	4,902,900

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit” e cila përfaqëson shumën e pagave neto dhe sigurimeve (11.2%) të personelit të muajit dhjetor në shumën 11,739,435 lekë për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës. Konstatohet se për periudhën e auditimit detyrimi për pagat neto rakordojnë me vlerat sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Tabela Nr.22

Në lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	Vlera
1	06.01.2025	1,465,100
2	06.01.2025	1,063,313
3	06.01.2025	5,704,917
4	06.01.2025	1,508,469
5	06.01.2025	1,964,236
6	06.01.2025	33,400
Totali		11,739,435

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” përfaqësojnë vlerën e kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor për vitin 2024. Keto detyrime në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen përkatësisht në vlerat 1,831,626 dhe në vlerën 201,479 lekë. Kjo tepriçë në mbyllje të vitit ushtrimor rakordon me listëpagesen e deklaruar në organet tatimore dhe likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Urdhër shpenzimi		
Nr.	Datë	Vlera
5	13.01.2025	2,033,105
Totali		2,033,105

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve. Në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2024 kjo llogari paraqitet në vlerën kontabël 38,730,520 lekë, vlerë kjo e cila është e rakorduar me degën e thesarit, dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave për mallra dhe shërbime të cilat do tu kthehen të tretëve sipas kushteve të kontratave. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se: Për vitin 2024 nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, Drejtoria e financës ka të dokumentuar ngurtësimet gjatë vitit 2024 në vlerën 38,730,520 lekë për 31 subjekte. Gjatë vitit 2024 shtesat janë në vlerën 12,981,080 lekë dhe likuidimet e kryera për këtë vitin janë 11,829,852 lekë, sipas akt rakordimeve midis Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier dhe degës së thesarit Fier.

Si përfundim konstatohet se: Për 6 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, në vlerën 6,601,936 lekë, sipas tabelës në vijim, nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Lista e objekteve dhe subjekteve për të cilat investimi ka përfunduar de është marrë në dorëzim, por ende nuk është bërë xhirimi i fondeve të ngurtësuar prej 5% si garanci kontrate, në llogarinë e kontraktorit:

Tabela Nr. 24

Në lekë

Nr.	Objekti	Subjekti (Kontraktori)	Vlera e ngurtësuar
1	VLf pjesa e II	Sh.	3,031,623
2	Mbrojtja nga lumi KALASES	Sh.	2,400,042
3	Rikonstruksioni I ures varibob	Sh.	52,581
4	Mbrojtja nga lumi vjose ne Bishan,krahu I majte bashkia Vlore	K.	499,807
5	Riparimi i diges Vlashuk (pajisjet elektro-mekanike)	A.	511,319
6	Objekti është e mbartur nga iah Bordi VloprëVlora	Nga ish Bordi Vlorë	106,564
Totali			6,601,936

Veprimet e mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50, pika 30:

“Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”.

Pika 50. “Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”.

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e garancisë së punimeve.

Kontratat e lidhura për vitin 2024. Për vitin 2024 është kryer investimi me burim financimi nga fondet e siguruar nga buxheti i shtetit.

Për vitin 2024 janë lidhur 12 kontrata në vlerën 328,042,108 lekë për mbrojen nga lumi Vjosa, Kalasë, Pavlla e Madhe, Shushicë, Seman, rehabilitimi i disa kanaleve etj të financuara nga buxheti i shtetit.

- Llogaria 467, “Kreditorë të ndryshëm” përfaqëson shumën e detyrimeve që institucioni ka ndaj të tretëve, e cila ka vlerën 18,569,382 lekë dhe i përkasin periudhës dhjetor 2024, likuiduar në muajin janar 2025.

1.3 Fondet Neto

Nga auditimi konstatohet se Aktivët neto plotësojnë rregullin Te Drejta – Detyrime = Fondi i Konsoliduar. Fondi i Konsoliduar përbëhet nga llog 101 “Fondi i akumuluar” i cili për vitin 2024 mbyllet me tepricë 3,870,674,246 lekë dhe llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson rezultatën e vitit ushtrimor 2024 në shumën -5,837,231 lekë.

Tabela Nr. 25

Në lekë

Referenca e	FONDET NETO	Ushtrimi i	Ushtrimi i
llogarive		mbyllur 2024	mbyllur 2023
	Totali	3,864,837,015	3,806,159,540
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	3,870,674,246	3,806,159,540
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	-5,837,231	0

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Fondi i Konsoliduar është rezultat i llogarive sintetike të pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Nga auditimi i Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, tepricat e llogarive në fund të periudhave ushtrimore pasqyrohen si më poshtë:

Tabela Nr. 26.

Në lekë

	Emertimi	Kapitale	Fonde te tjera te veta	Rezultate e Mbartura Teprioce/Deficit	Rezultatet e ushtrimit Teprioce/Deficit	Fonde/ Neto
b	c	1	3	4	5	6
101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	3,806,159,540	270,075,299			4,076,234,839
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/FONDET NETO(1+2)	-	-211,397,824	0	0	-211,397,824
	I.NGA BURIME TE BRENDSHME	-	-211,397,824	0	0	-211,397,824

105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	-				0
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	-				0
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	-				0
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	-				0
115	Nga fondet e veta të investimit(+)					0
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	-	-	210,697,991		-210,697,991
1015	Nga nxjerjet jashte perdorimit dhe dëmtimet(-)		-	699,833		-699,833
106	Nga grantet e jashtme kapitale (+)					0
	TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	3,806,159,540	58,677,475	0	0	3,864,837,015

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi konstatohet se totali fondeve neto në të dy pasqyrat rakordon. Nga auditimi konstatohet se llogaria 1013 “Nga konsumi i AAGJ” ne pasqyrën e pozicionit financiar është pjese e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i Akumuluar)” sipas vlerës se paraqitur ne pasqyrën e ndryshimeve ne fondet neto.

Llogaria 1013 “Nga konsumi i AAGJ” ne pasqyrën e ndryshimeve ne fondet neto eshte rezultat i pasqyrës se Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto) sipas normave te amortizimit te aplikuar nga subjekti. Aplikimi i normave jo te sakta te amortizimit te trajtuara ne seksionin e aktiveve ndikon rezultatin e llogarisë 1013 “Nga konsumi i AAGJ” i cili nga ana e tij ndikon llogarinë 101 “Teprica (Fondi i Akumuluar)”. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakordimit te plote dhe te saktë te llogarive kontabël ne pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar te subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5.

Pasqyra e Performancës

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transferuat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive në pasqyrën e performancës rezultoi se konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i të “Ardhurave” në Pasqyrën e Performancës F2 është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2024 pasqyra paraqitet si më poshtë:

Të ardhurat (grupi A) = 350,965,682 lekë

Shpenzimet (grupi B) = 350,965,682 lekë

Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 0 lekë

Ndryshimi i gjendjes së llogarive të klasës 3 në Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2023 me 31.12.2024, përkatësisht 15,488,705 minus 21,325,936 konstatohet -5,837,231 lekë. Kjo vlerë konstatohet e barabartë me tepricën e llogarisë 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit” në Pasqyrën nr. 2, “Pasqyra performancës financiare”.

2.1 Të ardhurat

Në kuptim të SKK1 Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës së raportimit, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e detyrimeve, si dhe që rrisin kapitalin e njesisë ekonomike.

Të ardhurat janë flukse hyrëse parash dhe përfaqësojnë rritjet e përfitimeve ekonomike bruto gjatë ushtrimit kontabël (periudhës së raportimit). Burim kryesor për të ardhurat në sektorin publik janë nga aktiviteti buxhetor, mallrat e shërbimet (veçori për sektorin publik). Gjithashtu, burime të tjera janë interesat, dividendët, grantet. Të ardhurat rrisin përfitimet ekonomike në formën e rritjes së aktiveve dhe pakësimit të pasiveve (detyrimeve), të cilat kanë për rezultat shtimin e fondeve të veta.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës konstatohet se të ardhurat e realizuara gjatë vitit janë rezultat i të ardhurave nga buxheti i shtetit për NJQP (Qendrore) shumë 318,623,760 lekë dhe financim i pritshëm nga buxheti në shumë 32,341,922 lekë sipas të dhënave të mëposhtme:

Tabela Nr. 27

Në lekë

Reference e llogarise	Te Ardhurat sipas pasqyrave financiare	Ushtrimi I mbyllur 2024
7200	Nga buxheti për NJQP (Qendrore)	318,623,760
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	32,341,922
Totali		350,965,682

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Grantet korrente përbëhen nga financimet nga buxheti

- Llogaria 7200 “Nga buxheti për NJQP (Qendrore)” përfaqëson financimin me grante nga buxheti i shtetit për funksionimin e institucionit në shumë 318,623,760 lekë,

- Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” përfaqëson shumë që institucioni u detyrohet punonjësve për pagat, detyrimet ndaj shtetit për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e mbajtur për tatimin mbi pagat në shumë 32,341,922 lekë. Kjo shumë rakordon me detyrimet afatshkurtra të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit objekt auditimi.

2.2 Shpenzimet

Shpenzimet përfaqësojnë pakësim të përfitimeve ekonomike gjatë ushtrimit kontabël, në formën e daljes apo të pakësimit të vlerave të aktiveve apo rritjen e detyrimeve. Shpenzimet janë flukse dalje gjatë periudhës raportuese, që kanë për rezultat zvogëlimin e kapitaleve të veta (fondeve), përfaqësojnë investimin që kryen njësia e qeverisjes së përgjithshme për realizimin e synimeve të tij të funksionimit gjatë një viti ushtrimor. Ato njihen në të njëjtën periudhë ushtrimore. Shpenzimet e raportuara pasqyrohen si më poshtë:

Tabela Nr. 28

Në lekë

B	SHPENZIMET	Ushtrimi mbyllur 2024	i
600	I. PAGAT DHE PËRFITIMET E PUNONJËSVE	127,349,819	
601	II. KONTRIBUTE TË SIGURIMEVE	19,349,269	
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	201,385,594	

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në shumën 127,349,819 lekë përfaqëson pagat e personelit të përhershëm dhe të përkohshëm. Nga auditimi shpenzimeve për paga konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit Fier.

Llogaria 601 “Kontribute të Sigurimeve” në shumën 19,349,269 lekë përfaqëson shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Nga auditimi shpenzimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit Fier.

Tabela e deklarimit të pagave në sistemin e Tatimeve C@ts janar-dhjetor 2024

Tabela Nr. 29

Në lekë

	Paga Totale bruto në lekë	[16] Paga Bruto mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore	[17] Kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme të punëdhënësit	[18] Kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme të punëmarrësit	[23] Total of Contributions for social insurances [19 + 22]	[25] Kontribute për sigurimet shëndetësore gjithsej	[26] Tatimi mbi të Ardhurat nga P
Janar	8,985,263	9,029,729	1,353,632	857,715	2,211,347	307,002	539,337
Shkurt	9,022,487	9,061,962	1,358,467	860,777	2,219,244	308,098	543,666
Mars	8,996,901	9,038,376	1,354,460	858,486	2,212,946	307,295	541,161
Prill	9,272,736	9,322,336	1,397,058	885,463	2,282,521	316,950	541,610
Maj	9,573,103	9,713,527	1,451,414	922,144	2,373,558	330,252	537,322
Qershor	9,975,540	10,122,640	1,510,625	960,771	2,471,396	344,162	543,397
Korrik	11,356,541	11,439,891	1,706,140	1,085,680	2,791,820	388,947	666,107
Gusht	11,501,635	11,576,735	1,722,320	1,098,192	2,820,512	393,606	660,134
Shtator	11,602,633	11,672,670	1,736,747	1,107,065	2,843,812	396,759	672,336
Tetor	11,692,465	11,763,440	1,750,331	1,115,938	2,866,269	399,951	699,021
Nentor	11,765,632	11,846,916	1,762,053	1,123,776	2,885,829	402,789	705,826
Dhjetor	11,780,938	11,851,913	1,762,757	1,124,245	2,887,002	402,959	707,380
Totali	125,525,874	126,440,135	18,866,004	12,000,252	30,866,256	4,298,770	7,357,297

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi konstatohet se pagat janar-dhjetor 2024 të deklaruara në sistemin e Tatimeve C@ts janë 125,525,874 lekë, në pasqyrën e performancës financiare janë vendosur 127,349,819 lekë, pra janë vendosur 1,823,945 lekë më shumë se sistemi C@ts. Kontributet për sigurimet në sistemin e Tatimeve C@ts janë 21,015,389 lekë në pasqyrën e performancës financiare janë vendosur 19,349,269 lekë, janë vendosur 1,666,120 lekë më pak se sistemi i tatimeve C@ts.

Tabela Nr. 30

Në lekë

	Pasqyra e performancës financiare	Deklarimi në C@ts	Diferenca
Paga 600	127,349,819	125,525,874	1,823,945
Sigurime 601	19,349,269	21,015,389	-1,666,120
Totali i diferencës			157,825

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Tek llogaria 600 kjo diferencë është 1,823,945 lekë më shumë se sistemi i tatimeve C@ts.
 Tek llogaria 601 kjo diferencë është 1,666,120,lekë më pak se sistemi i tatimeve C@ts.
 Kur i mbledh këto diferenca me njëra tjetrën (që janë njëra pozitive dhe tjetra negative) diferenca totale është 157,825 lekë. (1,823,945 - 1,666,120 = 157,825 lekë)
 Në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5 dhe 6.

Struktura Organizative

Struktura Janar – Maj 2024

Struktura e organikës Janar-Maj 2024 e DUK Fier është miratuar me urdhërin e ministërit të MBZHR nr.20/1 datë 11.01.2016, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të kushtetutës, dhe të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionin e administratës shtetërore”, të ligjit nr.8518 datë 30.07.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin” të ndryshuar, VKM nr.1107 datë 30.12.2015 “Për krijimin e bordeve rajonale të kullimit” dhe Urdhërit të Kryeministërit, nr.127, datë 16.09.2015, “Për marjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”.

Organika e Bordit Rajonal të Kullimit Fier të jetë sipas skemës 2/3, që i bashkëlidhet këtij urdhri.

-Struktura e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier për Janar-Maj 2024 është e përbërë:

Drejtor (1)

Spektori Financës dhe Shërbimeve (5)

Spektori Teknik Fier (7)

Spektori i Hidrovor-Makinerive Fier (48)

Spektori Teknik Lushnjë (34)

Spektori Teknik Vlorë-Sarandë (43)

Spektori Teknik Gjirokastër (4)

Numri total sipas strukturës të miratuar është 142 punonjës.

Tabela Nr. 31

Në lekë

Struktura e DUK Fier Janar - Maj 2024										
Nr. Punëmarësve	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj	
	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti
	142	147	142	148	142	148	142	159	142	167

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i listprezencave dhe deklaratave të listpagesave në sistemin e tatimeve numri i punëmarësve është më shumë se struktura e miratuar (në muajin janar janë 5 punëmarës më shumë, shkurt 6 më shumë, mars 6 më shumë, prill 17 më shumë dhe maj 25 më shumë).

Këta janë punonjës të marë me kontrata pune të përkohshme. Miratimin për marjen e këtyre punonjësve e ka dhënë MBZHR (Drejtorja e përgjithshme ekonomike dhe e shërbimeve mbështetëse) nëpërmjet shkresës nr.956/1 prot. 15.02.2024 “Mbi detajimin e numrit të punonjësve me kontratë për vitin 2024”, (punonjës mirmbajtje zgare 17, Teknik i mesëm 2, Punonjës pastrimi 1.

Në muajin Maj 2024 ka kalua struktura dhe nr. i punonjësve me kontratë, 5 më shumë. Këta 5 punonjës më tepër janë punësuar pas daës 10.05.2024 pasi ka hyrë në fuqi struktura e re.

Struktura Qershor – Dhjetor 2024.

Struktura e organikës për këtë periudhë e DUK Fier është miratuar me urdhërin e kryeministërit nr.78 datë 07.05.2024, në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të kushtetutës, të nenit 10, ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionin e administratës shtetërore”, i ndryshuar me urdhërin nr.207 datë 23.10.2024.

Skema 2/3, që përmendet në pikën 6, të zëvendësohet me skemën me të njëjtin numër dhe titull, që bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

Struktura e DUK Fier të jetë sipas skemës 1/3, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

Organika e DUK Fier të jetë sipas skemës 2/3, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

-Struktura e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier është e përbërë:

Drejtor (1)

Spektori Financës dhe Shërbimeve (5)

Spektori Teknik Fier (11)

Spektori Teknik Lushnjë (9)

Spektori Teknik Vlorë (7)

Spektori Teknik Gjirokastër (8)

Spektori i Hidrovor-Makinerive (127)

Numri total sipas strukturës është 168 punonjës.

Tabela Nr. 32

Në lekë

Struktura e DUK Fier Qershor- Dhjetor 2024														
Nr. Punëmarësve	Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nëntor		Dhjetor	
	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti
	168	176	168	185	168	187	168	189	168	187	168	188	168	188

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Edhe në këtë periudhë nr. i punëmarrësve është më i lartë se struktura, sepse janë sërish punonjësit e marrë më kontratë pune të përkohshme, bazuar në miratimin e dhënë nga MBZHR.

Në muajin Shtator 2024 ka kalua struktura dhe nr. i punonjësve me kontratë me 1 punonjës më shumë. Ky tejkallim vjen se në këtë listpagesë është punonjësja E. A. një pjesë të muajit dhe punëmarrësi I.P. që e ka zëvendësuar.

Nga janari në korrik 2024 pagat janë llogaritur në bazë të VKM 325 datë 31.05.2023

ç) Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Nga Korrik 2024 në Qershor 2025 pagat janë llogaritur në bazë të VKM 326 datë 31.05.2023 dhe VKM 422 datë 26.06.2024 “Për punonjësit mbështetës dhe punonjës të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”

Nga Korrik 2024 në Qershor 2025 pagat janë llogaritur në bazë të VKM 325 datë 31.05.2023 dhe VKM 421 datë 26.06.2024 “Për nivelet e pagave të nënpunësve të lartë”.

Pagat janë grupuar në tetë klasa sipas pozicioneve të punës në DUK Fier të miratuara me vkm-të e sipërpërmendura, sipas tabelës më poshtë:

Tabela Nr. 33

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Klasa e pagës	Paga bazë
1	Drejtori	III-1	115,000
2	Përgjegjës sektori	III-2	105,000
3	Specialist i lartë	IV-3	70,000
4	Teknik I mesëm	VI-6	43,200
5	Sekretari	X	45,300
6	Punonjës mirmbajtje	IV	42,500
7	Manovrator Ekskavatori	XIII	46,700
8	Shofer	IV	42,500

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Paga bruto për vitin 2024 është në vlerë 125,525,874 lekë dhe e përbërë nga:

Paga bazë sipas klasave në vlerë 79,807,955 lekë;

Vjetërsia në punë në vlerë 12,619,957 lekë bazuar në VKM 325 datë 31.05.2023;

Paga e funksionit në vlerë 17,652,273 lekë bazuar në VKM 422 datë 26.06.2024;

Për vështirësitë në punë dhe orët e turnit të dytë dhe të tretë në vlerë 15,445,689 lekë sipas Nenit 81 të kodit të punës.

Nga auditimi i dokumentave të bankës (urdhër shpenzimet e pagave) paga totale neto për periudhën e auditimit është paguar në vlerë 161,764,902 lekë.

Në listpagesat e deklaruar në sistemin e tatimeve E-sig25 paga neto e llogaritur është 161,478,437 lekë.

Konstatohet se pagat neto për periudhën e auditimit janë paguar 286,465 lekë më tepër.

Kjo mbipagesë e konstatuar për pagat neto vjen nga llogaritja gabim e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore gjithashtu dhe nga Tatimi mbi Pagën (TAP).

Më konkretisht punëmarrësit që janë të punësuar me 6 orë punë, paga bruto e tyre është më e vogël se paga minimale.,

Spektori i Financës në listpagesën e brendshme i ka llogaritur kontributet për këto paga (me 6 orë pune në ditë), dhe nuk i ka llogaritur me pagën minimale sipas ligjit për pagën minimale dhe sipas Sistemit të Tatimeve.

Spektori i Financës kur ka paguar pagën neto, ka ndaluar kontributet e sigurimeve të punëmarrësit për pagën e llogaritur me 6 orë pune (e cila është me vogël se paga minimale), e jo për pagën minimale sipas E-sig25, kjo ka sjellë që këta punonjës të marrin pagën neto më të lartë dhe kontributet e sigurimeve të paguhen sipas rregullit të gjeneruar nga sistemi i tatimeve E-sig25.

Gjithashtu dhe Tatimi mbi Pagën është llogaritur gabim për disa punonjës.

Këto janë arsytet që në periudhën objekt auditimi janë paguar 286,469 lekë më tepër pagat neto.

Në kundërshtim me udhëzimin udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5 dhe 6. dhe udhëzimi nr. 23 datë 9.12.2014 Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. (ndryshuar me udhëzimet nr. 1, datë 9.1.2015, nr. 32, datë 22.11.2022; nr. 3, datë 19.1.2023; nr. 14, datë 23.12.2024, ndryshuar me udhëzimin nr 10, datë 18.4.2025), pika 3.1.4 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i cili miratohet në zbatim të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Kjo do të thotë se asnjë punëdhënës, person juridik ose fizik, me punëmarrësit e vet, me kohë të plotë ose të pjesshme,

marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen në bazë të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të lidhë marrëveshje kolektive ose kontratë individuale me pagë më të ulët se paga minimale e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i cili miratohet në zbatim të këtij Kodi.

Tabelat më poshtë tregojnë disa shembuj si janë bërë llogaritjet nga Sektori Financës DUK Fier dhe si llogariten sipas Listpagesës Esig-25:

Tabela Nr. 34

Në lekë

Punëmarësit	Paga bruto e llogaritur nga subjekti	Paga mbi të cilën llogariten kontributet	Kontributet e punëmarësit ndaluar nga Sek.Financës 11.2%	Kontributet e punëmarësit sipas Esig-25 11.2%	Pagat neto sipas urdhërshpenzimeve të paguar nga Sek. Financ	Paga neto që duhet merrin punonjësit
D. H.	34,500	40,000	3,864	4,480	30,636	30,020
G. D.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
P. M.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
G. K.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
E. A.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
L. H.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
L. M.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
A. F.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
I. T.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
I. P.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
E. B.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
Sh. S.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
I. E.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
A. B.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
N. A.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
A. B.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
E. S.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
N. M.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
M. Rr.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
E. K.	35,875	40,000	4,018	4,480	31,857	31,395
Totali			80,206	89,600	635,919	626,525

Burimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Punonjësit e shembullit më lart kanë marrë pagë neto 9,394 lekë më shumë, gjithashtu dhe disa punonjësve të tjerë nuk i është llogaritur Tatimi mbi Pagën në mënyrën e duhur sipas tabelës më poshtë:

Tabela Nr. 35

Në lekë

	Paga Bruto	Sigurimet e punëmarësit 9.5% dhe 1.7%		TAP	Paga neto sipas Esig-25	Paga neto sipas subjektit	Diferenca
A. N.	144,200	13,699	2,451	14,846	113,204	114,233	(1,029)
N. M.	55,840	5,305	949	2,709	46,877	46,655	222
B. K.	144,200	13,699	2,451	14,846	113,204	114,233	(1,029)
S. M.	57,206	5,435	973	2,887	47,912	48,331	(419)
F. D.	137,900	13,101	2,344	14,027	108,428	108,859	(431)
S. Sh.	48,496	4,607	824	-	43,064	52,364	(9,300)
D. T.	64,068	6,086	1,089	4,429	52,464	42,965	9,499

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i dokumentave të bankës (urdhër shpenzimet e sigurimeve) sigurimet dhe tatimi i pagës për vitin 2024 janë paguar në vlerë 42,522,323 lekë, nga listpagesat e deklaruar në sistemin e tatimeve E-sig25 sigurimet dhe tatimi i pagës janë po në të njëjtën vlerë, subjekti nuk ka diferenca ose paguar kamatëvonesa, sipas tabelës më poshtë:

Tabela Nr. 36

Në lekë

Periudha	Sigurime, Tap të paguara	Të deklaruar në Esig25	Diferenca
Janar	3,057,686	3,057,686	-
Shkurt	3,071,008	3,071,008	-
Mars	3,061,402	3,061,402	-
Prill	3,141,081	3,141,081	-
Maj	3,241,132	3,241,132	-
Qershor	3,358,955	3,358,955	-
Korrik	3,846,874	3,846,874	-
Gusht	3,874,252	3,874,252	-
Shtator	3,912,907	3,912,907	-
Tetor	3,965,241	3,965,241	-
Nentor	3,994,444	3,994,444	-
Dhjetor	3,997,341	3,997,341	-
Totali	42,522,323	42,522,323	-

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi i dokumentave të bankës (urdhër shpenzimet e sigurimeve) sigurimet dhe tatimi i pagës për periudhën Janar – Qershor 2025 janë paguar në vlerë 23,809,036 lekë, nga listpagesat e deklaruar në sistemin e tatimeve E-sig25 sigurimet dhe tatimi i pagës janë po në të njëjtën vlerë, subjekti nuk ka diferenca ose paguar kamatvonesa, sipas tabelës më poshtë:

Tabela Nr. 37

Në lekë

Periudha	Sigurime, Tap të paguara	Të deklaruar në Esig25	Diferenca
Janar	3,893,348	3,893,348	-
Shkurt	3,889,599	3,889,599	-
Mars	4,009,916	4,009,916	-
Prill	4,004,235	4,004,235	-
Maj	4,017,147	4,017,147	-
Qershor	3,994,791	3,994,791	-
Totali	23,809,036	23,809,036	-

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Listprezencat janë mbajtur në mënyrë të rregullt për secilin muaj. Janë firmosur nga përgjegjësit e hidrovorëve dhe përgjegjësi i sektorit Hidrovor-Makineri, listprezencat e administratës të sektorëve janë firmosur nga përgjegjësit e sektorëve përkatës, listprezencia e administratës Fier është firmosur nga punonjësja e sekretari-arkivës dhe drejtori.

DUK Fier nuk ka procese gjyqësore të lidhura me punonjësit dhe me ish punonjësit.

Nga auditimi rezultoi se në lidhje me procedurat e rekrutimit nga institucioni nuk është përcaktuar mënyra se si veprohet në rastet e rekrutimit për vakancat që krijohen. Institucioni duhet të përcaktojë një plan të qartë rekrutimi ku kandidatët mund të shprehin interesimin për pozicionin përkatës sipas disa kriterëve të përcaktuara nga institucioni ku ndër elementet kryesorë të këtyre kriterëve është arsimi përkatës i cili duhet të përputhet me vendin e punës.

Nga auditimi me zgjedhje i 8 dosjeve të personelit për periudhën objekt auditimi dhe para kësaj periudhe, dokumentacioni në përgjithësi është i plotë. Pjesë përbërëse e dosjes janë kartat e identitetit, certifikatat familjare, dëftesa/diplomat e studimeve të kryera (fotokopje të noterizuara), listë notash, vërtetimet shëndetësore, kontratat e punës, librezat e punës, dëshmi penaliteti etj.

Llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” në shumën 201,385,594 lekë përfaqëson shpenzimet operative të kryera nga institucioni në funksion të aktiviteteve, konstatohet se nuk ka diferenca mes shpenzimeve të deklaruara në pasqyrat financiare dhe rakordimit me degën e thesarit.

Për vitin 2024 shpenzimet për mallra dhe shërbime janë klasifikuar sipas nën llogarive të klasës 602 si më poshtë:

Llogaria 6020 “Materiale zyre e te përgjithshme” në shumën 985,604 lekë paraqitur në pasqyrën e performancës si llogari sintetike. Nga auditimi i llogarisë analitike konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike.

Nga auditimi i llogarisë 6021 “Materiale dhe shërbime speciale” në shumën 78,633,656 lekë në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike.

Nga auditimi i llogarisë 6022 “Shërbime nga të tretë” në shumën 77,670,094 lekë në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike.

Nga auditimi i llogarisë 6024 “Shpenzime Udhëtimi” në shumën 1,598,200 në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike.

Nga auditimi i llogarisë 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në shumën 39,487,255 lekë në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike.

Nga auditimi i llogarisë 6027 “Shpenzime për detyrime per kompensime legale” në shumën 937,274 lekë në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike dhe përfaqëson shpenzime per detyrime të D|UK Fier sipas vendimeve te gjykatave.

Nga auditimi i llogarisë 6029 “Shpenzime të tjera operative” në shumën 2,073,511 lekë në pasqyrën e performancës konstatohet se rakordon me llogarinë sintetike.

Llogaria 6061 “Transferta të paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor” në shumën prej 2,881,000 lekë përfaqëson 5 shpërblim në vlerën 301,000 lekë me raste dalje në pension pleqërie, 1 rast vdekje në vlerën 90,000 lekë, dhe 166 shpërblime në fund të vitit për punonjësit me klasa në vlerë 2,490,000 lekë sipas të dhënave në vijim:

Tabela Nr. 38

Në lekë

Nr.	Emri punonjësit	Vlera e Shpërblimit	Lloji i Shpërblimit
1	H. H.	61,000	me rastin e dalies në pension pleqërie
2	F. T.	62,000	me rastin e dalies në pension pleqërie
3	M. Xh.	62,000	me rastin e dalies në pension pleqërie
4	K. K.	58,000	me rastin e dalies në pension pleqërie
5	L. M.	58,000	me rastin e dalies në pension pleqërie
6	Sh. Ll.	60,000	rast fatkeqësie vdekje anëtar i familjes
7	H. K.	30,000	rast fatkeqësie vdekje anëtar i familjes
Totali		391,000	

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi rezulton se është bërë kërkesa me nr. 33/1 prot datë 05.02.2024 nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier “Kërkesë për përdorimin e fondit të veçantë”, Ministrisë së Bujqësisë dhe

Zhvillimit Rural në zbatim të VKM nr. 929 datë 07.11.2010 i ndryshuar me VKM nr. 493 datë 06.07.2011 “Për krijimin e një fondi të veçantë” pika 7 e VKM, me rastin e daljes në pension pleqërie, pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar këtë kërkesë me shkresën nr. 1021/1 datë 06.03.2024, për ndihmën e menjëhershme me rast dalje ne pension për punonjës in e DUK Fier H.H.

Nga auditimi rezultoi se është bërë kërkesa me nr. 101/1 prot datë 02.04.2024 nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier “Kërkesë për përdorimin e fondit të veçantë”, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në zbatim të VKM nr. 929 datë 07.11.2010 i ndryshuar me VKM nr. 493 datë 06.07.2011 “Për krijimin e një fondi të veçantë” pika 7 e VKM, me rastin e daljes në pension pleqërie, pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar këtë kërkesë me shkresën nr. 2365/1 datë 16.04.2024 për ndihmën e menjëhershme me rast dalje ne pension për punonjës in e DUK Fier M.Hh., F.T.

Nga auditimi rezultoi se është bërë kërkesa me nr. 223/1 prot datë 02.07.2024 nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier “Kërkesë për përdorimin e fondit të veçantë”, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në zbatim të VKM nr. 929 datë 07.11.2010 i ndryshuar me VKM nr. 493 datë 06.07.2011 “për krijimin e një fondi të veçantë” pika 7 e VKM, me rastin e daljes në pension pleqërie, pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar këtë kërkesë me shkresën nr. 84/1 datë 17.07.2024 për ndihmën e menjëhershme me rast dalje ne pension për punonjës in e DUK Fier L.M., K.K.

Nga auditimi rezultoi se është bërë kërkesa me nr. 294 prot datë 17.09.2024 dhe nr. 294/1 prot datë 23.09.2024 nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier “rast fatkeqësie, vdekje anëtari të familjes”, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në zbatim të VKM nr. 929 datë 07.11.2010 i ndryshuar me VKM nr. 493 datë 06.07.2011 “për krijimin e një fondi të veçantë” pika 7 e VKM, me rastin e fatkeqësisë, vdekja e një anëtari të familjes, pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën 30,000 lekë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar këtë kërkesë me shkresën nr. 6342/1 datë 03.10.2024 për ndihmën e menjëhershme me rast dalje ne pension për punonjës in e DUK Fier Sh.L., H.K.

Tabela Nr. 39

Në lekë

Nr. Urdhër Shpenzimi	Data	Nr. Punëmarësish	Vlera e Shpërblimit	Total
296	31.12.2025	15	15,000	225,000
297	31.12.2025	26	15,000	390,000
298	31.12.2025	17	15,000	255,000
299	31.12.2025	108	15,000	1,620,000
Total		166		2,490,000

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi rezultoi se është dhënë urdhri nr. 409 datë 31.12.2024 “për dhënie ndihme financiare për punonjës in mbështetës” në zbatim të ligjit nr. 97/2023 për buxhetin e vitit 2024 i ndryshuar të VKM nr. 846 datë 26.12.2024, tu jepet shpërblimi në shumën 15,000 lekë të gjithë punonjësve mbështetës dhe punonjësve me kontratë të përkohshme mbi 6-muaj.

Ky urdhër është zbatua në mënyrë korekte.

Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve në bazë të institucioneve. Nga veprimet kontabël të bëra nga institucioni dhe të pasqyruar në pasqyrën

e performancës financiare ndryshimi i gjendjes është pasqyruar drejtë në shumën prej -5,837,231 lekë.

Analizimi i Llogarisë 602

Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime” përputhet me tabelën e shpenzimeve operative Janar-Dhjetor 2024 sipas tabelës më poshtë:

Tabela Nr. 40

Në lekë

Buxheti fakt Janar-Dhjetor 2024	191,023,474
Detyrimet e energjisë Dhjetor 2023	(8,207,262)
Detyrimet e energjisë Dhjetor 2024	18,569,382
Llogaria 602 pasqyra e performancës	201,385,594

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela e shpenzimeve operative janar – dhjetor 2024 u analizua zëri “blerje karburanti” me vlerë 57,049,368 lekë.

Është ngritur urdhri i brendshëm i drejtorit me nr. 14/3 datë 19.09.2023 “të gjithë sektorët bazuar shkresës së buxhetit të përpilojnë volumet që do të realizohen për vitet 2024-2025 dhe bazuar volumeve do të bëhet përlogaritja e fondit limit” për blerje karburanti. Janë nxjerrë normat e harxhimit të karburantit për m3 për mjetet e rënda.

Është bërë kërkesa me lëndë “blerje karburanti Gazoil 10 ppm” me nr. 14/5 datë 11.10.2023 drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara.

DUK Fier përmes kësaj procedure ka për qëllim blerjen e karburantit për mjetet e rënda, mjetet e transportit dhe hidrovoret për vitet 2024-2025 sipas tabelës më poshtë:

Tabela Nr. 41

Në lekë

	Plani/litra 2024-2025	Cmimi Plan	Vlera për 2024-2025
Mjetet e rënda	425,816	199	84,737,364
Mjete Transpotri	58,800	199	11,701,200
Emergjencia	20,000	199	3,980,000
Hidrovor, Shërbime te ndryshme	9,200	199	1,830,800
Totali	513,816		102,249,364

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Blerjet e Karburantit për vitin 2024 janë bërë sipas tabelës më poshtë:

Tabela Nr. 42

Në lekë

	Sasia/litra	Cmimi për litër	Vlera
gjendje karburanti 31.12.2023	16,030		
F.H. 2.dt13.03.2024	1,000	188	188,328
F.H.3.dt 20.03.2024	5,000	186	931,620
F.H.5.dt 29.03.2024	5,000	188	939,600
F.H.6.dt 02.04.2024	5,000	187	937,080
F.H.7.dt 03.04.2024	10,000	187	1,874,160

F.H.8.dt 11.04.2024	10,000	189	1,888,440
F.H.10 dt 22.04.2024	20,000	182	3,643,680
F.H.11 dt 02.05.2024	20,000	181	3,625,440
F.H.12 dt 07.05.2024	20,000	179	3,580,800
F.H.14 dt.27.05.2024	10,000	177	1,773,360
F.H.16 dt.04.06.2024	15,000	179	2,678,220
F.H.17 dt.04.06.2024	10,000	179	1,785,480
F.H.18 dt.18.06.2024	15,000	181	2,710,260
F.H.21 dt.02.07.2024	40,000	184	7,344,480
F.H.24 dt.20.09.2024	15,000	167	2,503,636
F.H.25 dt.23.09.2024	40,000	167	6,669,600
F.H.29 dt.05.11.2024	17,989	169	3,035,115
F.H.35 dt.13.12.2024	64,555	169	10,940,069
Blerje Totale	323,544		57,049,368
Blerje 2024+ Gjendje e mbetur nga 2023	339,574		

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

DUK Fier administron 10 mjete të rënda, 5 mjete ndodhen në Sektorin Fier, 3 mjete në Sektorin Lushnjë, 1 mjet në Sektorin Vlorë dhe 1 mjet në Sarandë. Mjetet e rënda të DUK Fier për vitin 2024 kanë konsumuar në total 251,175 litra naftë dhe kanë kryer punime për një sasi prej 887,088 m³.

Këto mjete kanë konsumuar dhe 2,276 litra naftë për lëvizje jashtë kantierit dhe për shërbime të ndryshme që i janë bërë këtyre mjeteve.

Mjetet e Sektorit Fier kanë kryer punime me 407,470 m³ dhe kanë konsumuar 107,437 litra naftë. Mjetet e Sektorit Lushnjë kanë kryer punime me 267,218 m³ dhe kanë konsumuar 82,103 litra. Mjetet e Sektorit Vlorë kanë kryer punime me 118,809 m³ dhe kanë konsumuar 32,166 litra. Mjetet e Sektorit Gjirokastrë-Sarandë kanë kryer punime me 93,591 m³ dhe kanë konsumuar 29,469 litra naftë.

Naftë e përdorur për lëvizjen e mjeteve të rënda vetë, dhe për shërbimet që i janë bërë këtyre mjeteve është 2,276 litra.

Sektorin Fier

Tabela Nr. 43

Nr.	Objekti	Manovratori	Mjeti	Norma për m ³	Sasia/Volumi realizuar m ³	Naftë lit. të konsumuar
1	K,kull K-13 Sheq	K. Gj.	F,Hitac	0.27	32,000	8,640
		I. C.	F,hitac	0.27	29,130	7,865
		E. B.	X,C,M,G	0.23	530	122
2	K,Kull Apendice e Re	K. Gj.	F,Hitac	0.27	26,360	7,117
		I. C.	F,hitac	0.27	36,960	9,979
		A. S.	X,C,M,G	0.24	17,600	4,224
3	Ndertim prite ne K,R,H	I. C.	F,Hitac	0.30	3,759	1,127
4	Kanali kull Bd-18 +183	A. S.	X/C.M.G	0.24	46,293	11,132
5	Kanali kullues Bd-8	I. C.	F Hitac	0.30	5,885	1,765
6	K,M,U	S. R.	X,c.M.G	0.24	4,460	1,070
7	Shtrati perbashket Hekal-Mollaj	I. C.	F,hitac	0.30	13,450	4,035
		E. B.	X,C,m g	0.24	6,663	1,600
8	K,k K-1 Kut	E. B.	X,C,M,G	0.23	2,480	570
9	K ujites Dega Cukas	E. B.	X,C,M,G	0.23	4,760	1,094
10	Rezervuari Kurjan	I. C.	F,Hitac	0.30	2,769	830

11	k,k Devijimi K-25	K. Gj.	F,Hitac	0.30	3,557	1,067
12	K,Kull k-9 libofsh	E. B.	X,C,M,G	0.22	31,175	6,983
13	k,kuf libofsh	S. R.	X,C,Mg	0.26	15,523	4,035
14	K.Ul fid Portez	S. R.	X,C,m,g	0.26	15,480	4,024
15	Perroi Vidhishtes	S. R.	X.C.M.G	0.26	8,433	2,192
		E. B.	X,C,M,G	0.25	13,306	3,326
16	K,K K-12 sheq	S. R.	X,C,M,G	0.26	3,269	850
17	Perroi Frashrit	I. C.	F,Hitac	0.30	1,550	465
18	K,K L,V A seman	E. B.	X,C,M,g	0.27	14,299	3,860
19	K,K K-15/A Zharrez	K. Gj.	F,Hitac	0.30	15,894	4,768
		I. C.	F,Hitac	0.30	8,481	2,544
20	Kolektor Kalinor	K. Gj.	F,Hitac	0.30	11,954	3,586
21	Kolektori Bitaj	A. S.	X,C,m,g	0.23	4,747	1,090
22	Portat e Selishtes	S. R.	X,C,M,G	0.28	11,963	3,350
		E. B.	X,C,M,G	0.28	14,740	4,127
Totali					407,470	107,437

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Sektori Lushnjë

Nr.	Objekti	Manovratori	Mjeti	Norma për m3	Sasia/Volumi realizuar m3	Nafte lit. të konsumuar
1	Knali ujites V4 dega Lushnje	Sh. Ll.	F,Hitac	0.33	6,997	2,300
2	Kanali ujites V2 dega Krutje	V B.	F,Hitac	0.31	15,317	4,672
3	Kanali ujites V1 Dega Terbuf	A S.	Hydomek	0.33	5,975	1,942
4	LUK3-4 Karavasta	V B.	F,Hitac	0.31	17,019	5,191
5	Kolektori Sejmenz	V B.	F,Hitac	0.30	14,810	4,517
6	KUL Dushk-Gramsh-Bicukas	V B.	F,Hitac	0.33	17,840	5,887
		Sh. Ll.	F,Hitac	0.33	18,740	6,187
7	KUL Golem	A S.	Hydomek	0.33	13,244	4,346
		Sh. Ll.	F,Hitac	0.30	12,139	3,702
		V B.	F,Hitac	0.31	5,777	1,762
8	Emisari Terbuf	A S.	Hydomek	0.31	63,397	19,399
		Sh. Ll.	F,Hitac	0.30	41,277	12,589
9	LUK3-4-6/1	E. B.	X,C,M,G	0.25	13,036	3,250
10	LUK1-13-10	V B.	F,Hitac	0.32	4,426	1,399
11	LUK1-13	S R.	X,C,M,G	0.25	5,242	1,300
12	LUK1-14/1	A S.	Hydomek	0.31	7,066	2,160
13	Em. H.Terbuf	Sh. Ll.	F,Hitac	0.31	2,950	900
14	Em.H.Karavasta	Sh. Ll.	F,Hitac	0.31	983	300
15	Em.KUL Grabian-Bicukas	Sh. Ll.	F,Hitac	0.31	983	300
TOALI					267,218	82,103

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Sektori Vlorë

Nr.	Objekti	Manovratori	Mjeti	Norma për m3	Sasia/Volumi realizuar m3	Nafte lit. të konsumuar
1	Kanali ujites Llakatund	Z. L.	F,Hitac	0.30	8,107	2,392
2	Kanali ujites Armen	Z. L.	F,Hitac	0.30	17,785	5,247
3	Vepra e marjes Llakat dhe Armen	Z. L.	F,Hitac	0.28	4,466	1,241
4	Vepra e marjes Llakatund	A. S.	X,C,M,G	0.25	12,129	3,033
5	Vepra e marjes Armen	A. S.	X,C,M,G	0.25	15,738	3,934
6	Kanali kullues KK3 Akerni	Z. L.	F,Hitac	0.28	10,626	2,953

7	KK2 Akerni	A. S.	X,C,M,G	0.25	20,606	5,152
8	KUL Qyteti, VI	A. S.	Hydomek	0.31	14,426	4,400
9	KUL Qyteti, VI	S. R.	X,C,M,G	0.25	13,260	3,315
10	K.K i dergimit Hidrovori Akerni	K. Gj.	F,Hitac	0.30	1,666	499
TOALI					118,809	32,166

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Sektori Gjirokastër – Sarandë

Nr.	Objekti	Manovratori	Mjeti	Norma për m3	Sasia/Volumi realizuar m3	Naftë lit. të konsumuar
1	Vepra e marjes ne lumin Kalase	N. Xh.	F,Hitac	0.32	5,731	1,806
2	Prroi i Navarices	N. Xh.	F,Hitac	0.32	16,545	5,295
3	K..komunikues liqeni Bufit-liq. Butrintit	N. Xh.	F,Hitac	0.30	9,948	3,034
4	Mbrojtje nga lumi Kalase	A. S.	Hydomek	0.32	15,000	4,800
5	KUL Xare(Mursi)	N. Xh.	F,Hitac	0.31	22,641	7,019
6	Kthim uji ne Ushq. Rezervuarit te Doftise	N. Xh.	F,Hitac	0.31	4,084	1,246
7	K K 2 Dopull	N. Xh.	F,Hitac	0.32	19,642	6,269
TOALI					93,591	29,469

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Janë analizuar disa dosje teknike mbi zbatimin e punimeve për të parë se si është menaxhuar konsumimi i karburantit për mjetet e renda.

Kanali K 13 Sheq-Grizë, ka dalë urdhri i drejtorit për kronometrimin me nr. 28/3-1 datë 07.04.2024 i përberë nga z. B. K. përgjegjës sektori, z. K. B. ekonomist, z. K. Z. Ing. Hidro, znj. E. B. topograf për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. K. Gj. që do punojnë në këtë kanal kullues. Grupi i inspektimit ka mbajtur një procesverbal në datën 07.04.2024 për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. K. Gj., ku e ka monitoruar për 2 orë pune dhe ka dalë në konkluzion se konsumi i naftës është 0.27 litra për 1 m3.

Ka dalë urdhri i drejtorit për kronometrimin me nr. 28/3-2 datë 07.04.2024 i përbër nga z. B. K. përgjegjës sektori, z. K. B. ekonomist, z. K. Z. Ing. Hidro, znj. E. B. topograf për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. I. Cj. që do punojë në këtë kanal kullues. Grupi i inspektimit ka mbajtur një procesverbal në datën 07.04.2024 për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. I. C., ku e ka monitoruar për 2 orë pune dhe ka dalë se konsumi i naftës është 0.27 litra per 1 m3.

2.Kanali. K. Apendice e re ka dalë urdhri i drejtorit për kronometrimin me nr. 28/3-5 datë 15.06.2024 i përberë nga z. B. K. përgjegjës sektori, z. K. B. ekonomist, z. K. Z. Ing. Hidro, znj. E. B. topograf për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. K. Gj. që do punojnë në këtë kanal kullues. Grupi i inspektimit ka mbajtur një procesverbal në datën 15.06.2024 për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. K. Gj., ku e ka monitoruar për 2 orë pune dhe ka dalë në konkluzion se konsumi i naftës është 0.27 litra për 1 m3. Ka dalë urdhri i drejtorit për kronometrimin me nr. 28/3-4 datë 15.06.2024 i përberë nga z. B. K. përgjegjës sektori, z. K. B. ekonomist, z. K. Z. Ing. Hidro, znj. E. B. topograf për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. I. C. që do punojë në këtë kanal kullues. Grupi i inspektimit ka mbajtur një procesverbal në datën 15.06.2024 për mjetin Fiat Hitaci me manovrator z. I. C., ku e ka monitoruar për 2 orë pune dhe ka dalë se konsumi i naftës është 0.27 litra per 1 m3. Ka dalë urdhri i drejtorit për kronometrimin me nr. 28/3-6 datë 12.07.2024 i përbërë

nga z. B. K. përgjegjës sektori, z. K. B. ekonomist, z. K. Z. Ing. Hidro, znj. E. B. topograf për mjetin XCMG me manovrator z. A. S. që do punojë në këtë kanal kullues. Grupi i inspektimit ka mbajtur një procesverbal në datën 12.07.2024 për mjetin XCMG me manovrator z. A. C., ku e ka monitoruar për 2 orë pune dhe ka dalë se konsumi i naftës është 0.23 litra për 1 m³.

Për lëvizjen e mjeteve të rënda vetë, dhe për shërbimet që i janë bërë këtyre mjeteve, ka dalë urdhri i drejtorit për kronometrimet dhe janë mbajtur procesverbalet e kronometrimet nga komisioni për secilin mjet.

Gjithashtu DUK Fier administron 6 mjete transporti (auto vetura) dhe 1 rimorkiator që përdoret për lëvizjen e mjeteve të rënda, DUK Fier ka konsumuar naftë dhe për mirëmbajtjen e hidrovorëve (për larje, pastrime me mjete të rënda etj.). Sasia totale që këto mjete kanë konsumuar në vitin 2024 është 29,772 litra.

Për llogaritjen e sasisë të naftës që këto mjete konsumojnë ka dalë urdhri i drejtorit me nr. 28/3-1 datë 31.01.2024 “për kronometrimin e mjeteve të transportit, llogaritjen e normës së harxhimit për km”. Komisioni për zbatimin e këtij urdhri është i përbërë nga 3 anëtare z. B. K. Ing. Mekanik, K. B. ekonomist, E. B. specialist.

Në zbatim të urdhrin të drejtorit janë mbajtur procesverbalet e kronometrimet për këto mjete transporti për 100 km udhëtim.

Dalja e naftës nga magazina është bërë në këtë mënyrë: i janë bërë kërkesat drejtorit nga Përgjegjësi i Sektorit me arsyen e lëvizjes dhe intenerarin që do të përshkruajë ky automjet, drejtori ka miratuar këtë kërkesë duke e firmosur. Janë bërë fletë udhëtimet e automjeteve ku është përcaktuar vendnisja, vendmbërritja, arsyeja e lëvizjes, urdhëruesi i lëvizjes, kilometrat e përshkruara dhe sasia e naftës e konsumuar.

Sasia e naftës e përdorur për hidrovorët për vitin 2024 është 3,546 litra. Kjo naftë është përdorur për shërbimet e ndryshme që i janë bërë hidrovorëve, pastrimi me mjet të rëndë nga papastërtitë etj. Për konsumin e kësaj sasive naftë janë bërë kërkesat nga Përgjegjësi i Sektorit Hidrovor-Makineri me arsyen përkatëse dhe janë miratuar nga drejtori.

Në lekë

	Jana	Shku	Mar	Prill	Maj	Qersh	Korri	Gush	Shtato	Teto	Nënto	Dhjetto	Totali
AA750 LO E. T.	349	330	438	555	653	292	557	710	550	770	427	652	6,283
AA240 CY B. K.	98	330	55	161	210	273	117	62	118	243	270	198	2,135
FR3083 B V. R.	100	70	110	232	150	-	140	180	120	430	200	240	1,972
VL4482B Rimorkiator V. B.	880	600	680	1,276	640	1,750	870	710	970	790	800	1,564	11,530
VL0342D V. H.	150	100	50	200	200	-	50	-	150	149	100	80	1,229
AA 435 DE F. D.	-	-	50	100	150	150	150	150	300	148	150	50	1,398
AA355DU O.S.	99	100	50	150	200	150	150	150	150	150	130	200	1,679
Hidrovoret (13 Hidrovore)	72	110	133	161	120	390	97	230	437	280	689	827	3,546
Total litra të konsumuara													29,772

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për vitin 2024 nga auditimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga drejtoria e financës e DUK Fier, sasia totale hyrje është 339,574 litra dhe sasia totale e konsumuar për këtë periudhë është 283,363 litra naftë. Gjendja e mbetur e naftës në datën 31.12.2024 është në sasinë 56,211 litra naftë e cila përpunohet me sistemin e karburantit.

Karburanti Janar – Qershor 2025.

Blerjet e Karburantit periudhën Janar-Qershor 2025 janë bërë sipas tabelës më poshtë:
Në lekë

	Sasia/litra	Cmimi për litër	Vlera
gjendje karburanti 31.12.2024	56,211		
F.H.Nr.1 dt 11.02.2025	5,000	174	871,140
F.H.Nr.2 dt 26.02.2025	20,000	177	3,545,760
F.H.Nr.3 dt 19.03.2025	15,000	168	2,517,660
F.H.Nr.4 dt 21.03.2025	15,000	168	2,517,660
F.H.Nr.5 dt 25.03.2025	5,000	168	840,120
F.H.Nr.6 dt 14.04.2025	15,000	161	2,413,620
F.H.Nr.8 dt 24.04.2025	20,000	162	3,237,360
F.H.Nr.9 dt 08.05.2025	15,000	159	2,381,040
F.H.Nr. Dt 10 20.2025	20,000	163	3,258,000
F.H.Nr.11 dt 05.06.2025	30,000	160	4,806,360
Blerje Totale	160,000		26,388,720
Blerje dei 30.06.2025+ Gjendje e mbetur nga 2024	216,211		

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Në vitin 2025 DUK Fier i janë shtuar dhe 2 mjete të rënda të reja.

Konsumi i naftës për mjetet e rënda për periudhën Janar – Qershor 2025 është 197,262 litra dhe këto mjete kanë kryer punime me një volum prej 711,009 m³. Këto mjete kanë konsumuar dhe 350 litra naftë për lëvizje jashtë kantierit dhe për shërbime të ndryshme që i janë bërë këtyre mjeteve.

Në lekë

Mjeti	Volumi realizuar	Karburant për mjetet e rënda						
		Normativa/m ³	Naftë/plan	Lëvizje e mjetit vetë	Shërbime	Totali	Furnizuar mag	Gjendje mjeti 30.06.2025
	1	2	3 =1x2	4	5	6=3+4+5	7	8=7-6
Fiat HitaciEX255 k. Gj. fier	81,295	0.30	24,365	0	0	24,365	24,365	0
Fiat HitaciEX256 l.c. fier	82,760	0.29	24,125	0	0	24,125	24,125	0
Fiat HitaciEX257 l.V. lush	56,986	0.32	17,960	0	0	17,960	17,960	0
Fiat HitaEX258 Sh.Ll. lus	68,051	0.31	20,980	0	0	20,980	20,980	0
Fiat HitaciEX259 Z.L. vlor	18,268	0.25	4,550	0	300	4,850	4,850	0
Fiat HitEX260 N.xh. sara	5,728	0.31	1,800	0	0	1,800	1,800	0
Hydromec B. S. lushnj	78,206	0.32	24,800	0	0	24,800	24,800	0
Esk XE 260 CLL S.R. fier	69,358	0.24	16,808	50	0	16,858	16,858	0
Esk XE 260 CLL A.S. fier	85,403	0.25	21,753	0	0	21,753	21,753	0
Esk XE 260 CLLE ,B. fier	88,918	0.25	21,814	0	0	21,814	21,814	0
Eks ri HYD VI	46,495	0.21	9,590	0	0	9,590	9,590	0

Eks ri HYD saranda	29,541	0.30	8,717	0	0	8,717	8,717	
Shuma			197,262	50	300	197,612	197,612	0

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Gjithashtu konsumimi i naftës për periudhën janar-qershor 2025 për mjetet e transportit (autoveturat), rimorkiatori dhe për mirëmbajtjen e hidrovorëve (për larje, pastrime me mjete të rënda etj.) DUK Fier ka konsumuar 16,621 litra.

Në lekë

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
AA750 LO E. T.	354	523	718	850	583	315	3,343
AA240 CY B. K.	162	237	166	231	122	300	1,218
FR3083 B V. R.	100		150	200	220	190	860
VL4482B Rimorkiator V.B	830	1,195	1,060	1,505	990	1,640	7,220
VL0342D V. H.	80	60	60	290	180	235	905
AA 435 DE F. D.	150	150	58	121	100	100	679
AA355DU O. S.	150	150	217	150	150	150	967
Hidrovoret (13 Hidrovore)	100	200	329	160	210	430	1,429
Totali litra të konsumuara							16,621

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Për periudhën janar-qershor 2025 nga auditimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga drejtoria e financës e DUK Fier, sasia totale hyrje është 216,211 litra dhe sasia totale e konsumuar për këtë periudhë është 214,233 litra naftë. Gjendja e mbetur e naftës në datën 30.06.2025 është 1,978 litra e cila korrespondon me sistemin e karburantit.

Si përfundim nga auditimi i shpenzimit të karburantit konstatohet se dalja e naftës nga magazina përgjithësisht është e dokumentuar në rregull, janë urdhrat e brendshëm për kronometrimin e mjeteve, kërkesat për lëvizje nga Përgjegjësit e Sektorëve, miratimi i lëvizjes së mjetit nga drejtori si dhe fletë udhëtimet e plotësuara.

Në disa raste për mjetet e transportit fletë udhëtimet kanë mangësi në plotësimin e tyre nga ana e përdoruesve të mjeteve.

Pasqyra e flukseve monetare (cash floë)

Pasqyra financiare e flukseve monetare jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme.

Nga auditimi i pjesës së dyte të pasqyrës së flukseve “Veprimtaritë e Investimeve” konstatohet se daljet e mjeteve monetare “Akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale” pasqyrohen në

shumën 264,422,151 lekë, ndërsa ne pasqyrën statistikore “Investimet dhe Burimet e investimeve” shpenzimet për investime pasqyrohen në shumën 264,277,162 leke. Konstatohet një diferencë në shumën 144,989 lekë. Efekti në pasqyrat financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosrakovit të plotë dhe të saktë të llogarive kontabël në pasqyrat financiare jep një pasqyrë jo të drejtë dhe të saktë të fluksit monetar të subjektit. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”, paragrafi 27 i SNKSP 1 “Paraqitja E Pasqyrave Financiare”. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimit të MF me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5

Nga auditimi i pjesës së fundit të tabelës së flukseve monetare konstatohet se “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” 2024 pasqyrohet në shumën 37,579,292 lekë është e njëjte me “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në fund të vitit 2023 e cila është në shumën 37,579,292 lekë.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto

Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit ushtrimor të mbyllur raportues.

Nga auditimi i “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto” konstatohet se të dhënat e kësaj pasqyre rakordojnë për totalin e fondeve neto me pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C. Nuk konstatohet mospërputhje midis këtyre llogarive.

Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit.

Nga auditimi i pasqyrës së investimeve dhe burimeve të investimeve konstatohet se kjo pasqyrë statistikore është e plotësuar në mënyrë të saktë, jap një pasqyrim të plotë të të gjitha transaksioneve që kanë ndodhur gjatë vitit lidhur me burimet e financimit dhe investimet.

Të dhënat e pasqyrës së Investimeve dhe Burimeve të Financimit raportuar nga subjekti në pasqyrat financiare janë si me poshtë:

në lekë

Ref e Llogarive	EMERTIMI	Teprica ne Fillim te Vitit	Transaksionet e vitit		Teprica ne Fund te vitit
			Debi	Kredi	
b	c	d	e	f	g
I.	SHPENZIMET PER INVESTIME		264,277,162	264,277,162	
230	Shpenzime per Aktive Afatgjata jo materiale				-
231	Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale		264,277,162	264,277,162	
25,26	Shpenzime per Aktive Afatgjata Financiare				
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet				
II.	BURIMET PER INVESTIME		264,277,162	264,277,162	
105	1.Grante te brendshme kapitale		264,277,162	264,277,162	
1050	Grante kapitale nga Buxheti				
1059	Grante te brendshme kapitale ne natyre				
1061	Nga institucione nderkombetare				
1069	Grante te huaja ne natyre				
11	4.Fonde te tjera te veta.				
111	Fonde rezerve				
115	Caktim fondi per investime nga rezultati I vitit				

12	Rezultat i mbartur			-			-
III.	BALANCA (II-I)		-	-		-	-

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit sipas parashikimeve të Paragrafit nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”

Më konkretisht:

Inventarizimi i vitit 2024:

Me Urdhrin e Drejtorit nr. 386 datë 03.12.2024 është ngritur urdhri i përbashkët për “Ngritja e komisionit të inventarizimit fizik për vitin 2024” dhe “nxjerrjen jashtë përdorimit”.

Për Sektorin Vlorë grupi i inventarizimit përbëhet nga V. H. (përgjegjës sektori), M. H., E. H., E. Q..

Për Sektorin Fier grupi i inventarizimit përbëhet nga E. K. (përgjegjës sektori), E. B., K. Z., V. Gj..

Për Sektorin Gjirokastër grupi i inventarizimit përbëhet nga O. Sh. (përgjegjës sektori), N. L., K. K..

Për Sektorin Lushnjë grupi i inventarizimit përbëhet nga F. D. (përgjegjës sektori), V. N., A.B., F.H..

Për Sektorin Lushnjë-Fier për Hidrovoret dhe mjetet e transportit grupi i inventarizimit përbëhet nga B. K. (përgjegjës sektori), K. B., K. B..

Për Sektorin Lushnjë-Fier-Gjirokastër për materjalet dhe për llogarinë 218 grupi i inventarizimit përbëhet nga A. N. (përgjegjës sektori), K. B., A. Dh., E. M..

Grupi për nxjerrjen jashtë përdorimit është i përbërë nga K. B., B. K., A. N., K. B., E. M., A. Dh.. Afati i inventarizimit do të jetë deri në datën 10.01.2025 për të gjitha objektet e inventarit.

Për aktivet e nxjerra jashtë përdorimit nga komisioni konstatohet se nuk është ndjekur procedura e përcaktuar në udhëzimin nr.30 seksioni “Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve” pika 109 “Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazine dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, gruposur ose djegur”.

DUK Fier për të gjitha objektet që ka në pronësi nuk disponon çertifikata pronësie.

Aplikimet e fundit për pajisje me çertifikata pronësie pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurisë të Paluajtshme janë bërë në vitet 2014-2015, para se të bëhej riorganizimi nga Bordet e Kullimit në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimi Fier.

Ish Bordi Lushnjë dhe ish Bordi Fier ka aplikuar pranë ZQRPP në vitet 2014-2015 vetëm për objektet (hidrovorët, zyrat jo për kanalet dhe objektet e tjera që disponon) dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ZQRPP. Ish Bordi Vlorë-Sarandë ka bërë vetëm një kërkesë ndaj ZQRPP- së në datën 16.04.2014 për vendosjen në dispozicion të hartave të pasurive. Ish Bordi Gjirokastrë nuk ka bërë asnjë aplikim pranë ZQRPP- së. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM 1108 datë 30.12.2015 “Për transferimin nga MBZHR dhe administrimit të ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe asetëve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”. Në tabelën më poshtë paraqiten vetëm 18 asete për objektet hidrovoret, zyrat, ofiçina dhe jo kanalet etj., të cilat janë pa certifikatë pronësoie në eër të DUK Fier:

Nr.	EMERTIMI	NR.I KARTELES	Hipotekuar	Aplikuar për Hipotekim	Data e aplikimit para bashimit të bordeve
1	Ndertesja Zyra + Oficina	97	Jo	po	15.12.2014
3	Hidrovori Terbuf	98	Jo	po	2015
4	Hidrovori Karavasta	99	Jo	po	2015
5	Hidrovori Divjake	100	Jo	po	2015
6	Hidrovori Hoxhara 1	101	Jo	po	15.12.2014
7	Hidovori Seman 2	102	Jo	po	15.12.2014
8	Hidrovori Hoxhara 3	103	Jo	po	15.12.2014
9	Hidrovori Sheqit	104	Jo	po	15.12.2014
10	Hidrovori Marinez	105	Jo	po	15.12.2014
11	Hidrovori Akerni	106	Jo	jo	-
12	Hidrovori Gorice	107	Jo	jo	-
13	Hidrovori Oriku	108	Jo	jo	-
14	Hidrovori Cuke	109	Jo	jo	-
15	Hidrovori Butrint	110	Jo	jo	-
16	Rezervuar Thana	-	Jo	jo	-
17	Rezervuar Kurjan-Strum	-	Jo	jo	-
18	Rezervuar Dofia	-	Jo	jo	-

Burimi: Pasqyra financiare Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier /Përpunuar nga Grupi i Auditimit

2.4.a. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Në zbatim të pikës Nr.6 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni elektronik i marrë nga sistemi i prokurimit elektronik në faqen elektronike të APP, si dhe dokumentacioni shkresor i ndodhur në dosjet e prokurimit pranë autoritetit kontraktor.

Për procedurat e prokurimit publik, me urdhrin nr.10 Prot., datë 07.01.2025, të titullarit të autoritetit kontraktor z. Th. S., me detyrë drejtor i DUK Fier, janë caktuar si persona përgjegjës për procedurat e prokurimeve publike: z. S. H., me detyrë specialist jurist në Sektorin Teknik Fier, si dhe znj. E. M., me detyrë specialiste juriste, në Sektorin e Financës.

1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i hidrovorit Oriku”, me fond limit 77,054,538 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2025 (REF-48856-05-23-2025).

<i>"Rikonstruksioni i hidrovorit Orikum", me fond limit 77,054,538 lekë pa TVSH REF-48856-05-23-2025</i>		
1.Urdhër Prokurimi. nr. 159/5 prot, datë 14.05.2025	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 159/5 prot, datë 14.05.2025: E. M. (P.Përgjegjës), K. B., F. D.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.159/6 prot, datë 14.05.2025:S. H., B. K., M. H.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur ", Punë		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 77,054,538 lekë pa TVSH (Midis kufirit të lartë dhe të ulët monetar)	6.Oferta fituese: BOE "V. & LI." SHPK, me vlerë 74,579,916 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 2,474,622 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 10.06.2025	9.Burimi Financimit: Buxheti shtetit	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender 3 OE b)S'kualifikuar: 2 OE c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.159/15 prot, datë 10.07.2025	15.Vlera e kontratës: 74,579,916 lekë pa TVSH, ose 89,495,899 lekë me TVSH	16. Nuk janë bërë likujdime

Procedura është pjesë e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike.

Kriteret e vlerësimit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Likuidimi: Sipas shkresës Nr. 1732/1 Prot., të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me lëndë "Mbi miratimin e detajimit të buxhetit 2025-2027 për shpenzimet kapitale, drejtuar Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, përcaktohet se për projektin "Rikonstruksion i hidrovorit Fier", llogaria ekonomike 231 (së bashku me mbikëqyrjen), likuidimi është parashikuar të kryhet për një periudhë 3 vjeçare: për vitin 2025 vlera 20,000 lekë, për vitin 2026 vlera 28,500,000 lekë dhe për vitin 2027 vlera 46,500,000 lekë. Aktualisht nuk janë kryer pagesa për kontraktorin.

Afati i realizimit të kontratës është 10 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës

Hartimi i fondit limit

Projekti i zbatimit për këtë investim fillimisht është hartuar që në vitin 2012, me porositës QTTB Fushë Krujë, hartues subjekti "S." SHPK. Nga AK u paraqit preventivi i ri, i hartuar mbi bazën e projektit të viti 2012, i cili paraqet ndryshimet në çmime dhe ndryshime të tjera teknike, për shkak të diferencës në kohë të këtyre dy dokumenteve. Preventivi i ri i hartuar nga subjekti "S." SHPK (ing. V. A.), ka zërat e punimeve, si dhe vlerat e tyre. Shumë totale e preventivit pa TVSH përbënë vlerën e fondit limit prej 77,054,538 lekë pa TVSH.

Hartimi kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit.

Me urdhrin e prokurimit nr. 159/5 prot, datë 14.05.2025 të titullarit të autoritetit kontraktor z. Th. S., është përcaktuar njësia e prokurimit, e përbërë nga znj. E. M. (P. Përgjegjës për prokurimin), me detyrë specialiste juriste, në Sektorin e Financës, z. K. B., inxhinier elektrik, me detyrë specialist në Sektorin Teknik Fier, z. F. D., inxhinier hidroteknik, me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Lushnje.

Në urdhrin e prokurimit është përcaktuar se njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Nuk është caktuar asnjë person si specialist i fushës në urdhrin e prokurimit.

Në zbatim të urdhrin të prokurimit, njësia e prokurimit ka hartuar procesverbalin Nr. 159/7 Prot., datë 21.05.2025, për argumentimin e kriterëve të veçanta për kualifikim. Lidhur me kriteret e veçanta të kapacitetit teknik, në kërkesat për fuqinë punëtore dhe mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës, në këtë procesverbal janë dhënë argumentime ligjore, por argumentimet teknike janë të përgjithshme. Këto argumentime teknike i janë paraqitur grupit të auditimit me observacion, pas përfundimit të fazës së auditimit në teren, **por theksojmë se këto argumentime teknike duhet të ishin bërë pjesë e procesverbalit që është mbajtur për këtë qëllim nga njësia e prokurimit:** znj. E. M. (P. Përgjegjës), z. K. B., z. F. D..

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr.159/6 Prot., datë 14.05.2025 nga titullari i AK z. Th. S. është përcaktuar KVO, e përbërë nga: znj. M. H. (kryetare), inxhinier hidroteknike, me detyrë specialiste në Sektorin Teknik Vlorë, z. S. H., jurist, me detyrë specialist në Sektorin Teknik Fier, z. B. K., inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Hidrovor Makinerive.

Nr	Operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	“A.” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	S’kualifikuar	L...I
2	BOE “V. & LI.” SHPK	74,579,916	Kualifikuar, fitues	L...S & K...K
3	“V.” SHPK	75,527,983	S’kualifikuar	K...L

-Nga auditimi u konstatua se OE “A.” SHPK nuk ka paraqitur ofertë, si dhe i vetmi dokument që ka dorëzuar është certifikata e rregjistrimit në QKB.

-Arsyet e s’kualifikimit nga KVO të OE “V.K.” SHPK:

-Nuk ka përmbushur piken e kriterëve të veçanta të kualifikimit ,pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.

Nga auditimi i DST u konstatua se në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumenteve të tenderit, në pikën 1.b, është përcaktuar se operatorët ekonomik duhet të paraqesin sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, u konstatua se OE “V.” SHPK nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës. Për këtë arsye s’kualifikimi nga KVO është i drejtë.

Gjithashtu KVO e ka s’kualifikuar OE “V.” SHPK edhe për arsyet në vijim:

-Nuk ka përmbushur piken 2.3.1 kriteret e veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument ku vërteton se O E ofertues ka realizuar punë të ngjashme me objektin e prokurimit (Hidrovor).

-Nuk ka përmbushur piken 2.3.8a, pasi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e kërkuara.

Nga auditimi nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve nga BOE “V. & LI.” SHPK.

2.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Transport aluvionesh ne kanale kulluese dhe punime mirëmbajtjeje, 31600m3(L- 4km)”, me fond limit 9,116,608 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2025 (REF-42696-03-27-2025).

“Transport aluvionesh ne kanale kulluese dhe punime mirëmbajtjeje”, me fond limit 9,116,608 lekë pa TVSH (REF-42696-03-27-2025)		
1.Urdhër Prokurimi. nr. 97/5 prot, datë 17.03.2025	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 97/5 prot, datë 17.03.2025: E. M. (P.Përgjegjës), E. K., K. Z.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.97/6 prot, datë 17.03.2025:S. H., K. B., F. D.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur e thjeshtuar”, Punë.		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 9,116,607 lekë pa TVSH (nën kufirin e ulët monetar, kufi i cili ka vlerën 12 ml lekë).	6.Oferta fituese: OE “Sh.” SHPK, me vlerë 8,448,200 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 668,407.50 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 07.04.2025	9.Burimi Financimit: Buxheti shtetit	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar: 1 OE c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.97/18 prot, datë 28.04.2025	15.Vlera e kontratës: 8,448,200 lekë pa TVSH, ose 10,137,840 lekë me TVSH	16. Likuiduar e gjithë vlera e kontratës

Kohëzgjatja e kontratës deri me 30.09.2025.

Procedura është pjesë e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike.

Kriteret e vlerësimit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Llogaritja e fondit limit: Në dosje ndodhet dokumenti “Relacion për vlerë kontrate” me lëndë “Mbi përlllogaritjen e vlerës së kontratës”, i miratuar nga titullari i AK z. Th.S., në të cilin është përshkruar se i gjithë dokumentacioni teknik i nevojshëm për këtë objekt (preventivi etj), janë hartuar nga Sektori Teknik DUK Fier, si dhe është thënë se vlera e fondit limit për këtë procedurë është 9,116,607 lekë pa TVSH. Bashkangjitur kësaj shkrese nuk është praktika e llogaritjes së fondit limit.

Hartimi kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit.

Me urdhrin e prokurimit Nr.97/5 prot, datë 17.03.2025 të titullarit të autoritetit kontraktor z. Th.S., është përcaktuar njësia e prokurimit, e përbërë nga znj. E. M. (P. përgjegjës për prokurimin), me detyrë specialiste juriste në Sektorin e Financës, z. E. K., inxhinier hidroteknik, me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Fier, z. K. Z., inxhinier ndërtimi, me detyrë specialist në Sektorin Teknik Fier.

Në urdhrin e prokurimit është përcaktuar se njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Për argumentimin e kritereve të vendosura në DST, njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin Nr. 97/7 Prot., datë 18.03.2025.

Në pikën 2.2.1 të seksionit të kapacitetit ekonomik dhe financiar është vendosur kriteri:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiros vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

-Në pikën 2.2.1 të seksionit të kapacitetit ekonomik dhe financiar është vendosur kriteri:

Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit dhe ky raport të mos jete me i vogël vlera e fondit limit.

Kriteri i mësipërm lidhur me vlerën e xhiros vjetore, paraqitjen e bilanceve, si dhe raporti midis aktivitetit dhe pasivitetit të mos jete me i vogël vlera e fondit limit (i pa shpjeguar dhe argumentuar kjo e fundit në procesverbalin e argumentimit të kërkesës për këtë vlerë të këtij raporti), nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 55 (Procedurë e hapur e thjeshtuar), pika 4, të VKM Nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, ku kërkohet që në procedurat e prokurimit të hapur e thjeshtuar, nga AK duhet të përcaktohen kritere të thjeshtuara, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe plotësimit i kërkesave ekonomike financiare, mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë (pra mund edhe të mos kërkohen pasqyrat financiare).

Në nenin 55, pika 4 thuhet:

Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimit i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Vlera e xhiros vjetore të kërkuar nga AK duhet të kishte qenë jo më e madhe se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës (fondit limit).

Në seksionin e kapacitetit teknik të DST, nga AK janë kërkuar 23 punonjës, si dhe një numër i caktuar mjetesh, midis të cilëve: 5 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton, 1 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton, 1 kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5-2 ton, 2 rimorkiator, 1 kokë tërheqëse, etj. Në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, nga njësia e prokurimit janë bërë argumentime ligjore, por nuk janë bërë pjesë e tij, argumentimet teknike lidhur me kërkesave për kualifikim që lidhen me kapacitetin teknik.

Çdo makineri e kërkuar në DST, duhet të argumentohet në lidhje me zërat konkret të preventivit, volumin e punimeve, orët e punës, grafikun e punimeve, etj.

Veprimet e mësipërme për mos argumentimin teknik të kriterëve të kapacitetit teknik, lidhur me makineritë, janë në mos përputhje me nenin 2 dhe 78 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 21 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku respektivisht thuhet:

Neni 2, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021: *Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;*

Neni 78, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021: *Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së*

prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

LPP, neni 21: Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

Për mangësitë e mësipërme ka përgjegjësi njësia e prokurimit, znj. E. M. (P. Përgjegjës), z. E. K., z. K. Z..

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr. 97/6 prot., datë 17.03.2025, të titullarit të AK z. Th. S., është ngritur KVO i përbërë nga z. F. D.(kryetar), inxhinier hidroteknik, me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Lushnje, z. K. B., ekonomist, me detyrë specialist finance, z. S. H., me detyrë specialist jurist në Sektorin Teknik Fier.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender:

Nr	Operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender	Vlera e ofertës pa TVSH në lekë	Kualifikimi nga KVO	NIPT
	BOE "A." & "I." SHPK	6,623,000	S'kualifikuar	L...A L...D
	"Sh." SHPK	8,448,200	Kualifikuar, fitues	K...N

Pas procesit të vlerësimit, KVO bazuar në nenin 84 të VKM 285, datë 19.5.2021, ka paraqitur për miratim titullarit të AK raportin përmbledhës Nr. 97/16 Prot., datë 18.04.2025, për vlerësimin e ofertave, në të cilin ka propozuar shpalljen fitues të OE "Sh." SHPK, si dhe s'kualifikimin e BOE "A." & "I." SHPK. Arsyet e s'kualifikimit nga KVO të BOE "A." & "I." SHPK janë: kjo është një ofertë anomalisht e ulët.

Nga auditimit konstatohet se: Bazuar në VKM Nr. 291, datë 15.5.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik", kreu II, pika 2.a, kufiri i ulët monetar në sektorin klasik, për procedurat e prokurimit për punë publike, është e barabartë ose më e madhe se vlera 12,000, 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë. Vlera e kësaj procedure është 9,116,607 lekë, pra nën kufirin e ulët monetar.

Referuar nenit 82, pika 4, paragrafi i parë: "Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur".

Në rastin konkret ka vetëm dy oferta, njëra prej të cilave e vlefshme dhe, për të vlerësuar vlefshmërinë e ofertës së dytë, përsa i përket vlerës anomalisht të ulët, kjo ofertë nuk duhet të jetë më e ulët se $25\% * 9,116,607 = 6,837,456$ lekë. Vlera e ofertës së paraqitur nga BOE "A." & "I." SHPK është 6,623,000, pra është ofertë anomalisht e ulët.

3.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "Mbrojtje e kanalit në dalje të hidrovorit Nr 3, Darzeze, Fier", zhvilluar në vitin 2024, me fond limit 28,745,937. (REF-08624-06-10-2024).

“Mbrojtje e kanalit ne dalje te hidrovorit Nr 3, Darzeze,Fier”, zhvilluar në vitin 2024, me fond limit 28,745,937. (REF-08624-06-10-2024)		
1.Urdhër Prokurimi. nr. 185/5 prot, datë 06.06.2024	3. Njësia e Prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 185/5 prot, datë 06.06.2024: E. M., S. H. (P.Përgjegjës), F. D.	4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: Urdhër nr.185/6 prot, datë 06.06.2025:E. K., K. B., K. B.
2.Lloji i Procedurës së Prokurimit: “E hapur”, Punë.		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 28,745,937 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese: BOE “A.” SHPK &“U.” SHPK, me vlerë 27,892,042 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 853,894 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit: 26.06.2024	9.Burimi Financimit: Buxheti shtetit	10.Operatoret Ekonomik a)Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar: 3 OE c) Kualifikuar 0 OE
11.Ankimime: AK: Nuk ka patur ankesa	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr.185/15 prot, datë 13.08.2024	15.Vlera e kontratës: 27,892,042 lekë pa TVSH, ose 33,470,450 lekë me TVSH	16. Likuiduar e gjithë vlera e kontratës

Kohëzgjatja e kontratës: 90 ditë nga hyrja ne fuqi e kontratës.

Kriteret e vlerësimit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Vlera e fondit limit ka dalë si rezultat i preventivit pjesë e projektit, të hartuar nga studio “H”, me projektues z. G. P.

Për projektin e kësaj procedure nuk është kryer oponencë teknike, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, ku është përcaktuar se:

“Neni 6. Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë;

c) objektet me akses publik. Me “objekte me akses publik”, sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku, pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadiume, markete etj.”.

Njësia e prokurimit

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit nga drejtori i DUK Fier z. Th. S., ka dalë urdhri i prokurimit në të cilin është përcaktuar njësia e prokurimit si vijon: znj. E. M., me detyrë specialiste juriste, S. H. (P. Përgjegjës), me detyrë specialist jurist në Sektorin Teknik Fier, z. F. D., inxhinier hidroteknik, me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Lushnje. Në urdhrin e prokurimit nuk është përcaktuar asnjë person si specialist i fushës.

- Në pikën 2.2.2 të seksionit të kapacitetit ekonomik dhe financiar, është vendosur kriteri:

Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet

të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet dhe ky raport të mos jete me i vogël vlera e fondit limit.

Njësia e prokurimit nuk ka shpjeguar dhe argumentuar kërkesën se: për 2 vite raporti i aktivitet dhe pasivitet të mos jete me i vogël vlera e fondit limit.

Në pikën 2.3.2/1 të seksionit të kapacitetit teknik, është kërkuar që OE të vërtetojnë se kanë licencat profesionale për ekzekutimin e kontratës, për kategoritë e mëposhtme të punimeve:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI		
1	NP-1-A	Punime gjurmimi në tokë.
2	N.P-5-A	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
3	N.P-6-A	Diga dhe tunele hidroteknike.
4	N.P-9-B	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
5	NP-12-A	Punime inxhinierike mjedisore
PUNIME SPECIALE		
8	NS-18-B	Punime topogjeodezike
9	NS-20-A	Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse dhe shpime per uje

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për argumentimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës, janë dhënë vetëm argumentime ligjore, pra është përshkruar baza ligjore që i jep të drejtë autoritet kontraktor, të kërkojë licenca profesionale për realizimin e kontratës, por nuk janë dhënë argumentime teknike, duke mos shpjeguar lidhjen teknike të secilës licencë profesionale, me zërat përkatës të preventivit.

- Janë kërkuar 2 licenca të nivelit “B” të punimeve, konkretisht licenca N.P-9-B “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime”, si dhe licenca N.S-18-B “Punime topogjeodezike”. Vlera në lekë e punimeve që i korrespondon nivelit “B” për secilën kategori punimi, është nga 21 milion deri 50 milion lekë, që do të thotë se duke marrë vlerën minimale të nivelit “B” të 2 licencave të kërkuara, pra vlerën 21 milion lekë, preventivi duhet të kishte zëra punimesh në vlerën 42 milion lekë, që lidhen drejtpërdrejtë me këto 2 licenca, N.P-9-B dhe N.P-9-B, por në fakt vlera totale e preventivit, ku përfshihen edhe licenca për punime të tjera, është 28.7 milion lekë, pra më e vogël se vlerë 42 milion lekë, gjë që tregon se përveç mungesës së argumentimit, në këto dy raste licencat e kërkuara tejkalojnë vlerën e punimeve që parashikohen në preventiv. Këto licenca, nëse do të argumentoheshin teknikisht se ishin të nevojshme, duhet të ishin përcaktuar për nivelin “A” (0-20 milion lekë). Për sa më sipër është në mos përputhje me kërkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja 4.

- Në pikën 2.3.2/2 dhe 2.3.4 të seksionit të kapacitetit teknik janë kërkuar 1 inxhinier mekanik dhe 1 teknik mekanik, por nga sa përshkruhet në zërat e preventivit, nuk vërtetohet lidhje e ngushtë e nevojës për inxhinier mekanik dhe teknik mekanik, me zërat e preventivit.

Kërkesa për licencat e nivelit “B”, si dhe kërkesa për 1 inxhinier mekanik dhe 1 teknik mekanik, janë në mospërputhje me kërkesat e nenit 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 39, pika 4&6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku respektivisht thuhet:

- neni 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike,

financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

- neni 39, pika 4&6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021: Pika 4: Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Pika 6: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

- Në pikën 2.3.2/2 dhe 2.3.4 të seksionit të kapacitetit teknik, nga njësia e prokurimit është kërkuar personeli kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

2 (dy) Inxhinier Ndërtimi

1(nje) Inxhinier Hidroteknik

1(nje) Inxhinier Mjedesi

1(nje) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaider

1(nje) Inxhinier Mekanik

1(nje) Ing Ndërtimi Gjeoteknik

1(nje) Ing Hidroteknik

2 (dy) Teknik ndertimi

1(nje) Teknik topograf/gjeodet

1(nje) Teknik mekanik

Për këto kërkesa lidhur me secilën tipologji/degë të inxhinierit të kërkuar, nuk janë dhënë argumente teknike për të shpjeguar lidhjen e çdo dege inxhinieri të kërkuar, me zërat konkret të preventivit. Gjithashtu nuk është argumentuar pse janë kërkuar 2 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier ndërtimi gjeoteknik dhe 2 teknik ndërtimi.

- Në pikën 2.3.3 të seksionit të kapacitetit teknik, nga njësia e prokurimit është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 75 (shtatëdhjetë e pese) persona. Në DST janë përcaktuar pozicionet e punës si dhe numri i punonjësve për secilin pozicion, dhe nga shuma e tyre numri total me gjithë punëtorinë e thjeshtë del 59. Është e paqartë diferenca prej 16 punonjës, roli i të cilëve në zbatimin e kontratës, është i pa përkrahur në DST.

- Në pikën 2.3.7 të seksionit të kapacitetit teknik, nga njësia e prokurimit është kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	5
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
5	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	3
6	Eskavator me zinxhir me krahe te gjate mbi 18m	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
7	Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1

8	Minieskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
9	Buldozer	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
10	Grejder (mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
11	Rimorkiator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
12	Autobot Uji	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
13	Autobetoniere	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	2
14	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
15	Dumper (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë	1
16	Vibrator Betoni	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	2
17	Betoniere kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
18	GPS	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
19	Kontinier Stacioner (zyra, ndrresa)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
20	Koke terheqese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
21	Autopompe Betoni	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1

Për mjetet e mësipërme të kërkuara nuk janë dhënë argumentime teknike

Veprimet e mësipërme për mos argumentimin teknik të kriterëve të kapacitetit teknik, nuk janë në përputhje me nenin 2 dhe 78 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 21 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku respektivisht thuhet:

Neni 2, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021: *Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;*

Neni 78, VKM Nr. 285 datë 19.05.2021: *Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

LPP, neni 21: *Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.*

Për mos hartimin e argumentimeve teknike për llojin dhe numrin e makinerive të kërkuara në tender, mbajnë përgjegjësi njësia e prokurimit: znj. E. M., z. S. H.(P.Përgjegjës), z. F. D..

Vlerësimi i ofertave

Me urdhrin nr.185/6 prot, datë 06.06.2025, të titullarit të AK z. Th.S., është ngritur KVO i përbërë nga E. K., nxhinier hidroteknik, me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Fier, z. K. B., ekonomist, me detyrë specialist finance, z. K. B., inxhinier elektrik, me detyrë specialist në Sektorin Teknik Fier.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender:

Nr	Operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi nga KVO	NIPT
1	BOE "A." SHPK & "U." SHPK	27,892,042	Kualifikuar, fitues	K...P &
2	"M." SHPK	28,454,643	Kualifikuar	L...C
3	"Sh." SHPK	28,741,461	Kualifikuar	K...N

KVO ka kualifikuar si të suksesshëm të tre operatorët ekonomik pjesëmarrës në tender dhe duke qenë se oferta ekonomike e BOE "A." SHPK & "U." SHPK ka vlerën më të vogël, i ka propozuar titullarit të AK shpalljen e tij fitues.

Nga auditimi nuk u konstatuan mangësi në plotësimin e kriterëve të DST nga BOE fitues.

4. Auditim i procedurës e prokurimit me objekt: "Riparim i argjinaturës së majtë të Lumit Seman" viti 2024.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, përfshirë dosjen fizike të procedurës, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e pasqyruara në sistemin elektronik të prokurimit (SPE), u evidentuan parregullsi që përbëjnë shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të cilat paraqiten si më poshtë:

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Riparim i argjinaturës së majtë të Lumit Seman" viti 2024 - REF-07768-06-03-2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.179/5, prot, datë 20.05.2024	2. Njësia e Prokurimit (NJP): S. H. E. M. E. K.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 179/6 prot, datë 20.05.2024. 1.M. H. (kryetare) 2.F. D. (anëtar) 3.K. Z. (anëtar)
2. Lloji i Procedurës : E Hapur/ Punë "Midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar"		
5. Fondi Limit: Vlera e pritshme e kontratës: 120,346,782 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese pa TVSH: M. SHPK 116,172.971 lekë	7. Diferenca me fondin limit: 4.173.811 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 19.06.2024	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 1 OE; 1 BOE b) S'kualifikuar: 1 BOE c) Kualifikuar: 1 OE 1."M." SHPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka

14. Data e lidhjes së kontratës: Datë 16.08.2024	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 139,407,565	16. Afati i kontratës: 4 muaj (120 ditë)
	17. Likujduar Datë 19.12.2024	18. Zbatimi i kontratës 28.10.2024-19.12.2024 51 ditë

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar një dosje e plotë dokumentacioni, sipas përcaktimeve ligjore, e pasqyruar në inventarin përkatës. Dokumentacioni përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës duke përfshirë të dhënat e përgjithshme dhe specifike, kërkesat kualifikuese, specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit.

Projekti

Projekti parashikonte ndërhyrje në dy zona kryesore: në segmentin Belinë, me gjatësi rreth 0.5 km ku ishin planifikuan vetëm riparime të pjesshme, dhe në segmentin pas Sektorit Seman, me gjatësi rreth 6 km, ku ishte parashikuar rehabilitim i plotë, ndërkohë që gjatësia totale e argjinaturës së majtë arrin në 44 km. Qëllimi kryesor i projektit ishte riaftësimi konstruktiv i argjinaturës për të garantuar funksionimin e saj të qëndrueshëm dhe sigurinë ndaj përmytjeve. Dokumentacioni i dorëzuar përfshinte projektin e zbatimit, relacionin teknik, specifikimet teknike, grafikun e punimeve, planimetritë, profilet gjatësore e tërthore dhe raportet topografike. Në projekt është cilësuar se segmenti i Belinës ishte përgjithësisht në gjendje të mirë dhe kërkonte vetëm punime mirëmbajtjeje, ndërsa segmenti i sektorit Seman, me gjatësi rreth 7.96 km, paraqitej i dëmtuar, me skarpata të gërryera, kurorë të deformuar dhe gjerësi të reduktuar të trupit të argjinaturës, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ndër vite. Zgjidhja teknike e propozuar konsiston në seksionimin e argjinaturës për kthimin në parametrat e projektuar, ndërtimin e 13 rampave dhe kalimeve të reja, rrugë shërbimi përgjatë argjinaturës dhe sigurimin e dherave nga zona shtetërore në afërsi. Në volumet e punimeve përfshiheshin gërmime dhe transport i konsiderueshëm dheu, mbushje dhe ngjeshje me shtresa 30 cm, rrafshime të skarpatave, ndërtim rrugësh ndihmëse, mbjellje bari në sipërfaqe rreth 170,600 m² dhe prerje bimësie mbi 127,000 m².

-Nga auditimi rezulton se, në lidhje me projektin e hartuar nuk është ngritur një komision i posaçëm për të materializuar një dokument zyrtar që konfirmon fondin limit, grafikun e punimeve dhe specifikimet teknike të hartuara nga projektuesi. Pra në praktikë nuk ka një akt-marrje në dorëzim, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e projektit, nëse projekti është i rregullt dhe i përmban të gjithë elementet e nevojshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Veprimet e kryera janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, neni 21 si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 5, 8, 9, 16, 19, 22.

- Në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nuk është hartuar dhe paraqitur raporti paraprak i VNM-së, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, neni 7 ku përcaktohet :

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit. 2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin: a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis; b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis. 3. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë: a) raporti paraprak i VNM-së, për projektet e shtojcës II; b) raporti i

thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës I. Si dhe bazuar VKM-në nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, Shtojcës 2 “Vlerësimin i Ndikimit në Mjedis” ku përcaktohen kërkesat, procedura, dhe llojet e projekteve për të cilat duhet hartuar raporti paraprak i VNM-së ku bën pjesë dhe ky projekt. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas hartimit të raportit paraprak merr vendimin përfundimtar për miratimin e projektit ose vijimin me VNM të thelluar.

-Në lidhje me opionencën teknike rezulton se nuk është hartuar akti i opionencës teknike nga Instituti i Ndërtimit, ku projektet që i përkasin fushës infrastrukturore dhe hidrike duhet ti nënshtrohen detyrimisht opionencës teknike, e cila ka për qëllim kontrollin e përputhshmërisë së projektit me detyrën e projektimit, normat teknike të ndërtimit, standardet dhe legjislacionin në fuqi. Në vendim përcaktohet se kontrolli teknik duhet të përfshijë elemente si qëndrueshmëria strukturore, zgjidhjet hidroteknike, preventivat etj. Veprime të cilat janë në kundërshtim me nenet 2, 3, 5, 7, 10 të VKM nr. 9, datë 11.1.2024, “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet ti nënshtrohen opionencës teknike ku përcaktohet : *Neni 2 Qëllimi Oponenca teknike ka për qëllim kontrollin e projektit në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë. Neni 3 Fushat për kryerjen e projektimit Oponenca teknike kryhet për studim-projektim në fushat: a) sociale, kulturore, shëndetësore, arsimore, shkencore, sportive dhe varreza; b) infrastrukturore; c) hidrike; ç) e transmetimit të energjisë; d) e rrjeteve inxhinierike; dh) e grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve; e) e banimit dhe shërbimit; ë) industriale; f) bujqësore; g) financiare; gj) administrative; h) akomoduese dhe çlodhjeje.*

-AK (NJP) në lidhje me **“Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”**:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të hartuara nga Njësia e Prokurimit me përbërje, S. H., E. K. dhe E. M., të evidentuara në procesverbalin përkatës, rezulton se në pjesën më të madhe janë formuluar në përputhje me kërkesat ligjore, duke u mbështetur në nenet 74 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të lidhura me objektin e kontratës.

Nga auditimi konstatohet se: në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave të veçanta të kualifikimit, konstatohet se për procedurën e prokurimit janë përgatitur dhe miratuar dokumentet standarde të tenderit (DST), specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, të cilat janë publikuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe janë nënshkruar nga Njësia Hartuese e Dokumenteve të Tenderit (NJHDT). Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe procesverbalit përkatës të përgatitur nga njësia e prokurimit, rezulton se në shumicën e rasteve kërkesat për kualifikim janë formuluar në përputhje të përgjithshme me bazën ligjore, duke iu referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në disa raste edhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008. Megjithatë, vihet re se në disa nga kriteret e përcaktuara janë vetëm të pasqyruara në mënyrë të përgjithshme, pa shoqëruar një argumentim teknik dhe ligjor të mirëfilltë për secilën kërkesë në disa raste. Baza ligjore së cilës i referohet NJHDT është pjesa e së drejtës që AK, ka për të parashikuar në kriteret e vendosura për nevojën e fuqisë punëtore, makinerive, licencat dhe të tjera mjete të nevojshme, ndërsa numri kërkuar nga AK për mjete, fuqi punëtore, licenca e etj, është detyrimi që ka AK për të argumentuar vendosjen e këtyre kriterëve.

-Në lidhje me afatin e dorëzimit të ofertave, konstatohet se NJP nuk e ka shtyrë afatin e dorëzimit të ofertave pas ndryshimeve të bëra në Dokumentet e Tenderit, si shkak i kërkesës së APP për rishikimin e disa kritereve. Më konkretisht, njoftimi i kontratës është shpallur më datë 04.06.2024 nga ku është përcaktuar afati i dorëzimit të ofertave deri më datë 19.06.2024, duke respektuar afatin minimal prej 15 ditësh, afat ky për procedurat ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar. Më datë 11.06.2024 Autoriteti Kontraktor ka kryer ndryshime në DT, ndryshim i cili përkon midis gjysmës së parë dhe gjysmës së dytë të afatit të dorëzimit të ofertave. Bazuar në nenin 75, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se : *Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.*

Në këtë rast, megjithëse ndryshimet janë bërë pikërisht në momentin që përkon me fillimin e gjysmës së dytë të afatit, autoriteti kontraktor nuk e ka shtyrë afatin e dorëzimit të ofertave, i cili ka mbetur 19.06.2024. Duke qenë se kërkesa për ndryshimin e kritereve ka përfshirë një numër të konsiderueshëm të tyre, autoriteti kontraktor duhej të shtynte afatin e dorëzimit të ofertave, në mënyrë që operatorëve ekonomikë t’u sigurohej kohë e mjaftueshme për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave. Mos zgjatja e afatit ka ndikuar në uljen e pjesëmarrjes pasi është reflektuar me një nivel të ulët ofertuesish ku kanë ofertuar vetëm 2 (dy) OE në një procedurë ku zakonisht numri i OE është shumë më i lartë. Kjo situatë lidhet me mos shtyrjen e afatit dhe kohën e pamjaftueshme për përgatitjen e ofertave. Veprimet e kryera janë në kundërshtim me nenin 75, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

-Nga shqyrtimi i kritereve të DT, rezulton se, nuk është përcaktuar si pjesë e kërkesave teknike, që për materialet kryesore, përfshirë dherat dhe zërat e tjerë me funksion strukturor ose mbrojtës, të kërkohen specifikime teknike të detajuara si prova laboratorike paraprake dhe raporte testimi të kryera sipas standardeve kombëtare ose ndërkombëtare përpara hapjes së ofertave. Autoriteti Kontraktor dhe NJP duhet të kishte parashikuar që operatorët ekonomikë ofertues të paraqisnin prova laboratorike dhe raporte testimi në mënyrë që vërtetojë që OE ofertues përmbushin specifikimet teknike duke garantuar në fazën e zhvillimit të procedurës. Gjithashtu gjatë zbatimit të kontratës, duhet të ishte përcaktuar frekuenca e testimit apo numri i testeve që duhet të kryhen për materialet e përdorura si psh numri i provave për njësi vëllimi, apo numri i provave për një sasi të caktuara materialesh, sipas standardeve përkatëse referuese. Mos parashikimi i prova laboratorike para hapjes së ofertave dhe mungesa e kërkesave të detyrueshme për testime periodike gjatë zbatimit të kontratës kufizon verifikimin teknik të materialeve në të gjitha fazat, duke rritur rrezikun që të përdoren materiale që nuk përmbushin standardet e kërkuara ose që nuk lidhen qartësisht me lotin/serinë e materialit të përdorur.

Veprimet e kryera janë në mos përputhje nenin **74**, nenin **77** të ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Neni **40**, neni **78**, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thotë “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJP me përbërje S. H., E. M., E. K.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NJP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, hyri në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në datën **19.06.2024**, sipas orarit të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), për të kryer hapjen zyrtare të ofertave.

KVO vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1.	“M.” SHPK me NIPT L...C	116 172 971 lekë	Kualifikuar/Fituesi
2.	BOE “B.” SHPK Nipti K...A “A.” SHPK Nipti L...V “2.” SHPK Nipti K...M	102 203 073 lekë	Skualifikuar pasi: Nuk plotësojnë disa kriteret të kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuara në DST. Konkretisht, nuk u vërtetua disponimi i specialistëve të kërkuar (teknik hidroteknik, teknik gjeolog/topograf, inxhinier ndërtimi gjeoteknik, koordinators për sigurinë në punë, drejtues transporti rrugor), si dhe punonjësve me dëshmi aftësie profesionale. Po ashtu, nuk u paraqitën certifikatat ISO të kërkuara, deklaratat për kontratat dhe vendndodhjen e mjeteve, si dhe nuk u provua disponimi i mjeteve teknologjike sipas specifikimeve (eskavatorë dhe dumper me dokumentacion të rregullt). Këto mangësi e bënë ofertën jo të vlefshme dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore e dokumentet standarde të tenderit.

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave, si dhe praktikës së administruar nga KVO, rezulton se KVO e ka konsideruar të rregullt dhe në përputhje me të gjitha kriteret e DT dokumentacion e dorëzuar nga OE “M.” SHPK duke e shpallur fitues të procedurës.

5-Auditim i procedurës së prokurimit me objekt: “Shkarje në kanalin ujitës VMK 2”, viti 2024.
Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, përfshirë dosjen fizike të procedurës, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e pasqyruara në sistemin elektronik të prokurimit (SPE), u evidentuan parregullsi që përbëjnë shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të cilat paraqiten si më poshtë:

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shkarje në kanalin ujitës VMK 2” viti 2024 REF-08186-06-05-2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.192/5, prot, datë 04.06.2024	2. Njësia e Prokurimit (NJP): 1.E. M. 2.F. D. 3.K. Z.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 192/6 prot, datë 04.06.2024. 1.S. H. (kryetare) 2.K. B. (anëtar) 3.O. S. (anëtar)
2. Lloji i Procedurës : E Hapur/ Punë “Midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar”		
5. Fondi Limit: Vlera e pritshme e kontratës: 37,967,343 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese pa TVSH: “Sh.”SHPK 37,779,210 lekë	7. Diferenca me fondin limit: 188,133 lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 21.06.2024 ndryshuar sipas shtojcës Datë 28.06.2024	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 1 OE; b) S’kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1 OE 1.“Sh.”SHPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Data e lidhjes së kontratës: Datë 06.08.2024	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 45,335,052 lekë	16. Afati i kontratës: 3 muaj

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar një dosje e plotë dokumentacioni, sipas përcaktimeve ligjore, e pasqyruar në inventarin përkatës. Dokumentacioni përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës duke përfshirë të dhënat e përgjithshme dhe specifike, kërkesat kualifikuese, specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Projekti

Projekti parashikonte ndërhyrje në kanalin ujitës VMK 2, në segmentin nga progresivi 12 600 ml deri në 12 765 ml, me gjatësi rreth 165 m, ku kanali ka dalë jashtë funksionit për shkak të aktivizimit të një rrëshqitjeje në faqen e kodrës “Kodra e Bajames”. Rrëshqitja, me gjatësi rreth 260 m dhe sipërfaqe afërsisht 32 700 m², ka bllokuar plotësisht kalimin e ujit duke ndërprerë furnizimin për tokat bujqësore përreth.

Qëllimi kryesor i projektit ishte riaftësimi dhe sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm të kanalit, përmes rehabilitimit të gjurmës ekzistuese, përfundimit të argjinaturave anësore dhe masave mbrojtëse për të shmangur aktivizime të mëtejshme të rrëshqitjes. Dokumentacioni i dorëzuar përfshin projektin e zbatimit, specifikimet teknike, grafikun e punimeve, profilin gjatësor dhe tërthor, preventivin dhe volumin e punimeve. Zgjidhja teknike e propozuar parashikon sistemimin e shtratit të kanalit, ndërtimin e mbështetjeve anësore me materiale të përshtatshme, përdorimin e

tubacioneve HDPE SN4 për kalimin e ujit dhe rivendosjen e parametrave hidroteknike sipas standardeve të projektimit. Punimet përfshijnë gërmime, mbushje, transport dherash, rrafshime të skarpatave dhe masa stabilizimi të terrenit, për të garantuar furnizimin e sigurt të rrjetit ujitës dhe mbrojtjen e tokave bujqësore të zonës.

-Nga auditimi rezulton se, në lidhje me projektin e hartuar nuk është ngritur një komision i posaçëm për të materializuar një dokument zyrtar që konfirmon fondin limit, grafikun e punimeve dhe specifikimet teknike të hartuara nga projektuesi. Pra në praktikë nuk ka një akt-marrje në dorëzim, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e projektit, nëse projekti është i rregullt dhe i përmban të gjithë elementet e nevojshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Veprimet e kryera janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, neni 21 si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 5, 8, 9, 16, 19, 22.

- Në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, nuk është hartuar dhe paraqitur raporti paraprak i VNM-së, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, neni 7 ku përcaktohet :

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit. 2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin: a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis; b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis. 3. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë: a) raporti paraprak i VNM-së, për projektet e shtojcës II; b) raporti i thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës I. Si dhe bazuar VKM-në nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, Shtojca 2 “Vlerësimin i Ndikimit në Mjedis” ku përcaktohen kërkesat, procedura, dhe llojet e projekteve për të cilat duhet hartuar raporti paraprak i VNM-së ku bën pjesë dhe ky projekt. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas hartimit të raportit paraprak merr vendimin përfundimtar për miratimin e projektit ose vijimin me VNM të thelluar.

-Në lidhje me oponencën teknike rezulton se nuk është hartuar akti i oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit, ku projektet që i përkasin fushës infrastrukture dhe hidrike duhet të nënshtrohen detyrimisht oponencës teknike, e cila ka për qëllim kontrollin e përputhshmërisë së projektit me detyrën e projektimit, normat teknike të ndërtimit, standardet dhe legjislacionin në fuqi. Në vendim përcaktohet se kontrolli teknik duhet të përfshijë elemente si qëndrueshmëria strukturore, zgjidhjet hidroteknike, preventivat etj. Veprime të cilat janë në kundërshtim me nenet 2, 3, 5, 7, 10 të VKM nr. 9, datë 11.1.2024, “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet të nënshtrohen oponencës teknike ku përcaktohet : *Neni 2 Qëllimi Oponenca teknike ka për qëllim kontrollin e projektit në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, si dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë. Neni 3 Fushat për kryerjen e projektimit Oponenca teknike kryhet për studim-projektim në fushat: a) sociale, kulturore, shëndetësore, arsimore, shkencore, sportive dhe varreza; b) infrastrukture; c) hidrike; ç) e transmetimit të energjisë; d) e rrjeteve inxhinierike; dh) e grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve; e) e banimit dhe shërbimit; ë) industriale; f) bujqësore; g) financiare; gj) administrative; h) akomoduese dhe çlodhjeje.*

-AK (NJP) në lidhje me **“Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”**:

Në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave të veçanta të kualifikimit, konstatohet se për procedurën e prokurimit janë përgatitur dhe miratuar dokumentet standarde të tenderit (DST), specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, të cilat janë publikuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe janë nënshkruar nga Njësia Hartuese e Dokumenteve të Tenderit (NJHDT). Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe procesverbalit përkatës të përgatitur nga njësia e prokurimit, rezulton se në shumicën e rasteve kërkesat për kualifikim janë formuluar në përputhje të përgjithshme me bazën ligjore, duke iu referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në disa raste edhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008. Megjithatë, në disa raste vihet re se kriteret e përcaktuara janë vetëm të pasqyruara në mënyrë të përgjithshme, pa shoqëruar një argumentim teknik dhe ligjor të mirëfilltë për secilën kërkesë në disa raste.

-Në procesin e hartimit të kriterëve të dokumenteve të tenderit (DT) konstatohet se Autoriteti Kontraktor ka kryer ndryshime dhe modifikime të shumta të kriterëve, të cilat janë bërë kryesisht mbi bazën e sugjerimeve të dhëna nga APP. Ky fakt tregon se kriteret fillestare nuk janë hartuar në mënyrë të saktë nga vetë autoriteti, duke dëshmuar mungesën e ekspertit të fushës në përbërjen e njësisë së prokurimit. Mungesa e përfshirjes së një specialisti të fushës, siç e parashikon neni 74, pika 2 e Vkm nr. 285, datë 19.05.2021.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Konstatohet se personi përgjegjës z. S. H. ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, hyri në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në datën **28.06.2024**, sipas orarit të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), për të kryer hapjen zyrtare të ofertave. Pas hapjes së ofertave në sistem, KVO vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1.	“Sh.” SHPK me NIPT K... N	37,779,210 lekë	Kualifikuar/Fitues

Referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave si dhe verifikimit në SPE rezulton se është paraqitur vetëm një ofertues të cilin KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues duke e konsideruar dokumentacionin e paraqitur si të rregullt dhe në përputhje me DT.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me objekt “Shkarje në kanalim ujitës VMK-2”, zhvilluar në vitin 2024, u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Në këtë procedurë prokurimi me NR-REF-08186-06-05-2024, zhvilluar në datën 28.06.2024, me afat zbatimi 3 muaj, operatori ekonomik “Sh.” SHPK i shpallur fitues, ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (SPE), konkretisht në seksionin D “Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”, të njëjtin staf teknik, drejtues teknik dhe të njëjtat mjete/makineri, që ka deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt “Mur mbajtës në kolektorin Roskovec–Hoxharë, Fier”, me NR-REF-07579-05-31-2024, për të cilën është shpallur fitues, zhvilluar më 18.06.2024 me afat zbatimi kontrate 4 muaj, ndërkohë që në formularin e vetëdeklarimit të secilin tender, është deklaruar në të dy rastet se këto kapacitete nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera publike.

Sipas Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit, e cila përcakton formularin standard të vetëdeklarimit, seksioni D i këtij formulari, është parashikuar posaçërisht për të pasqyruar disponueshmërinë reale të kapaciteteve teknike që OE zotëron për procedurën konkrete të prokurimit dhe nuk lidhet me kapacitetet në tërësi që ai zotëron, të cilat deklarohen në seksionet e tjera pararendëse të formularit. KVO nuk ka kërkuar sqarime dhe dokumente mbështetëse lidhur me mënyrën e deklarimit të këtyre kapaciteteve në rastin konkret. Në këtë kontekst, deklarimi i të njëjtave kapacitete teknike si të paangazhuara në dy procedura të zhvilluara paralelisht përbën deklarim të pasaktë dhe bie ndesh me funksionin dhe qëllimin e seksionit D të formularit standard të vetëdeklarimit, duke cenuar vlerësimin e saktë të përmbushjes së kriterëve të kualifikimit.

Veprimet e kryera janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 82, 92; VKM nr. 285, datë 19.05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 82.

Nga grupi i auditimit verifikimi i deklarimeve lidhur me angazhimin e stafit teknik, drejtuesve teknik, si dhe mjete dhe makinerive, për procedurën e prokurimit me objekt “Mur mbajtës në kolektorin Roskovec–Hoxharë, Fier”, me NR-REF-07579-05-31-2024, është bërë në sistemin e prokurimit elektronik, shtojca 8 “Formulari i vetëdeklarimit”, të paraqitur nga OE “Sh.” SHPK, i cili është shpallur fitues edhe në këtë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, deklarimet e operatorit ekonomik në seksionin D të formularëve përkatës rezultojnë të pasakta, në kundërshtim me nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje: S. H., K. B., O. S..

6- Auditim i procedurës së prokurimit me objekt: “Mbrotjtje nga Lumi Vjosë krahu i djathtë në Kashisht” viti 2024.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, përfshirë dosjen fizike të procedurës, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e pasqyruara në sistemin elektronik të prokurimit (SPE), u evidentuan parregullsi që përbëjnë shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të cilat paraqiten si më poshtë:

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Mbrotjtje nga Lumi Vjosë Krahu i Djathtë në Kashisht” viti 2024 - REF-03953-05-03-2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.150/5, prot, datë 03.05.2024	2. Njësia e Prokurimit (NJP): K. B. E. M. K. Z.	3. KVO: Nr. 150/6 prot, datë 03.05.2024. 1.F. D. (kryetar) 2.K. B. (anëtar) 3.S. H. (anëtar)
2. Lloji i Procedurës : E Hapur/ Punë “Midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar”		

5. Fondi Limit: 73,096,264 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese pa TVSH: “G.” SHPK 71,265.194 lekë	7. Diferenca me fondin limit: 1,831,070 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 24.05.2024	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 9 OE; 1 BOE b) S’kualifikuar: 7 OE ;1 BOE c) Kualifikuar: 2 OE 1. “G.” SHPK 2. “E.” SHPK
11. Ankimime AK: Nr. 33/1 prot, datë 25.06.2024	12. Përgjigje ankesës nga AK: Ka nr. 150/15 prot, datë 27.06.2024	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nr. 1704/8 prot, datë 04.07.2024
14. Data e lidhjes së kontratës: Nr.. 150/20, datë 16.08.2024	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 85,518,233	16. Afati i kontratës: (130 ditë)

a- Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar një dosje e plotë dokumentacioni, sipas përcaktimeve ligjore, e pasqyruar në inventarin përkatës. Dokumentacioni përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës duke përfshirë të dhënat e përgjithshme dhe specifike, kërkesat kualifikuese, specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Projekti

Projekti i hartuar nga H.A., në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit Fier, parashikon ndërhyrje mbrojtëse përgjatë segmentit të djathtë të lumit Vjosë, në afërsi të fshatit Kashisht, në kufirin midis bashkive Fier dhe Vlorë. Qëllimi kryesor i projektit ishte parandalimi i avancimit të gërryerjeve të tokave bujqësore dhe rehabilitimi i penelave ekzistues përgjatë një segmenti me gjatësi të përgjithshme rreth 295 metra.

Pas rievimit topografik dhe rikonjicionit në terren, u konstatua se një pjesë e penelit ekzistues paraqitet e dëmtuar dhe kërkon riparim dhe zgjatje nga zona e inkastrimit, ndërsa një tjetër segment me gjatësi rreth 70 metra paraqet gërryerje në formë harku dhe u klasifikua si zonë me emergjencë hidroteknike. Pjesa përreth është kryesisht tokë bujqësore pa ndërtime dhe në dy skajet kufitare situata paraqitet më e qëndrueshme. Zgjidhja teknike e propozuar konsiston në: Rehabilitimin e penelit ekzistues me mbushje të pjesëve të dëmtuara dhe zgjatje në drejtim të rrjedhës; Vendosjen e gabionave dhe gurëve natyralë për stabilizim të skarpateve dhe përshtatje me shtratin e lumit; Rimodelimin e bankinës dhe mbjelljen e barit natyral përgjatë vijës së mbrojtjes; Përdorimin e materialeve ekzistuese, për të shmangur ndikime në ekosistem.

Në pikën fikse reper të veprës (me kuotë 41.18 m dhe koordinata X=374579.96, Y=4495771.52) do të lidhen pikat e relievit të projektit, i cili është rievuar në tetor 2023 dhe do të shërbejë si bazë për zbatimin në terren.

Në aspektin gjeologjik dhe hidrologjik, terreni është përbërës aluvial–lagunor me kushte të mira inxhinierike ndërtimore, ndërsa klima mesdhetare e zonës karakterizohet nga reshje vjetore mesatare 901–951 mm dhe temperatura që variojnë nga 10°C në dimër deri 30–40°C në verë.

Përfshirja e të dy bashkive (Fier dhe Vlorë) synon bashkërendimin e masave mbrojtëse përgjatë segmentit të përbashkët të lumit Vjosë, për të garantuar stabilitetin e argjinaturave dhe mbrojtjen afatgjatë të tokave bujqësore.

Në vijim me shkresën nr. 150, prot., datë 02.05.2024, përgjegjësi i sektorit teknik, z. E. K., ka informuar dhe konfirmuar fondin limit të projektit në shumën 73,096,264 lekë pa TVSH, e cila i

korrespondon në vlerën 87,715,517 lekë me TVSH. Me shkresën me nr. 150/1 prot, datë 03.05.2024 është hartuar relacioni i cili konfirmon fondin limit të përlogaritur kryer nga projektuesi mbi bazën e projektit, preventivit dhe të gjithë dokumentacionit teknik të nevojshëm. Vlera e fondit limit e llogaritur në përfundim bazuar dhe në urdhrin e prokurimit

-AK (NJP) në lidhje me **“Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”**:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të hartuara nga Njësia e Prokurimit me përbërje, K. B., K. Z. dhe E. M., të evidentuara në procesverbalin përkatës, rezultojnë se në pjesën më të madhe janë formuluar në përputhje me kërkesat ligjore, duke u mbështetur në nenet 74 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të lidhura me objektin e kontratës.

Nga auditimi konstatohet se: në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave të veçanta të kualifikimit, konstatohet se për procedurën e prokurimit janë përgatitur dhe miratuar dokumentet standarde të tenderit (DST), specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, të cilat janë publikuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe janë nënshkruar nga Njësia Hartuese e Dokumenteve të Tenderit (NJHDT). Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe procesverbalit përkatës të përgatitur nga njësia e prokurimit, rezultojnë se në shumicën e rasteve kërkesat për kualifikim janë formuluar në përputhje të përgjithshme me bazën ligjore, duke iu referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në disa raste edhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008. Megjithatë, vihet re se kriteret e përcaktuara janë vetëm të pasqyruara në mënyrë të përgjithshme, pa shoqëruar një argumentim teknik dhe ligjor të mirëfilltë për secilën kërkesë në disa raste.. Baza ligjore së cilës i referohet NJHDT është pjesa e së drejtës që AK, ka për të parashikuar në kriteret e vendosura për nevojën e fuqisë punëtore, makinerive, licencat dhe të tjera mjete të nevojshme, ndërsa numri kërkuar nga AK për mjete, fuqi punëtore, licenca e etj, është detyrimi që ka AK për të argumentuar vendosjen e këtyre kriterëve.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, hyri në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në datën **24.05.2024**, sipas orarit të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), për të kryer hapjen zyrtare të ofertave.

KVO vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1.	E. me Nipt K...P	46,886,395 lekë	Arsyet e skualifikimit Dokumentacion të rregullt por Ofertë anomalisht të ulët Arsyet e skualifikimit: -Bazuar ne Ligjin Nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020“për prokurimin publik” Neni 27 Në procedurat e

			<i>prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët</i>
2.	G.. me Nipt J...V	71,265,194 lekë	Kualifikuar/Fituesi
3.	BOE: B. II Nipt L...O B. Nipt J...R B. Nipti J...V	43 253,458 lekë	<p><i>Arsyet e skualifikimit</i></p> <p><i>O.E B. II SHPK nuk ploteson kriteret e pikave 2.3.1 pika 1/b, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.7 dhe 2.3.9 te DST –ve, gjithashtu nuk disponon keto pika te licencave profesionale:</i></p> <p><i>NP- 9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime</i></p> <p><i>NP- 12 C Punime te inxhinierise se mjedisit</i></p> <p><i>NS- 9 B Punime Strukturore special</i></p> <p><i>B. SHPK perfaqesues ne BOE nuk disponon keto pika te licencave profesionale</i></p> <p><i>NP- 6 B Diga e tunele hidroteknike</i></p> <p><i>NP- 8 B</i></p> <p><i>Ndertimedetare dhe punimethellimi ne uje</i></p> <p><i>NP- 9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime</i></p> <p><i>NP- 12 C Punime te inxhinierise se mjedisit</i></p> <p><i>NS- 9 B Punime Strukturore speciale</i></p> <p><i>B. SHPK ,perfaqesues BOE nuk disponon keto pika te licencave profesionale</i></p> <p><i>NP- 6 B Diga e tunele hidroteknike</i></p> <p><i>NP- 8 B Nderitime detare dhe punime thellimi ne uje</i></p> <p><i>NP- 9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime</i></p> <p><i>NP- 12 C Punime te inxhinierise se mjedisit</i></p> <p><i>O.E B. paraqet nje pune te ngjashme me vlere =8,687,836,all mbrotje lumore,sipas kontrates se lidhur qe eshte 41% te fondit limit =29,969,468 all.</i></p>
4.	BOE: D. Nipti K...J F. Nipti K...C R.& H. Nipti L...U	45,086,422 lekë	<p><i>Arsyet e skualifikimit O.E</i></p> <p><i>D.SHPK ,nuk permbushet kriteri ne piken 2.3.2 te licencave profesionale te kerkuara ne DST</i></p>

			<p><i>Shoqeria D.SHPK lider e BOE dhe qe do te kryej 70 % te punimeve i mungon pika "NP- 8 B Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje".</i></p> <p><i>Shoqeria R. & H.perfaqesues e BOE –se qe dote kryeje 12% te punimeve i mungojne keto te licencaveprofesionale si me poshte NP- 6 B Diga e tunele hidroteknike NP- 8 B Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje NP- 9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime NP- 12 C Punime te inxhinierise se mjedisit NS- 9 B Punime Strukturore speciale NS- 18 B Punime topogjeodezike</i></p>
5.	<p>BOE: L. Nipti K...H I. Nipti L...D V. Nipti K...L</p>	48,041 882,70 lekë	<p><i>Arsyet e skualifikimit O.E L. SHPK qe eshte perfaqesuese e BOE nuk ka pune ngjashme nuk e permbush kete kriter pikat 2.3.1 ne DST</i></p> <p><i>O.E "L." SHPK qe eshte perfaqesuese e BOE dhe qe do te kryej 51 % te punimeve nuk ka keto pika te licencave profesionale (pikat 2.3.2 ne DST)</i></p> <p><i>NP- 5 B Punime nen tokesore,ura e vepraarti</i></p> <p><i>NP- 6 B Diga e tunele hidroteknike</i></p> <p><i>NP- 8 B Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje</i></p> <p><i>NP- 9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime</i></p> <p><i>NP- 12 C Punime te inxhinierise se mjedisi</i></p> <p><i>OE I.SHPK nuk ka keto pika te licencave profesionale (pikat 2.3.2 ne DST)</i></p> <p><i>NP- 5 B Punime nen tokesore,ura e vepraarti</i></p> <p><i>NP- 6 B Diga e tunele hidroteknike</i></p> <p><i>NP- 8 B Ndertime detare dhe punime thellimi ne uji</i></p> <p><i>NP- 9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime</i></p> <p><i>NP- 12 C Punime te inxhinierise se mjedisit</i></p>

			<p>NS- 9 B Punime Strukturore speciale</p> <p>NS- 18 B Punime topogjeodezike</p>
6.	BOE: C. Nipti K...V B. Nipti K...O	50 241 038 lekë	<p>Arsyet e skualifikimit O.E C.nuk ploteson kriteret 2.3.1 ne pikat 1/a dhe 1/b, kriteret 2.3.2 te DST –ve te procedures qe perbejne kushte per s'kualifikim nga kjo procedure.</p> <p>O.E C.nuk ka asnje pune te ngjashme.</p> <p>O.E "B.." SHPK ploteson 50% te vleres se kontrates per 5 vitet e fundit.</p> <p>O.E C."perfaqesuese e BOE SHPK nuk ka keto licenca profesionale</p> <p>NP- 6 B Diga e tunele hidroteknike</p> <p>NP- 8 B Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje</p> <p>NP- 9 C Punime dhe mbrotje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime</p> <p>NP- 12 C Punime te inxhinierise se mjedisit</p> <p>NS- 9 B Punime Strukturore speciale</p>
7.	BOE: E. Nipti K...I A. Nipti J...R	52 579 800 lekë	<p>Arsyet e skualifikimit Ne reference te kriterit 2.3.1 te DST –se ne kete prokurim E. SHPK nuk ka pune te ngjashme.</p> <p>Ne mbeshetete te DST-ve te O.E "Shoqeria E." SHPK nuk ploteson kriteret 2.3.1 ne pikat 1/a, 1/b te procedures "Mbrojtja nga lumi Vjose krahu djathte Kashisht</p>
8.	B.SHPK Nipti K...A	55 453 464	<p>Arsyet e skualifikimit O.E BE – IS SHPK ne informacionin mbi kapacitetin mbeshtetes deklarone qe do te mbeshtetet nga keto shoqeri;</p> <p>*Shoqeria "H." SHPK do ta mbeshtese me 34 punonjes ku 1 eshte mekanik &1 manovratore</p> <p>* Shoqeria "B." SHPK do ta mbeshtese me 20 punonjes ku 1 eshte teknik ndertim &1 shofer.</p> <p>*Shoqeri "Rr." SHPK Elbasan do ta mbeshtese me 3 punonjes dhe 2 shofera.</p> <p>Ne Seksioni Nr-2 Pika 2.16 "Mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera "DUK Fier specifikon "JO "subjekte</p>

			<p><i>mbeshtetes” .Persa me siper O.E “ B.” SHPK nuk ploteson kriteret e pikave 2.3.3,2.3.7 dhe 2.3.9 te DST –ve te procedures ”Mbrojtja nga lumi Vjose krahu djathte Kashishte,” qe perben kushte per s’kualifikim nga kjo procedure</i></p>
9.	P. Nipt K...M	59 204 381	<p><i>Arsyet e skualifikimit Operatori ekonomik “P. SHPK deklarone shtojcen nr -8 se P. SHPK dega Kosove eshte subjekt mbeshtetes dhe dege e shoqerise ne Shqiperi, e mbeshtet ne kapacitet njerzore. 1 Teknike ndertim & 1 Manovratore. , dhe ka te siguruar per muajet shkurt-prill 2024 perreth 144 punonjes. Ne mjete: Eskavator me goma – 2 cope, Fadrom me goma – 1 cope, Autopompe Betoni – 1 cope Sa me siper ne reference te kritereve te DST-ve te hartuara nga DUK Fier ,Seksioni Nr-2” Pika 2.16 “Mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera” , DUK specifikon “JO” subjekte mbeshtetes, gje e cila perben kushte per s’kualifikim te O.E P.SHPK ne kete procedure e prokurimit. Referuar pikes 2.3.2 te kerkesave ne DST mungun pika NP-6B(diga e tunele hidroulike) e licences Referuar pikes 2.3.9 te kerkesave ne DST mungojne 5 Manovratore dhe 3 shofera.</i></p>
10.	E. Nipt L...T	59 466 382	<p><i>Arsyet e skualifikimit Operatori ekonomik “ E.”SHPK deklarone shtojcen Nr -8 se do te mbeshtet ne kapacitet teknike nga shoqeria “ N. “ SHPK dhe nga shoqeri “N. “ SHPK ne kapacitet njerzore. Shoqeria “ N. “ SHPK e mbeshtet me kapacitetin teknik kategoria e licences dhe NP-6B (diga tunele hidroteknike) Shoqeri “N. “ SHPK e mbeshtet me kapacitet njerzore , Teknike ndertimi 1 (nje) ,Karpentier 1 (nje), Mekanik1 (nje)</i></p>

			<p><i>Ne referencë të kriterëve të DST-ve të hartuara nga DUK Fier të tenderit për procedurë të hapur publike me objekt; "Mbrotjtja nga lumi Vjose, krahu djathtë Kashishte. ne" Seksioni-2 Pika 2.16 "Mbeshtetja në kapacitetet e subjekteve të tjera", DUK specifikon "JO" subjekte mbeshtetes, gje e cila perben kushte për s'kualifikim se nuk permbush kekesat 2.3.2, dhe 2.3.7 në DST –te si dhe nuk permbush kriterin 2.3.1 të punëve të ngjashme, gje të cilat perbejne e kushte për s'kualifikim në këtë procedurë.</i></p>
--	--	--	--

Referuar vlerësimit të ofertave rezultoi se në përfundim është shpallur fituese oferta e OE "G." e konsideruar me dokumentacion të rregullt kualifikues.

7- Auditim i procedurës së prokurimit me objekt: "Mbrotjtja nga Lumi Shushicë në Drashovicë" viti 2024.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, përfshirë dosjen fizike të procedurës, procesverbalet e vlerësimit të ofertave, njoftimin e fituesit dhe të dhënat e pasqyruara në sistemin elektronik të prokurimit (SPE), u evidentuan parregullsi që përbëjnë shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", të cilat paraqiten si më poshtë:

a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Mbrotjtja nga lumi Shushicë në Drashovicë, Vlorë" viti 2024 - REF-21927-09-027-2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr.304, prot, datë 27.09.2024	2. Njësia e Prokurimit (NJP): K. Z. E. M. K. B.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 304/6 prot, datë 27.09.2024. 1.S. H. (kryetar) 2.F. D. (anëtar) 3.M. A. (anëtare)
2. Lloji i Procedurës : E Hapur/ Punë "Midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar"		
5. Fondi Limit: 38,914,025 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese pa TVSH: B." SHPK 38,247,720 lekë	7. Diferenca me fondin limit: 666,305 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 22.10.2024	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës: 3 OE;1 BOE b) S'kualifikuar: 1 OE;1 BOE c) Kualifikuar: 2 OE 1."B." SHPK 2. "LI." SHPK
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: Nuk ka
14. Data e lidhjes së kontratës: Datë 26.11.2024	15. Vlera e kontratës (me Tvsh): 45,897,264 lekë	16. Afati i kontratës: 2 muaj (60 ditë)

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Është organizuar një dosje e plotë dokumentacioni, sipas përcaktimeve ligjore, e pasqyruar në inventarin përkatës. Dokumentacioni përfshin të gjithë informacionin e nevojshëm për zhvillimin e procedurës duke përfshirë të dhënat e përgjithshme dhe specifike, kërkesat kualifikuese, specifikimet teknike dhe termat e referencës.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Projekti

Projekti ka për qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore dhe infrastrukturës rurale përgjatë krahut të majtë të lumit Shushicë në zonën e Drashovicës, ku janë evidentuar dëmtime të konsiderueshme të bregut si pasojë e prurjeve dhe gërryerjeve të përsëritura të lumit. Qëllimi kryesor është frenimi i gërryerjeve të mëtejshme dhe rivendosja e stabilitetit të shpatit të majtë për të garantuar siguri të qëndrueshme ndaj erozionit dhe ruajtjen e tokave bujqësore në këtë zonë.

Në kuadër të projektit janë planifikuar ndërhyrje mbrojtëse në një gjatësi prej rreth 280 metrash linearë, duke realizuar mbrojtje gjatësore me gurë në formë prizmi, të përmasave që variojnë nga 0.5 m³ deri 1.0 m³ secili. Zgjidhja teknike është konceptuar për t'u përshtatur me relievin dhe kuotat e terrenit, të cilat variojnë nga +51.8 m deri +50.82 m, me pjerrësi 0.0035. Pjerrësia e skarpatës së mbrojtjes është projektuar 1:1.5, ndërsa gjerësia minimale e mbrojtjes në kurore është 3.0 metra, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti strukturor i saj.

Pjesë e zgjidhjes inxhinierike është parashikuar ndërtimi i një bazamenti mbështetës në shtratin e lumit, me gjerësi 3 m dhe thellësi minimale 2 m, mbi të cilin do të vendosen gurët për mbrojtjen gjatësore. Punimet do të realizohen me ngjeshje dhe sistemim mekanik për të formuar prizmin mbrojtës me parametra konstruktivë të qëndrueshëm ndaj forcave hidraulike të lumit.

Dokumentacioni projektues përfshin të gjitha elementet teknike të domosdoshme për zbatimin, si planimetria dhe horografia në shkallë 1:1000, rilevimet topografike, profilet gjatësore dhe tërthore, si dhe pamje tip e prerje të penelave mbrojtëse të shoqëruara me volumet e punimeve dhe detajet përkatëse.

Në vijim me shkresën nr. 304, prot., datë 24.09.2024, përgjegjësi i sektorit teknik, z. E. K., ka informuar dhe konfirmuar fondin limit të projektit në shumën 38,914,025 lekë pa TVSH, e cila i korrespondon në vlerën 46,696,831 lekë me TVSH.

Me shkresën nr. 304/1, prot., datë 27.09.2024, është hartuar relacioni i cili konfirmon fondin limit të përlogaritur kryer nga projektuesi mbi bazën e projektit, preventivit dhe të gjithë dokumentacionit teknik të nevojshëm. Vlera e fondit limit e llogaritur në përfundim bazuar dhe në urdhrin e prokurimit është përcaktuar 38,914,025 lekë pa TVSH.

-AK (NJP) në lidhje me ***“Argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”***:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të hartuara nga Njësia e Prokurimit me përbërje, K. Z., K. B. dhe E. M., të evidentuara në procesverbalin TIP me nr. 304/7 prot, datë 27.09.2024 rezulton se në pjesën më të madhe janë formuluar në përputhje me kërkesat ligjore, duke u mbështetur në nenet 74 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të lidhura me objektin e kontratës.

Por pavarësisht sa theksuar më sipër nga auditimi konstatohet se: në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave të veçanta të kualifikimit, konstatohet se për procedurën e prokurimit janë përgatitur dhe miratuar dokumentet standarde të tenderit (DST), specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit, të cilat janë publikuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe janë nënshkruar nga Njësia Hartuese e Dokumenteve të Tenderit (NJHDT). Nga

shqyrtimi i dokumentacionit dhe procesverbalit përkatës të përgatitur nga njësia e prokurimit, rezulton se në shumicën e rasteve kërkesat për kualifikim janë formuluar në përputhje të përgjithshme me bazën ligjore, duke iu referuar ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në disa raste edhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008. Megjithatë, vihet re se kriteret e përcaktuara janë vetëm të pasqyruara në mënyrë të përgjithshme, pa shoqëruar një argumentim teknik dhe ligjor të mirëfilltë për secilën kërkesë në disa raste.. Baza ligjore së cilës i referohet NJHDT është pjesa e së drejtës që AK, ka për të parashikuar në kriteret e vendosura për nevojën e fuqisë punëtore, makinerive, licencat dhe të tjera mjete të nevojshme, ndërsa numri kërkuar nga AK për mjete, fuqi punëtore, licenca e etj, është detyrimi që ka AK për të argumentuar vendosjen e këtyre kriterëve.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:

Konstatohet se personi përgjegjës ka kryer administrimin e dokumentacionit të dosjes në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për prokurimin publik”.

Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve, KVO dhe NjP, mbi konfliktin e interesave.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, hyri në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) në datën **22.10.2024**, sipas orarit të përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST), për të kryer hapjen zyrtare të ofertave.

KVO vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta Lekë pa TVSH	Skualifikuar/Kualifikuar
1.	B. NIPT L...C	38,247,720 lekë	Kualifikuar/Fituesi
2.	“LI.”SHPK	38 366 685 lekë	Kualifikuar
3.	BOE D. Nipti L...B & Rr. Nipti K...H	25,868,409 lekë	<i>Arsyet e skualifikimit: BOE nuk plotëson piken 2.1.b tek kriteret e veçanta te kualifikimitNuk ka paraqitur, Sigurimin e Ofertes ,sipas shtojces 3. Bazuar ne Ligjin Nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020“për prokurimin publik” Neni 27 Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët</i>
4.	A. Nipti K...C	38 677 957 lekë	<i>Arsyet e skualifikimit : Operatori ekonomik nuk plotëson piken 2.1.b tek kriteret e veçanta te kualifikimit. Nuk ka paraqitur, Sigurimin e Ofertes ,sipas shtojces 3.</i>

Referuar vlerësimit të ofertave kryer nga KVO, nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE dhe dokumentacion fizik rezultoi se janë kualifikuar operatorët ekonomikë “Ll. SHPK” dhe “B.” SHPK duke konsideruar dokumentacion teknik të tyre si të rregullt dhe në përputhje me DT. Në përfundim bazuar në kriterin e vlerësimit “çmimi më i ulët” u shpall fituese oferta e OE “B.” SHPK.

8. Auditim i procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi i kanalit ujitës Llakatund, Vlorë”, viti 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës Llakatund - Vlorë”, zhvillimi i procedurës viti 2024, në lidhje zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i kanalit ujitës Llakatund, Vlorë”		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur REF-23932-10-10-2024	2 Njësia e Prokurimit E. M. A. B. M. H.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave S. H. K. B. F. D.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 80,049,623 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 76,846,770 lekë A.SHPK & B. SHPK & B.SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 3,202,853 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 17.10.2024	8. Burimi Financimit, Fondet e MM Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2B/OE b) S’kualifikuar 1 B/OE c) Kualifikuar 1 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 5 Muaj		

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit dhe përlogaritjes së fondit limit.

Në datën 17.10.2024, është publikuar në SPE procedura e prokurimit me referencë REF-23932-10-10-2024 me objekt “Rehabilitimi i kanalit ujitës Llakatund, Vlorë”

Njësia e prokurimit e caktuar me urdhrin e titullarit nr. 312/5, datë 07.10.2024, me përbërje znj. E. M., z. A. B. dhe znj. M. H.. Fondi limit në total është në vlerën 80,049,623 lekë, pa TVSH. Financimi i këtij objekti është parashikuar në Buxhetin e Shtetit.

Me anë të procesverbalit nr. 1, datë 08.10.2024, përlogaritet fondi limit dhe hartohen termat e referencës “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Me anë të urdhrin të titullarit nr. 312/6, datë 07.10.2024 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit të mësipërme, me përbërje z. S. H., z. K. B. dhe z. F. D..

b- Në lidhje me “Hartimin e Kritereve kualifikuese”:

Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (*specialisti i fushës*), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4 ku përcaktohet se: ... “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor

duhet të përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve...” Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se “...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”.

- Në pikën 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e cila përfshin kategoritë e mëposhtme.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit

N.P - 1	A	Punime gërmimi në tokë
N.P - 7	B	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje
N.P - 12	B	Punime të inxhinierisë mjedisore
N.S – 18	B	Punime topogjeodezike

Lidhur me licensat e mësipërme si argumentim A.K. ka paraqitur tabelën e mëposhtme në përmbajtje të D.S.T.

Kategoria e Licenses		Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1	A	Punime gërmimi në tokë	0-20 milion lekë
N.P - 7	D	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	21-50 milion lekë
N.P - 12	A	Punime të inxhinierisë mjedisore	21-50 milion lekë

-Në pikën 2.3.3 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 72 personave të siguruar për periudhën e 3 muajve të fundit si më poshtë:

Teknik ndërtimi	2	Diplomë shkollës mesme
Teknik Mekanik	1	Diplomë shkollës mesme
Teknik Topograf	1	
Karpertier	8	Dëshmi Profesionale
Hekurkthyes	4	Dëshmi Profesionale
Murator	5	
Saldator	3	
Automakinist	2	Dëshmi Profesionale
Shofer	4	Leje Drejtimi
Manovrator	2	Certifikate e Aftësisë Profesionale
Total	32	
Puntor të thjeshtë	20	

Inxhinier Ndërtimi	1	Diplome Universitare
Inxhinier Hidroteknik	2	Diplome Universitare
Inxhinier Mjedisi	1	Diplome Universitare
Inxhinier Gjeodet	2	Diplome Universitare
Total	6	

Nga zërbërthimi i zërave të preventivit rezulton se për realizimin e kontratës brenda grafikut nevojiten rreth 95 punonjës duke përfshirë staf teknik, specialiste etj. Duke qenë se OE mund të punojë dhe ditët pushim si dhe me orare të zgjatura brenda përcaktimeve ligjore NJP ka kërkuar një numër me të vogël punonjësish kjo dhe për të nxitur garën

Kërkesa e përcaktuar në dokumentet e tenderit për disponimin e të paktën 72 punonjësve, mbulohet vetëm nga numri i stafit teknik dhe atij mbështetës të parashikuar në kriteret e kualifikimit, pa përfshirë kategori të tjera punonjësish që janë domosdoshmërisht të nevojshëm për realizimin e plotë të punimeve në terren.

Në praktikë, për zbatimin e punimeve sipas preventiveve dhe për respektimin e afatit të kontratës, kërkohet një numër më i lartë punonjësish (punëtorë të thjeshtë, operatorë makinerish, punëtorë të specializuar, etj.), të cilët nuk janë kërkuar nga A.K.

Gjithashtu Operatorët Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
2	Autopompe Betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Buldozer	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Eskavator me zinxhir krahegjate mbi 18 m	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Fadrome (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Eskavator (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 3
8	Moto pompe uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Vibrator Betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Skeleri	në pronësi ose me qira	M2 100
12	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Cope 1
13	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Cope 2
15	Autovinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Rimorkiator per mjete te renda	në pronësi ose me qira	Copë 2
17	Pajisje gjeodezike tip Stacion total	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Pajisje gjeodezike tip GPS	në pronësi ose me qira	Copë 2
19	Dumper (mjet teknologjik me goma)	në pronësi / me qira	Copë 2
20	Kokore	në pronësi ose me qira	Copë 92
21	Jelek	në pronësi ose me qira	Copë 92
22	Tabela sinjalizuese kantieri	në pronësi ose me qira	Copë 4
23	Komplet i ndihmes se shpejte	në pronësi ose me qira	Copë 4
24	Kontenier ndërtimi levizshem (zyrë)	në pronësi ose me qira	Copë 1
25	Autobetonire	në pronësi ose me qira	Copë 4
26	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
27	Tranxhe per kthim hekuri	në pronësi ose me qira	Copë 2
28	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
29	Autobetoniere me kapacitet 2-3.5 m3 (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 2

Nga ana teknike, për një objekt të këtij lloji nuk është e argumentuar se përse kërkohet një numër kaq i madh mjetesh ndërtimi, sidomos që puna kryesore konsiston në gërmime, pastrim dhe rehabilitim të një kanali ujitës, që është një objekt pune lineare dhe jo një punë komplekse. Nuk ka asnjë analizë teknike që të tregojë se në cilat etapa të punimeve këto mjete do të përdoren, sa prej tyre do të ishin të nevojshme në të njëjtën ditë pune, ose nëse janë marrë parasysh kushtet reale të terrenit dhe intensiteti i punimeve. Gjithashtu, nuk paraqitet asnjë dokument që të lidhë sasinë e mjeteve me grafikun e punimeve apo me nevojën për të përfunduar objektin brenda afatit 5-mujor të kontratës.

2.3.11 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të jenë të certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesa për ISO 39001, e cila lidhet me menaxhimin e sigurisë së qarkullimit rrugor është licence e cila përdoret kryesisht për kompani transporti, autostrada apo sisteme rrugore, dhe jo për punime të kanalizimeve ujitëse në zonë rurale. Vendosja e saj nuk përputhet me natyrën e kontratës dhe nuk arsyetohet se pse do të ishte e domosdoshme për këtë objekt.

c-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 B/OE, për të cilët referuar procesverbalit përkatës të hapjes së ofertave 18.07.2022, KVO-ja ka kryer në SPE për vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

N r	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	I. SHPK & A.SHPK	59,452,985	S'Kualifikuar
2	A.SHPK & B. SHPK & B. SHPK	76,846,770	Kualifikuar/Fituesi

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar BOE I. SHPK dhe A.SHPK me arsyet e skualifikimit që BOE nuk ka përmbashur pikën 3.2.1 të kapacitetit teknik pasi anëtarë i BOE A. nuk ka paraqitur dokument provues për realizimin e punëve të ngjashme me objektin e prokurimit, por vetëm një kontratë mirëmbajtje/rikonstruksion të rrugëve automobilistike.

Si përfundim, në bazë të vlerësimi të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, kualifikohet BOE A.SHPK & B. SHPK & B. SHPK. me ofertë 76,846,770 lekë pa TVSH.

9.Auditim i procedurës së prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi i Kalasë (Kaskada e Shelegarit)”, vit 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Mbrojtja nga lumi i Kalasë (Kaskada e Shelegarit)”, zhvillimi i procedurës viti 2024, në lidhje zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mbrojtja nga lumi i Kalasë (Kaskada e Shelegarit)”		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur REF-01843-04-18-2024	2 Njësia e Prokurimit K. Z. E. M. O. S.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave S.H. E. K. F. D.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 43,300,377 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 41,090,342 lekë R. & N.	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,210,035 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 17.10.2024	8. Burimi Financimit, Fondet e MM Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 3B/OE b) S'kualifikuar 2 B/OE,

7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj	c) Kualifikuar 1 B/OE
--	-----------------------

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit dhe përlllogaritjes së fondit limit.

Në datën 07.05.2024, është publikuar në SPE procedura e prokurimit me referencë REF-01843-04-18-2024 me objekt “*Mbrojtja nga lumi i Kalasë (Kaskada e Shelegarit)*”

Njësia e prokurimit e caktuar me urdhrin e titullarit, me përbërje z. K. Z., znj. E. M. dhe z. O. S.. Fondi limit në total është në vlerën 43,300,377 lekë, pa TVSH. Financimi i këtij objekti është parashikuar në Buxhetin e Shtetit.

Me anë të urdhrin të titullarit “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit të mësipërme, me përbërje z. S. H., z. E. K. dhe z. F. D..

b- Në lidhje me “Hartimin e Kritereve kualifikuese”:

Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (*specialisti i fushës*), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4 ku përcaktohet se: ... “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve...*” Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se “*...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...*”.

NR.	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA
	1. PUNIME BETONI E BETONARMEJE		
1	Struktura monolite betoni me çakell C 25/30	m3	1196.72
2	Struktura te holla monolite betoni C 16/20	m3	312.0
	Shuma 1:		
	2. PUNIME HEKUR BETONI 3		
3	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	58.497
	Shuma 2:		
	3. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME		
4	Mbushje me gur kave	m3	122.925
5	Prishje struktura prej betoni	m3	98.7
	Shuma 3:		
	4. PUNIME GERMIMI		
6	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke	m3	858.0
7	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shk ne toke	m3	75.255

8	Germim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.	m3	25.0
	Shuma 4:		
	5. PUNIME SHITESASH		
9	Shtrese zhavor lumi t=15cm	m2	999.6
	Shuma 5:		

- Në pikën **2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e cila përfshin kategoritë e mëposhtme.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit

N.P - 1	A	Punime gjermimi në tokë
N.P - 9	B	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime
N.P - 12	A	Punime të inxhinierisë mjedisore
N.S – 9	B	Punime Strukturore speciale
N.S – 18	B	Punime topogjeodezike

Lidhur me licencat e mësipërme si argumentim A.K. ka paraqitur tabelën e mëposhtme në përmbajtje të D.S.T.

Kategoria e Licenses		Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1	A	Punime gjermimi në tokë	0-20 milion lekë
N.P - 9	B	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	21-50 milion lekë
N.P - 12	A	Punime të inxhinierisë mjedisore	0 -20 milion lekë
N.S – 9	B	Punime Strukturore speciale	21-50 milion lekë
N.S – 18	B	Punime topogjeodezike	21-50 milion lekë

Sipas legjislacionit përkatës, licencat e kategorisë B vlejné për vlera punimesh që nisin nga 21 milion lekë secila. Kjo do të thotë se vetëm për këto tre licenca, vlera minimale totale e punimeve që justifikojné kërkimin e tyre është:

3 licenca × 21 milion lekë = 63 milion lekë.

Ky prag minimal bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vlerën e fondit limit të procedurës, i cili është vetëm 43,300,377 lekë, një vlerë dukshëm më e ulët se minimumi i domosdoshëm që kërkojnë vetë licencat e kërkuara nga AK. Kjo mospërputhje bëhet edhe më e theksuar po të kemi parasysh se kërkohen edhe dy licenca të tjera (N.P–1 dhe N.P–12), të cilat shtojné më tej vlerën e detyrueshme të punimeve që duhet të justifikohen.

Në këto kushte, kërkesa e AK për një numër të tillë licencash të nivelit B nuk reflekton vlerën ekonomike të kontratës.

-Në pikën **2.3.3** Operatorët Ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 55 personave të siguruar për periudhën e 3 muajve të fundit si më poshtë:

Teknik Topograf	1	
Hekurkthyes	10	
Karpertier	10	Dëshmi Profesionale

Betonues	10	
Eskavatorist	7	
Buldozerist	3	
Automakinist	4	
Shofer	5	Leje Drejtimi
Total	50	
Inxhinier Ndërtimi	1	Diplome Universitare
Inxhinier Hidroteknik	1	Diplome Universitare
Inxhinier Mjedisi	1	Diplome Universitare
Inxhinier Gjeodet	1	Diplome Universitare
Inxhinier Gjeolog	1	
Total	5	

Nga zëbrthimi i zërave të preventivit rezulton se për realizimin e kontratës brenda grafikut nevojiten rreth 55 punonjës duke përfshirë staf teknik, specialist etj. Duke qenë se OE mund të punojë dhe ditët pushim si dhe me orare të zgjatura brenda përcaktimeve ligjore NJP ka kërkuar një numër më të vogël punonjësish kjo dhe për të nxitur garën.

Gjithashtu Operatorët Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-18 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Eskavator krah gjate deri ne 30 ml	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Eskavator krah gjate deri ne 18 ml	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Fadrome me Goma (kove perpara, kove mbrapa)	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Rul vibrues gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 18 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Rul vibrues gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 16 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Rul vibrues gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti deri 12 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Minieskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Mini fadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Autobetoniere kantieri 2.5-3.5 m ³	në pronësi ose me qira	Copë 3
13	Autobeniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Pajisje topografike-Sistemi Lidar scan 3D	në pronësi ose me qira	Cope 1
16	Vibrator betoni i jashtëm	në pronësi ose me qira	Copë 10
17	Vibrator betoni thellesie	në pronësi ose me qira	Copë 5
18	Vibrator ngjeshes(Tokmak)	në pronësi ose me qira	Cope 3
19	Pajisje per largimin e ujerave nentoksore me sistem gjilperthithese (Sistemi Ëell Point i paisur me pompe thithese,age ,kolektor dhe aksesor bashkues) thithese + tuba	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Gjenerator 75këa	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Depozitë Uji (5000 Litra)	në pronësi ose me qira	Copë 2
22	Konteiner stacioner zyre	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Impiant Betoni (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
24	Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

Kërkesat e Autoritetit Kontraktor për makineritë janë shumë më të larta në proporcion me vlerën e kontratës dhe kohëzgjatjes së saj. Lista e kërkuar përfshin disa kamionë, eskavatorë të madhësive të ndryshme, disa rula, makineri për beton, autobetoniere, nyje inertesh, impiant betoni, pajisje LIDAR 3D dhe madje edhe sistem Eell Point, të cilat zakonisht përdoren në punime të mëdha infrastrukturore me vlera të larta.

2.4.1. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- a. Certifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- b. Certifikatë ISO 45001–2018 mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë”,(e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim
- c. Çertifikatë ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim

Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kriter që operatori të ketë në dispozicion një Impiant Betoni të pajisur me leje mjedisore (kodi III.1.B), por në të njëjtën kohë nuk ka kërkuar që shoqëria të zotërojë licencën e detyrueshme nga Qendra Kombëtare e Licencimit për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve” (Kodi III.2.B), e cila lidhet drejtpërdrejt me funksionimin dhe aktivitetet e impiantit.

Po kështu, AK kërkon që operatori të ketë në dispozicion një Nyje Inertesh (me leje mjedisore kodi III.1.B), por nuk ka kërkuar që shoqëria të jetë e pajisur me licencën për “Ndikimi në mjedis, Auditim Mjedisor” (Kodi III.2.A – pika 1 dhe 2), e cila është licencë plotësuese dhe e domosdoshme për aktivitetet që lidhen me prodhimin e inertëve dhe ndikimin e tyre në mjedis.

c-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 B/OE, për të cilët referuar procesverbalit përkatës të hapjes së ofertave 07.05.2024, KVO-ja ka kryer në SPE për vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S’kualifikuar/ Kualifikuar
1	I.& A.	32,263,708	S’Kualifikuar
2	M.& S.	26,731,131	S’Kualifikuar
3	R. & N.	41,090,342	Kualifikuar/Fitues i

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

BOE I. SHPK dhe A. SHPK me arsyetimin që Operatori ekonomik A. SHPK nuk plotëson piken 3 **Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

-NP-1 A Punime gërmimi në tokë.

-NP-9 B Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

-NP-12A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

-NS-9 B Punime Strukturore speciale.

-NS-18 B Punime topogjeodezike.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

O.E. A. SHPK nuk ka dorëzuar ne SPE dokumentacionin vërtetues Licencë profesionale zbatimi.

O.E. I. SHPK nuk plotëson:

- pikën 3 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, nuk disponon në licencë kategorinë NS-18 B Punime topogjeodezike
- pikën 5 kriteret të veçanta për kualifikim, OE I. SHPK nuk ka dorëzuar në SPE deklaratë drejtuesi Teknik
- pikën 12 të DST” Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë vijon....”

Referuar shtojcës 8 Formulari përmbledhës i vet deklarimit BOE nuk ka deklaruar 1 (një) eskavator me goma, nuk ka deklaruar 2(dy) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 12-18 ton, ka deklaruar 1(një) auto betoniere kantieri 2.5-3.5 m3 me deklaratë doganore por nuk ka paraqitur të dhëna që mjete disponon targa/leje qarkullimi.

Gjithashtu BOE nuk plotëson pikën 12, ku mungojnë, 3 (tre) auto betoniere kantieri 2.5-3.5 m3.

Referuar akt-marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes ne % OE I. SHPK ka marrë përsipër të kryejë punime Struktura monolite betoni me çakëll C25/30 dhe mbushje inerte ndërsa në shtojcën 8 Formulari përmbledhës i vet deklarimit nuk ka deklaruar Nyje inerte (e pajisur me leje mjedisore kodi III.1.B).

BOE M. SHPK dhe S. SHPK me ofertë 26,731,131 lekë pa TVSH, me arsyetimin që bazuar ne Ligjin Nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020“për prokurimin publik” Neni 27 Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, kualifikohet OE R. SHPK & N. SHPK. me ofertë 41,090,342lekë pa TVSH.

10. Auditim i procedurës së prokurimit me objekt “Riparim i Argjinaturës Mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Riparim i Argjinaturës Mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”, zhvillimi i procedurës viti 2024, në lidhje zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riparim i Argjinaturës Mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur REF-11108-06-25-2024	2 Njësia e Prokurimit K. B. E. M. F. D.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave S. H. K. B. M. H.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 88,511,191 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 81,770,797 lekë S. SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 6,740,394 lekë

7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 21.06.2024	8. Burimi Financimit, Fondet e MM Buxheti i Shtetit	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 4B/OE b) S'kualifikuar 3 B/OE c) Kualifikuar 1 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 Muaj		

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit dhe përlllogaritjes së fondit limit.

Në datën 21.06.2024, është publikuar në SPE procedura e prokurimit me referencë REF-11108-06-25-2024 me objekt “Riparim i Argjinaturës Mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”

Njësia e prokurimit e caktuar me urdhrin e titullarit nr. 210/5, datë 24.06.2024, me përbërje z. K. B., znj. E. M. dhe z. F. D.. Fondi limit në total është në vlerën 88,511,191 lekë, pa TVSH. Financimi i këtij objekti është parashikuar në Buxhetin e Shtetit.

Me anë të procesverbalit nr. 210/7, datë 24.06.2024, përlllogaritjet fondi limit dhe hartohen termat e referencës “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Me anë të urdhrin të titullarit nr. 210/6, datë 24.06.2024 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit të mësipërme, me përbërje z. S. H., z. K. B. dhe znj. M. H..

b- Në lidhje me “Hartimin e Kritereve kualifikuese”:

Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (*specialisti i fushës*), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4 ku përcaktohet se: ... “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve...” Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se “...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

- Në pikën 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e cila përfshin kategoritë e mëposhtme.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit

N.P - 1	A	Punime gërmimi në tokë
N.P - 9	D	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime
N.P - 12	C	Punime të inxhinierisë mjedisore
N.S – 18	B	Punime topogjeodezike

Lidhur me licensat e mësipërme si argumentim A.K. ka paraqitur tabelën e mëposhtme në përmbajtje të D.S.T.

Kategoria e Licenses		Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1	A	Punime gjurmimi në tokë	0-20 milion lekë
N.P - 7	D	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	21-50 milion lekë
N.P - 12	A	Punime të inxhinierisë mjedisore	21-50 milion lekë

Në DST, për kërkesat e licencave profesionale (N.P-1, N.P-7 dhe N.P-12), vlerat e punimeve të lidhura me secilën kategori janë paraqitur në formë intervalesh, si p.sh.:

-N.P-1: 0–20 milion lekë

-N.P-7: 21–50 milion lekë

-N.P-12: 21–50 milion lekë

Megjithëse tabela paraqitet si argumentim për përshtatjen e licencave me zërat e punimeve, përdorimi i vlerave në formë intervale nuk përputhet me praktikën standarde të përlllogaritjes së preventivit. Sipas kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore, vlerat e punimeve që lidhen me licencat duhet të jenë fikse, të sakta dhe të mbështetura mbi preventivin zyrtar, dhe jo të paraqiten në mënyrë të përafërt ose të përgjithshme.

-Në pikën **2.3.3** Operatorët Ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 36 personave të siguruar për periudhën e 3 muajve të fundit si më poshtë:

Teknik ndërtimi	2	Diplomë shkollës mesme
Teknik Topograf	1	
Teknik Hidroteknik	1	
Teknik i mesëm Gjeolog	1	
Specialist Ndërtimi	4	
Karpertier	3	Dëshmi Profesionale
Eskavatorist	5	
Automakinist	2	Dëshmi Profesionale
Buldozerist	2	
Shofer	10	Leje Drejtimi
Total	31	

Inxhinier Ndërtimi	1	Diplome Universitare
Inxhinier Hidroteknik	1	Diplome Universitare
Inxhinier Mjedisi	1	Diplome Universitare
Inxhinier Gjeodet	1	Diplome Universitare
Inxhinier Gjeolog	1	
Total	5	

Nga zberthimi i zërave të preventivit rezulton se për realizimin e kontratës brenda grafikut nevojiten rreth 36 punonjës duke përfshirë staf teknik, specialiste etj. Duke qenë se OE mund të punojë dhe ditët pushim si dhe me orare të zgjatura brenda përcaktimeve ligjore, NJP ka kërkuar një numër me të vogël punonjësish kjo dhe për të nxitur garën.

Kërkesa e mësipërme për të pasur të paktën 72 punonjës mbulohet vetëm nga numri i stafit teknik dhe atij mbështetës të parashikuar në dokumentet e tenderit, pa përfshirë kategori të tjera punonjësish që janë të domosdoshëm për zhvillimin normal të punimeve në kantier.

Në praktikë, për realizimin e plotë të punimeve sipas preventiveve dhe për të përmbushur afatin e kontratës, nuk mjafton vetëm stafi teknik, por kërkohen gjithashtu punëtorë të thjeshtë, operatorë makinerish, punëtorë të specializuar, brigadierë dhe personel shtesë në terren, të cilët nuk janë përfshirë në këtë numër minimal të kërkuar.

Gjithashtu Operatorët Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetshkarkues jo me te vogel se 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 6
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
3	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5-7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
5	Eskavator me zinxhir krahegjate mbi 18 m	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Fadrome (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Eskavator (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 4
8	Dumper (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	Copë 3
9	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Rrul vibrues min.15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Piaster ngjeshese, vibruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Rrul me dhembe min.10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Buldozer min. 15 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
14	Minifadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Cope 2
16	Autovinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Rimorkiator per mjete te renda	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Pajisje gjeodezike tip Stacion total	në pronësi ose me qira	Copë 2
19	Pajisje gjeodezike tip GPS	në pronësi ose me qira	Copë 2
20	Aparatura për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metode me goditje (me pjate).	në pronësi / me qira	Copë 1
21	Mjet bujqesor me agregat per prerjen e bimesise	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Kokore	në pronësi ose me qira	Copë 75
23	Jelek	në pronësi ose me qira	Copë 75
24	Tabela sinjalizuese kantieri	në pronësi ose me qira	Copë 4
25	Komplet i ndihmes se shpejte	në pronësi ose me qira	Copë 4
26	Kontenier ndërtimi levizshem (zyrë)	në pronësi ose me qira	Copë 1
27	Drage -Ponton Germimi pajisur me eskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1

28	Pompe thithese me kapacitet mbi 200 m ³ /h	në pronësi ose me qira	Copë 2
----	---	------------------------	-----------

Lista aktuale e mjeteve është e plotë dhe mbulon pothuajse të gjitha kërkesat kryesore për punime ndërtimi, gjurmimi, transporti dhe shërbime teknike. Megjithatë, disa prej mjeteve të renditura mund të konsiderohen jo thelbësore dhe të pa arsyetueshme. Për shembull, rimorkiatori për mjete të rënda në dy copë mund të jetë i tepërt, pasi zakonisht mjafton një i vetëm për lëvizjen e makinerive të mëdha. Po ashtu, tre dumper me goma janë më shumë sesa kërkohet në shumicën e punimeve të zakonshme, përveç rasteve kur punohet në terrene shumë të vështira. Pajisjet gjeodezike në total katër njësi (dy Total Station dhe dy GPS) janë gjithashtu një numër i lartë, pasi zakonisht një stacion total dhe një GPS janë të mjaftueshëm për pjesën më të madhe të projekteve. Edhe autovinci apo minifadroma nuk janë të domosdoshme në çdo lloj kantieri, përveçse në punime shumë specifike.

c-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 B/OE, për të cilët referuar procesverbalit përkatës të hapjes së ofertave 18.07.2022, KVO-ja ka kryer në SPE për vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

N r	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S’kualifikuar/ Kualifikuar
1	S. SHPK	81,770,797	Kualifikuar/Fituesi
2	S. SHPK	82,232,530	S’Kualifikuar
3	Sh. SHPK	84,282,550	S’Kualifikuar
4	F. SHPK	-	S’Kualifikuar

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. F. SHPK me arsyet e s’kualifikimit që O.E nuk ka paraqitur oferte ekonomike. Ka paraqitur vetëm dokumentin “Ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”
2. Sh. SHPK me arsyet e s’kualifikimit që O.E nuk plotëson kriterin 2.3.2 ne licencat profesionale te shoqërisë mungon pika e licencës NP-9D “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidrolike dhe bonifikime.” Nuk plotëson kriterin 2.3.3 ,mungon inxhinieri Gjeolog. kriterin 2.3.4 pika a. Mungon Deklarata e Drejtuesit Teknik te Kantierit. kriterin 2.3.4 pika c. Mungon punonjësi i trajnuar dhe i certifikuar për “Punime ne prani te ujit” kriterin 2.3.4 pika e. Mungon punonjësi i certifikuar për kompetencën profesionale si drejtues per veprimtarinë e transportit rrugore brenda vendit te mallrave dhe udhëtarëve. kriterin 2.3.4 pika g, mungon inxhinieri Arkeolog. kriterin 2.3.5 ,mungon teknik i mesëm Gjeolog dhe teknik i mesëm Hidroteknik kriterin 2.3.5 pika III ,mungojnë 15 punëtoare te thjeshte . kriterin 2.3.6 mungojnë, 3 -Eskavatorist,1- Atomakinist,1- Budozerist dhe 5 -shofer . kriterin 2.3.8 mungon ”Grafiku i punimeve” te firmosur dhe vulosur nga Administratori i O.E. kriterin 2.3.9. Mungojnë shume makineri qe përbejnë shkak për mos realizim te kontratës
3. “S.” SHPK me arsyet e s’kualifikimit që në formulari përmbledhës të vetë deklarimit në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik “S.” SHPK i nënshkruari L. S. deklaroi nën përgjegjësinë e tij të plotë që:

Emri i operatorit ekonomik: BOE Shoqëria “S.” SHPK dhe Shoqëria “K.” SHPK ku përfaqësues është Shoqëria “S.” SHPK.

Në mbështetje të DST-ve të DUK Fier BOE “S.” SHPK & “K.” SHPK nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit. Kushti nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-Nuk plotëson kriterin Kapaciteti Ekonomik dhe Financiare, Kriteri 2.2.1 dhe 2.2.2 të DST -se.

-Nuk plotëson kriterin Kapaciteti Teknik, Kushti 2.3.1 dhe 2.3.2, 2.3.4 pika a dhe b të DST -se

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, kualifikohet OE “S.” SHPK me ofertë 85,859,336 lekë pa TVSH.

2.4.b. Auditim i procedurave të prokurimit publik me vlera të vogla.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u kërkua dokumentacioni si më poshtë:

-Regjistrat e parashikimeve të procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla

-Regjistrat e realizimeve të procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla

-Urdhër pagesat për procedurat e realizuara

-Dokumente të tjera.

Më datë 08.01.2024, me urdhrin nr. 5/1 Prot., titullari i autoritetit kontraktor ka krijuar komisionin e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga E. M., juriste, K. B., ekonomist dhe K.Z.inxhinier ndërtimi.

Për periudhën 2024 nga DUK Fier janë planifikuar të zhvillohen 21 procedura me vlerë të vogël, me vlerë totale në 14,516,392 lek, nga të cilat 6 janë për mallra me vlerë 3,463,000 lekë, 2 procedura janë për punë me vlerë 1,999,943 lekë dhe 13 procedura janë për shërbime me vlerë 9,053,419 lekë.

Procedurat për shërbime janë për riparime dhe shërbime elektromekanike të pompave zhytëse në hidrovore, mbikëqyrje të punimeve, siguracione për mjetet e transportit, sigurime të jetës dhe aksidenteve në punë, sigurimi teknik i punonjësve dhe shërbime interneti.

U realizuan 19 procedura me vlerë me fond limit 13,095,137 lekë dhe kontrata të lidhura në vlerën 11,459,251 lekë.

Në procedurën shërbime interneti për vitin 2024, me numër të procedurës: REF-95200-02-13-2024, me datë të hapjes për pranimin ofertave 2024-02-13 dhe datë të mbylljes për pranimin e ofertave: 2024-02-14 u konstatuan parregullsi në ftesën për ofertë.

-Në zërin 1 janë 15 kompjuterë të shpërndara në 5 zyra por në zërin e sasive janë 20 njësi.

-Gjithashtu afati i dorëzimit të ofertave vetëm një ditë pas hapjes ngushton paraqitjen e operatorëve ekonomikë.

-Kohe zgjatja e kontratës 12 muaj dhe pagesat do të bëhen mujore por në fund përcaktohet se afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë deri me 31 Dhjetor 2024 duke filluar nga momenti i lidhjes së kontratës kur procedura ka filluar 13.02.2024.

Nr	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
A	Shpenzimet për një muaj				
1	Internet(15 kompjutera të shpërndara në 5 zyra. në Qytetin e Fierit)	Mpbs-16	20		

2	Internet(ne qytetet: Vlore (2 zyra), ne Lushnje, Gjirokastër, Sarande nga 1 zyre.	Mpbs-8	10		
3	Telefon fiks	numra	5		
4	Instalime te brendshme dhe mirëmbajtje rrjeti	o/p	8		
5	f.v.Routera ëireless per internetin	cope	5		
	Shuma -1 ne leke				
B	Shpenzimet për 12 muaj	muaj	12		
	Shuma -2 në lekë				
	Shuma 1+2 pa T.V.SH	leke			

-Në procedurën me nr. REF-00758-04-09-2024, riparim i filtrimeve në degën e Lushnjës në qytet data e hapjes për pranimin ofertave është 2024-04-09 dhe data e mbylljes për pranimin e ofertave 2024-04-11.

-Afati për paraqitjen e ofertave ishte vetëm 2 ditë afat ky jo i mjaftueshëm për operatorët ekonomikë të plotësorë dokumentet e kërkuara.

-Në ftesën për ofertë u konstatuan pa rregullshmëri si mungesa e volumeve për të cilat do të ofertohej. Gjithashtu dhe në skicën me detajet teknike mungonin sasitë e betonit dhe suvatimit.

-Në kapacitetet teknike janë kërkuar betoniere pa u argumentuar pse do duhej ta zotëronte ose ta merrte me qira si dhe pasje e licencës N.P – 7. Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e të tjera

Nr.	An	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefta
1	3.104/b	Gërmim dheu me esk.0.5m3 me shkarkim ne mjet	a m ³			
2	3.25/c	Gërmim dheu me krahë	m ³			
3	3.405/1	Prishje betoni ekzistues	m ³			
4	3.158/5a	Transport dheu me auto L=5 Km	m ³			
5	3.183/c	Nënshtresë me zhavorr t=20 cm	m ²			
6	3.628	Suvatim ll.c. 1:2 lugjet nga jashtë	m ²			
7	3.287	F+v. hekur ø 10 mm, zgarë	ton			
8	3.243/1	Veshje me beton C16/20, t=20cm	m ³			
		Shuma				
		TVSH 20%				
		TOTALI				

Sa më sipër është në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 05.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pikat 7-9.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Në procedurën në datë 10.12.2024, me urdhër prokurimi nr.383/2 Prot., me objekt “Riparime dhe shërbime elektrike e mekanike të elektro-pompës zhytëse tip 700 QZ-4 me P=110kË në hidrovorin Butrint, Sarandë”, janë kërkuar:

Elektropompa zhytëse tip QZ 700-4 me P= 110 kË qe kërkohet nga DUK Fier për të bërë riparime dhe shërbime elektromekanike ndodhet e difektuar në hidrovorin Butrint ne Sarandë. Kjo elektropompë ka nevojë për ti bere riparime, shërbime elektromekanike si dhe furnizim vendosje materiale elektrike dhe mekanike si me poshtë vijon: 1-Avolxhimin e elektromotorit me P= 110 kË, Un=400V, n=740 rrot/min, 2-Riparimin e shërbimet grupit të lopatave dhe furnizim vendosje fleta helikash (tre cope) 3-Riparim shërbime kutisë së morseterisë së kablllove të fuqisë dhe

kabllove të sensoreve një cope 4-Riparim shërbime të aparaturës së monitorimit të sensoreve që monitorojnë parametrat teknike të elektropompës si temperaturat e kushinetave të sipërme dhe të poshtme, vibrimet e pompës, lagështirën në kabllot e fuqisë dhe në kasetën e kabllove duke furnizuar dhe vendosur 1 cope Modul-monitorimi që shërben për monitorimin e parametrave teknike të elektropompës si temperaturën e pështjellave, temperaturën e kushinetave, kontrollin e izolacionit, vibrimet. 5-Furnizim+Vendosje një cope Sensore Moduli që bene përpunimin e të dhënave të sensoreve që janë në elektromotorë dhe në pompë. 6- Furnizim+Vendosje ndërprerës i lagështirës së kabllove SMD copë-1. 7-Furnizim+Vendosje Pt-100 në pështjelljen e statorit, sensor për matjen e temperaturës copë-2. 8- Furnizim+Vendosje Bullona inoksi komplet M 24mm, L=70mm dado, rrore cope-24. 9- Furnizim+Vendosje morseta shtrënguese Ø90 mm për kabllot e fuqisë dhe të sensoreve cope=24. 10- Furnizim+Vendosje kabull gome 10x 1.5mm² IP-68 me gjatësi 10 m 11-Bojatisje pompe me lëng fosfori e llak fenol të një sipërfaqe prej 6m². Për sa sipër për ti bere te gjitha këta shërbime duhet bere çmontimi i pompës nga një grup mekanikësh që kane njohuri nga pompat zhytëse dhe të jenë shoqëruar me te gjitha veglat e punës per çmontimin e pompës me një automjet me tonazh 2.5 ton dhe një autovixh 5 ton per ngarkimin e pompës per ta çuar në një servis te specializuar për pompat.

II-Operatori Ekonomik duhet të disponoje një servis në pronësi ose me një kontrate noteriale qiraje. Servisi duhet te jete i specializuar për riparim dhe shërbime të pajisjeve mekanike dhe elektrike si dhe një reparte për avolzhim të elektromotorëve të tijen ose me kontrate qiraje të cilën e vërteton përmes disponimit të pajisjeve si më poshtë: 1-Trapano bango portative për shpim me Ø deri në 40mm.-1 cope 2-Bareno për punimin e bokullave . -1 cope 3-Freze për punime modulesh dhe kanalesh kiavete. -1 cope 4--Motogjeneratore saldimi me hark elektrik.- 1 cope 5--Vinx 5 ton -1 cope 6-Torno me gjatësi jo me te vogël se 3m për akset e pompave.- 1 cope 7- Reparte avolzhimi ku të ketë bobinatrice, tavoline të madhe pune për vendosje te elektromotorit dhe furre pjekje te llakut te elektromotorit. Në lidhje me këtë pike Operatori Ekonomik duhet te paraqesë (fotografi). Për të vërtetuar disponimin e këtyre pajisjeve duhet te paraqesë një nga dokumentet si me poshtë: Fature tatimore blerje ose kontratë qiraje, Inventarin e konfirmuar nga Tatimet ku te figurojnë këto pajisje. A.K përpara se të bëjë shpalljen e kualifikimit të O.E. ka të drejtën e verifikimit të informacionit në vend të dhënë nga O.E për plotësimin e këtij kriteri kualifikues. Operatori Ekonomik ofertues duhet te disponojë certifikatat e mëposhtëmve: -Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, BS OHSAS 18001:2015 ose ekuivalenti SSH ISO-45001:2018 -Certifikatë për sistemin e menaxhimit te cilësisë SSH EN – ISO 9001: 2015. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit te paraqesë certifikatat ISO. Këto certifikata kërkohen për të vërtetuar kapacitetin profesional dhe cilësore të kompanisë në mënyrë që të japë garanci në lidhje me përmbushjen e kontratës.

Argumentimi teknik i kërkesave të veçanta kërkon që Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 7 punonjës të cilët duhet ti vërtetojë me pagesën e sigurimeve shoqërore për 3 muajt e fundit te konfirmuara nga Drejtoria Tatim Taksave si me poshtë: Ing elektrike ose Megatronik -Duhet për të drejtuar te gjitha punimet e detajuara ne analizat e paraqitura nga A.K dhe për të përcaktuar kushtet teknike dhe teknologjike të të gjithave punimeve elektro/mekanike qe do te kryhen. Teknike te mesëm elektrik. Duhet sepse specifika e punimeve që do të kryhen në hidrovorin e Butrintit duhet të jenë njohës të mirë të skemave elektrike të lëshimit me Soste starter, lidhja e sendoreve të temperature së pështjellove, sensorëve të lagështirës dhe përshtatja e tyre ne skemën logjike të lëshimit me softe starter është domosdoshmëri. Teknike të mesëm mekanik duhen për realizimin e të gjithave punimeve mekanike të detajuara në analizat e shërbimeve të paraqitura nga A.K në hidrovorin Butrint Sarande. Tornitorët duhen për realizimin e punimeve në

hidrovore për prodhimin e boshteve të helikave të pompave dhe të detaleve të tjera që dalin gjatë remontit. Saldatorë duhen për realizimin e punimeve që kërkojnë saldime për mbushjen e akseve ose saldime të tjera që mund të lindin gjatë shërbimeve mekanike. Shoferi duhet për drejtimin e një kamionçine për transportin e punonjëseve dhe të materialeve për në hidrovorin Butrint. Vërtetimi i pagesave të sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga Tatim Taksat është detyrim ligjor për çdo lloje biznesi. makineri dhe pajisje të nevojshme për realizimin e kontratës 1-Bareno për punimin e bokullave, duhet për barinimin e bokullave të akseve të rotorit pas mbushjes me saldim. 2-Vinc 5 ton. Duhet sepse pompat dhe pjesët e pompave që do të çmontohen janë të përmasave dhe peshave të mëdha dhe të rënda që shkojnë deri në 3 ton 3. -Torno me gjatësi jo më të vogël se 3m për akset e pompave. -Duhet për tornimin e akseve të 4-Freze për punime modulesh dhe kanalesh kiavete.-Duhet për hapjen e kanaleve të akseve të rotorëve dhe detaleve të tjera shoqëruese pas procesit të saldimit dhe të tornimit. 5-Një servis në pronësi ose me një kontratë qiraje i specializuar për riparim dhe shërbime të pajisjeve mekanike, elektrike dhe të avolxhimit të elektromotorëve të elektropompave dhe të paneleve të lëshimit të elektropompave në hidrovore. Kërkohej servisi dhe është domosdoshmëri që të ketë të gjitha makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës të A.K. 6-Një repart elektrik të kompletuar në fushën e logjistikes të skemave elektrike, me softe starter.- O.E duhet që stafi elektrik që ka të jetë një njohës i mirë i skemave elektrike të lëshimit me softe starter, reaktore, ylle /trekëndësh etj, dhe të kenë përvojë në këtë fushë sepse punimi që do të kryhet në hidrovorin e Butrintit kërkon teknik të mesëm elektrik me përvojë të gjatë pune sepse do të bëjnë përshtatjen e skemës elektrike të pajisjes së re që do të sjellin me skemën elektrike të panelit ekzistues që ka hidrovori. 7-Një repart avolxhimi për elektromotora në pronësi ose me kontratë bashkëpunimi ndërmjet palëve. Kërkohej ky repart sepse duhen për të bërë avolxhimin e tre elektromotoreve me fuqi 110 kË. \Kjo kërkon një punë shumë të specializuar në fushën e izolimeve sepse janë elektromotore që do të punojnë brenda në ujë. Certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, BS OHSAS 18001:2015 ose ekuivalenti SSH ISO-45001:2018. Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë SSH EN-ISO 9001: 2015. Kërkesë e A.K për cilësinë dhe garancinë e punimeve.

Në kërkesat sa më sipër duke u nisur nga rëndësia e riparimit që do të kryhej saktësim i pajisjeve dhe i specialistëve është i justifikuar por kërkesa për certifikatat për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë nuk është e argumentuar. Duke u nisur nga fakti që është procedurë me blerjesh me vlera të vogla kërkesat duhet të ishin më të thjeshta dhe më thelbësore.

Në kontratën e lidhur për zbatim afati i përfundimit është brenda 5 ditëve. Njoftimi i fituesit është bërë më datë 24.12.2024, kontrata me nr. 383/5 është lidhur më datë 26.12.2024, fatura është emetuar më datë 27.12.2024 ora 8 dhe procesi verbal i marrjes në dorëzim është i datës 27.12.2024. Duke u nisur nga volumi i punëve, mjetet teknike të kërkuara, ambientet, avolxhimi etj, kryerja e të gjithë procesit nga lidhja e kontratës datë 26 dhjetor dhe emetimi i faturës në ora 8 të ditës së nesërme pra përfundimin e punimeve dhe marrjen në dorëzim brenda një afati kohor kaq të shkurtër nuk justifikon të gjitha kërkesat që duhet të plotësonte operatori ekonomik.

Në procesin verbalin e mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga B. K., K. B., B. D. dhe G. F., shprehen se procesi verbal i marrjes në dorëzim është bazuar në faturën me nr. 143, datë 27.12.2024, nga subjekti A. SHPK, si dhe dokumentacionit të dosjes. Komisioni pasi ka parë gjendjen e materialeve që rezultuan në gjendje të mirë teknike u dakortësuan për marrjen në dorëzim sipas situacionit përfundimtar të paraqitur nga operatori ekonomik. Fatura e operatorit ekonomik është e datës 27.12.2024, ora 07.55. me seli në Elbasan.

Sa më sipër është në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 05.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pikat 7-9.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla si dhe anëtarët e komisionit të pranimit.

Më datë 09.01.2025, me urdhrin nr. 11 Prot., titullari i autoritetit kontraktor ka krijuar komisionin e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga E. M., juriste, K. B., ekonomist dhe K.Z. inxhinier ndërtimi.

Për vitin 2025 ishin parashikuar 22 procedura me vlerë fondi limit 13,289,139 lekë. Deri në 6 mujorin e parë janë realizuar 12 procedura me fond limit 6,671,617 lekë dhe vlerë kontrate në shumën 5,240,937 lekë.

Procedura “Shërbime interneti” 2025

Më datë 21.02.2025 me numër REF-38999-02-24-2025 dhe urdhrin nr. 67/1 të titullarit të autoritetit kontraktor është iniciuar procedura me objekt “Shërbime interneti”, me fond limit 415,840 lekë, bazuar në kërkesën e bërë nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga K. Z. kryetar dhe E. M. e K. B. anëtarë.

Në zërin 1 janë 15 kompjuterë të shpërndara në 5 zyra por në zërin e sasive janë 20 njësi.

Gjithashtu afati i dorëzimit të ofertave vetëm një ditë pas hapjes ngushton paraqitjen e operatorëve ekonomikë.

Kohe zgjatja e kontratës 12 muaj dhe pagesat do të bëhen mujore por në fund përcaktohet se afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë deri me 31 Dhjetor 2024 duke filluar nga momenti i lidhjes së kontratës kur procedura ka filluar 13.02.2024.

Në këtë procedurë janë bërë të njëjtat gabime si në periudhën 2024.

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
A	Shpenzimet për një muaj				
1	Internet (15 kompjuterë të shpërndarë në 5 zyra në Qytetin e Fierit)	Mpbs-16	20		
2	Internet (në qytetet Vlore 2 zyra, në Lushnje, Gjirokastër, Sarandë nga 1 zyre.)	Mpbs-8	10		
3	Instalime të brendshme dhe mirëmbajtje rrjeti	op	24.8		
	Shuma totale për 1 muaj				
	Shuma totale për 12 muaj		12		
5	F.V Mikrotike Router MikroTik RouterOS	cope	5		
	Shuma totale pa t.v.sh				

Sa më sipër është në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 05.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pikat 7-9.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

2.4.c. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i kontratave për punë publike, për periudhën e auditimit 01.01.2024 deri 31.06.2025, paraqitet, si më poshtë.

Në total janë lidhur 20 (njëzet) kontrata për punë publike me vlerë 805,515,226.51 lekë me TVSH.

Në zbatim të pikës 2.6. të Programit të Auditimit, në DUK Fier, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, u

arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, tipologjisë së punimeve të ndërtimit dhe projekteve të zbatimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, procedurës së rishikimit të projekteve të zbatimit dhe preventivit si dhe, zbatimit të procedurës së shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve, u krye auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit për **6 (gjashtë)** kontrata për punë publike në shumën totale 455,176,080.8 lekë me TVSH ose 56.55 % të vlerës së kontratave të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga AK.

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar DUK Fier, **po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara**, si vijon:

I. Kontrata për punë publike me objekt: “Bypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit”, DUK Fier, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme, u konstatua problematikat si vijon.

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Bypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit”. REF-71840-06-07-2023		
14.Lidhja e kontratës. nr. 144/6-11 prot., datë 24.07.2023 OE “F.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 32,249,273.60 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 9,277,224 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 2,620,000 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 7,547,672.12 lekë me TVSH Sit. 4 në vlerën 10,599,496.22 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 2,201,714.98 lekë pa TVSH VI përf e realizuar 32,249,273.60 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 01.08.2023 Dt e pezullimit të punimeve. 21.09.2023 Dt e rifillimit të punimeve 20.03.2024 Përfundimi punimeve: 15.05.2024	19. Zgjatja e kontratës ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “H.-A.” SHPK	Licenca MK. 2191/4	Kontratë me nr. 175/6 prot., datë 31.07.2023
21. Kolaudatori i punimeve PF Ing. M. H. dhe Ing. N. L.	Licenca Nr: MK.1114/4	Urdhër nr. 144/6-24 prot., datë 12.08.2024
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. 144/6-24-1 prot., datë 18.07.2024 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “F.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “H.-A.” SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. M. H. dhe Ing. N. L..	23.Akt i marrjes në dorëzim: -Me me nr. 144/6-24-2 prot., datë 14.08.2024 protokolluar në DUK Fier, është mbajtur akt marrje në dorëzim e përkohshëm të punimeve të objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “F.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “H.-A.” SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. M. H. dhe Ing. N. L., si dhe komisioni i DUK Fier me përbërje Ing. F. D., Ing. K. B. dhe Ing. B. K..	

Përshkrimi i situatës.

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë

Dëm ekonomik ndaj buxhetit të **DUK Fier**, në vlerën **178,200 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Punime gjurmimi								-
Zëri 2 (3.96/b).	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m3, në kanale me gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë	m ³	120	9,874.69	9,874.69	8,389.69	1,485	178,200
Totali në lekë pa TVSH								178,200

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërisë “H.r-A.” SHPK e përfaqësuar nga Z. G. P., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

2. Nga Autoriteti Kontraktor DUK Fier, nuk është kryer oponenta teknike për projektin e zbatimit për projektin e zbatimit “Baypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit”.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6; VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën

e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve”, neni 41, pika 1, germa (c), si dhe VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponentëve teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK DUK Fier z. E. V. .

3. Është lidhur kontrata për kolaudimin e punimeve me nr. 144/6-24 prot., datë **12.08.2024** ndërmjet DUK Fier, përfaqësuar nga Drejtori z. Th. S. dhe, Ing. M. H. dhe Ing. N. L., ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë përfunduar me datë **15.05.2024**, pra, kontrata e kolaudimit nuk është lidhur brenda 30 ditëve nga njoftimi i përfundimi të punimeve të ndërtimit, por rreth 3 (tre) muaj me vonesë. Kjo parregullsi është në kundërshtim me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, **neni 12** ku citon se: “Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit” si dhe nenin 15. **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi** Drejtori i DUK Fier z. Th. S..

Për sa është trajtuar në projektraportin e auditimit është bërë në observacionin nga shoqëria mbikëqyrëse “H.-A.” SHPK me administrator Ing. G. P., protokolluar në DUK Fier me numër 201/24 prot., datë 09.02.2026 (protokolluar në KLSH me nr. 714/9 prot., datë 12.02.2026), ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:-Pretendimet lidhur mbi zërin e punimeve “2 (3.96/b). Gërmim dheu me ekskavator me zinxhir 0.25 m³, në kanale me gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë”, si dhe zërin e punimeve “Zëri 4(3.243/1). Shtresë betoni C16/20, t=15 cm. (Struktura të holla monolite)”, nga mbikëqyrësi janë paraqitur të njëjta me argumentet e paraqitur për akt konstatimin nr. 1, datë 26.11.2025. Kështu që nuk po i rishkruajmë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Mbas shqyrtimit të observacionit, sqarojmë si vijon:

-Së pari: Diferenca për volumin e zërit “Zëri 4(3.243/1). Shtresë betoni C16/20, t=15 cm. (Struktura të holla monolite)” është marrë në konsiderratë në observacionin për akt konstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit, dhe kjo gjë nuk është kuptuar nga mbikëqyrësi i punimeve. Përsëritja e argumentit, është e panevojshme.

-Së dyti: Lidhur me zërin e punimeve “2 (3.96/b). Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale me gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë”, argumentet janë të njëjta me trajtimin që është bërë në observacionin lidhur me akt konstatimin nr. 1, datë 26.11.2025, ku grupi ka arsyetuar se argumentet nuk janë bindëse.

Argumenti juaj për zërin “Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale me gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë” nuk qëndron, dhe se observacioni nuk merret në konsideratë në raportin përfundimtar të auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. V., në cilësinë e ish-Titullar të DUK Fier.

2. Z. Th. S., në cilësinë Drejtor të DUK Fier.

2. Z. G. P., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjërësisht problemet mbi shkeljet janë trajtuar në akt-konstatimi Nr.1, datë 26.11.2025, dorëzuar me protokoll në DUK Fier)

II. Kontrata për punë publike me objekt: “Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman”, DUK Fier, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman”. REF-07768-06-03-2024

14.Lidhja e kontratës. nr. 179/17 prot., datë 16.08.2024 OE “M.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 139,407,566 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 30,009,258 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 109,398,308 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 109,398,308 lekë pa TVSH VI përf e realizuar 139,407,566 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 28.10.2024 Përfundimi punimeve: 09.12.2024	19. Zgjatja e kontratës ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “G.” SHPK	Licenca MK. 2812/4	Kontratë me nr. 242/19 prot., datë 15.10.2024
21. Kolaudatori i punimeve Ing. F. D.	Licenca Nr: MK.1599	Urdhër nr. 179/28 prot., datë 20.12.2024
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. 179/30 prot., me datë 24.12.2024 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “M.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “G.” SHPK, kolaudatori i punimeve specialistët e DUK Fier Ing. F. D..	23.Akt i marrjes në dorëzim: -Me me nr. 179/30 prot., datë 24.12.2024 protokolluar në DUK Fier, është mbajtur akt marrje në dorëzim e përkohshëm të punimeve të objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “M.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “G.” SHPK, kolaudatori i punimeve specialistët e DUK Fier Ing. F. D., si dhe Titullari i DUK Fier Inxh. E. K..	

U konstatua problematikat si vijon.

Përshkrimi i situatës.

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **DUK Fier**, në vlerën **379,995 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacion i përfundi mtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 5	Gërmim me shkarkim në tokë eks. 0.5 m3, për seksionimin e argjinaturës	m ³	245	15,613	15,613	14,062	1551	379995
Totali në lekë pa TVSH								379,995

- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se:** “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- *Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërisë “G.” SHPK e përfaqësuar nga z. G. B., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- *Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”*.

- *UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”*.

2. Nga Autoriteti Kontraktor DUK Fier, nuk është kryer oponenta teknike për projektin e zbatimit për projektin e zbatimit “Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman” .

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6; VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve”, neni 41, pika 1, germa (c), si dhe VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponentës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK DUK Fier Z. Th. S. dhe mbikëqyrësin e punimeve Z. G. B..

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit të KLSH-së nga shoqëria mbikëqyrëse shoqëria “G.” SHPK, si dhe DUK Fier është paraqitur observacion me shkresë nr. 201/24 prot., datë 09.02.2026 (Protokolluar në KLSH me nr. 714/9 prot., datë 12.02.2026), ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

...lidhur me zërin 5. “Gërmim me shkarkim në tokë me ks. 0.5 m3 për seksionin e argjinaturës” pretendohet se pas rivlerësimit të librezës së masave, konstatohet se e gjithë volumi i gërmimit faktik është paraqitur në librezën e masave dhe situacionuar sipas tij.

Përfundim:

Shoqëria mbikëqyrëse vlerëson se konstatimet në Projekt raportin e auditimit lidhen me çështje që kërkojnë sqarim teknik shtesë, duke marrë parasysh specifikën e zbatimit të punimeve në objekte ekzistuese. Me paraqitjen e këtyre observacioneve, synohet qartësimi i rrethanave teknike dhe një vlerësim sa më objektiv i procesit të zbatimit të kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Lidhur me pretendimin e mbikëqyrësit se, pas rivlerësimit të librezës së masave, konstatohet se e gjithë volumi i gërmimit faktik është paraqitur në librezën e masave dhe situacionuar sipas tij, librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Grupi i auditimit ka arritur në përfundimin bazuar në dokumentet teknike në dosje, dhe mendon se nuk keni sjellë argument për ndryshuar konkluzionin mbi diferencën e volumit të gërmimit.. Sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Th. S., në cilësinë e Titullarit të DUK Fier.

2. Z. G. B., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet janë trajtuar në akt-konstatimi Nr.2, datë 26.11.2025, dorëzuar me protokoll në DUK Fier)

III. Kontrata për punë publike me objekt: “Mbrotjtja nga lumi i Kalasë- (Kaskada e Vanës)”, DUK Fier, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Mbrotjtja nga lumi i Kalasë- (Kaskada e Vanës)”. REF-04763-05-14-2024		
14.Lidhja e kontratës. nr. 162/15 prot., datë 05.08.2024 BOE “S. & K.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 83,899,617.48 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 16,728,049 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 28,920,816 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 38,241,768 lekë pa TVSH VI përf e realizuar 83,890,633 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 10.09.2024 Përfundimi punimeve: 30.06.2025	19. Zgjatja e kontratës Afati 160 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “G.” SHPK & OE “I.” SHPK	Licenca MK. 2928/17	Kontratë me nr. 244/15 prot., datë 30.08.2024
21. Kolaudatori i punimeve PF Ing. M. H.	Licenca Nr: MK.1114/4	Urdhër nr. 244/28 prot., datë 27.07.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. 244/29 prot., datë 30.07.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE “S.& K.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “G.” SHPK & “I.” SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. M. H..	23.Akt i marrjes në dorëzim: -Me me nr. 244/29 prot., datë 30.07.2025 protokolluar në DUK Fier, është mbajtur akt marrje në dorëzim e përkohshëm të punimeve të objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE “S.& K.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “G.” SHPK & “I.” SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. M. H., si dhe administratori i kontratës Ing. F. D..	

U konstatua problematikat si vijon.

Përshkrimi i situatës.

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **DUK Fier**, në vlerën **129,970 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Punime ndërtimi vepra arti (Mure gabion)							0	
Zëri 15	Gabiona me rrjet teli të zinguar e gur kave 1x1x1 m,	m ³	11,000	634	634	-	-	129,970
Totali në lekë pa TVSH							129,970	

Sa më sipër, ga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005** “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve BOE “G.” SHPK dhe OE “I.” SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3, datë 15.2.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

2. Nga Autoriteti Kontraktor DUK Fier, nuk është kryer opinionen teknike për projektin e zbatimit për projektin e zbatimit “Mbrojtja nga lumi i Kalasë- (Kaskada e Vanës)”.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve”, neni 41, pika 1, germa (c), si dhe

VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponentës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK DUK Fier Z. Th. S.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Th. S. në cilësinë Drejtor të DUK Fier.

2. Z. G. S., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet janë trajtuar në akt-konstatimi Nr.3, datë 26.11.2025, dorëzuar me protokoll në DUK Fier)

IV. Kontrata për punë publike me objekt: “Riparimi i Argjinaturës mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”, DUK Fier, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Riparimi i Argjinaturës mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”. REF-11108-06-25-2024		
14.Lidhja e kontratës. nr. 210/15 prot., datë 16.08.2024 OE “S.” SHPK	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 103,031,204.22 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 20,535,624 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 82,495,578.84 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 103,031,202.84 lekë pa TVSH VI përf e realizuar 103,031,202.84 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 10.10.2024 Përfundimi punimeve: 09.12.2024	19. Zgjatja e kontratës Afati dy muaj.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “A.” SHPK	Licenca MK.3101/15	Kontratë me nr. 41/15 prot., datë 25.03.2024
21. Kolaudatori i punimeve PF “F. D.”	Licenca Nr: MK.1599	Urdhër nr. 210/28 prot., datë 16.12.2024
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me datë 26.12.2024 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “S.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “A.” SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. F. D..	23.Akt i marrjes në dorëzim: -Me me nr. 210/29-1 prot., datë 26.12.2024 protokolluar në DUK Fier, është mbajtur akt marrje në dorëzim e përkohshme e punimeve të objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “S.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “A.” SHPK, kolaudatori i punimeve Ing. F. D., si dhe personi përgjegjës i kontratës Ing. M. H..	

U konstatua problematikat si vijon.

Përshkrimi i situatës.

Nga Autoriteti Kontraktor DUK Fier, **nuk është kryer oponentenca teknike** për projektin e zbatimit për projektin e zbatimit “Riparimi i Argjinaturës mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6; VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve”, neni 41, pika 1, germa (c), si dhe

VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponentës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK DUK Fier Z. Th. S..













Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit nga shoqëria mbikëqyrëse “A.” SHPK me administrator Ing. Ll. T., është paraqitur observacion protokolluar në DUK Fier me nr. 201 prot., datë 09.02.2026 (protokolluar në KLSH me nr. 714/9 prot., datë 12.02.2026), ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:













Pretendim i subjektit:

Në zërin gjurmim dhe me ekskavator me zinxhirë 0.25 m' ne prani uji, toke e zakonshme me shkarkim në mjet janë konsideruar si punime të pakryera sasia prej 564 m³ dhera me argumentimin se ka mos përjasje të kuotave të projektit të zbatuar dhe të pasqyruara në librezën e masave.

Sa me sipër theksojmë se volumet e gjurmimit janë realizuar në masën e paraqitur në librezën e masave, pasqyruar në situacionin përfundimtar dhe kjo sasi përputhet me azhurnimin e zbatimit të punimeve në fakt.

Volumet përfundimtare të gjurmimeve janë shumatorja e volumeve të projektit në masën 6276.3 m³ dhe shtesave të tyre të përballuara nga fondi rezerve në masën 640.8 m³. (6276.3 + 640.8 = 6917 m³). Sa më sipër po japim të specifikuarat profilat tërthore të argjinaturës, specifikisht volumet e gjurmimit për ndërtimin e saj:








Tabela e volveve te germimit						
Nr	Pk	Sg	Sm	L	Sasia	Progres
		m ²	m ²	m	m ³	m ³
1	Pk.1	0.00				
2	Pk.2	2.14	1.07	30	32.1	32.1
3	Pk.3	10.91	6.53	30	196.8	227.9
4	Pk.4	5.91	8.41	30	252.3	480.2
5	Pk.5	4.80	5.35	30	180.7	640.8
6	Pk.6	4.10	4.45	30	133.5	774.3
7	Pk.7	4.78	4.44	30	133.2	907.5
8	Pk.8	5.90	5.34	30	180.2	1067.7
9	Pk.9	9.61	7.71	30	231.2	1298.9
10	Pk.10	16.10	12.81	30	384.2	1683.0
11	Pk.11	13.04	14.67	30	437.1	2120.1
12	Pk.12	10.12	11.68	30	347.4	2467.5
13	Pk.13	9.44	9.78	30	293.4	2760.9
14	Pk.14	7.31	8.38	30	251.3	3012.2
15	Pk.15	9.40	8.36	42	350.9	3363.1
16	Pk.16	0.00	4.70	36	169.2	3532.3
17	Pk.17	0.00	0.00	22	0.0	3532.3
18	Pk.18	0.00	0.00	25	0.0	3532.3
19	Pk.19	5.78	2.88	40	115.2	3647.5
20	Pk.20	6.28	6.02	40	240.8	3888.3
21	Pk.21	0.00	3.14	25	78.5	3966.8
22	Pk.22	0.00	0.00	20	0.0	3966.8
23	Pk.23	8.35	4.18	30	125.3	4092.0
24	Pk.24	6.48	7.41	36	269.6	4358.6
25	Pk.25	5.68	6.02	11	66.2	4424.8
26	Pk.26	4.02	4.50	18	88.4	4513.2
27	Pk.27	7.35	5.69	35	199.0	4710.2
28	Pk.28	5.46	6.41	40	260.2	4966.4
29	Pk.29	6.80	6.03	40	241.2	5207.6
30	Pk.30	5.20	5.90	30	177.0	5384.6
31	Pk.31	3.72	4.46	30	133.8	5518.4
32	Pk.32	4.14	3.93	20	78.6	5597.0
33	Pk.33	5.48	4.81	30	144.3	5741.3
34	Pk.34	3.49	4.49	30	134.6	5875.8
35	Pk.35	0.00	1.75	30	52.4	5928.2
36	Pk.36	0.00	0.00	34	0.0	5928.2
37	Pk.37	4.35	2.18	30	85.3	5993.4
38	Pk.38	6.74	5.55	30	166.4	6159.8
39	Pk.39	9.41	8.08	26	210.0	6369.7
40	Pk.40	9.23	9.32	34	319.9	6689.6
41	Pk.41	8.85	8.94	28	232.4	6919.1
TOTALI (m ³)					6919.1	6919.1

Në këtë mënyrë shuma e përcaktuar në Aktin e Konstatimit prej 219,960 leke pa TVSH është realizuar dhe nuk mund konsiderohet si dem ekonomik.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbas shqyrtimit të observacionit, sqarojmë se argumentimi qëndron dhe se, observacioni i paraqitur për volumin e zërit “ ” qëndron dhe kjo do të reflektohet në materialin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. Th. S., në cilësinë e Titullarit të DUK Fier.

V. Kontrata për punë publike me objekt: “Mbrojtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e Shelegarit)”, DUK Fier, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Mbrojtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e Shelegarit)”. REF-01843-04-18-2024		
14.Lidhja e kontratës. nr. 130/16 prot., datë 12.07.2024 BOE “N.& R.” SHPK	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 49,308,411.10 lekë me TVSH.	16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 25,000,000 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 19,357,812.20 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 4,937,478.60 lekë pa TVSH Vl përf e realizuar 49,295,290.80 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 03.09.2024 Përfundimi punimeve: 27.12.2024	19. Zgjatja e kontratës ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “S. & A. & L.” SHPK	Licenca MK. 0944/10	Kontratë me nr. 243/14 prot., datë 29.08.2024

21. Kolaudatori i punimeve PF "F. D."	Licenca Nr: MK.1599	Urdhër nr. 243 prot., datë 27.01.2025
22. Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me datë 04.02.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "N. & R. C." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE "S. & A. & L." SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. F. D..	23. Akt i marrjes në dorëzim: -Me me nr. -- prot., datë 04.02.2025 protokolluar në DUK Fier, është mbajtur akt marrje në dorëzim e përkohshëm të punimeve të objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "N. & R." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE "S. & A. & L." SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. F. D., si dhe personi përgjegjës i kontratës Ing. M. H..	

U konstatua problematikat si vijon.

Përshkrimi i situatës.

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **DUK Fier**, në vlerën **207,365 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacion i përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime gjurmimi							-
Zëri 6	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m3, në kanale gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë	m ³	420	2,702.15	2,702.15	2,632.11	70.04	29,417
	Punime jashtë liste							-
Zëri 10(A n.01)	Mbushje me gurë masivë t=2 ton/m3 në blloqe, D=0.8-1.2 m. Në derdhje të Kaskadës	m ³	360	988.66	988.66	939.23	49.43	177,948
	Totali në lekë pa TVSH							207,365

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998** "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: "... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...".

- **Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005** "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3 ku përcaktohet se: "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...".

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve BOE "S." SHPK & OE "A." SHPK & OE "L." SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

2.Nga Autoriteti Kontraktor DUK Fier, **nuk është kryer opoenca teknike** për projektin e zbatimit për projektin e zbatimit “Mbrotjtja nga Lumi Kalase - (Kaskada e Shelegarit)” .

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6; VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve”, neni 41, pika 1, germa (c), si dhe VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen opoençës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK DUK Fier Z. Th. S..

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit të KLSH-së nga shoqëria mbikëqyrëse BOE “S. & A. & M.” SHPK, është paraqitur observacion protokolluar në DUK Fier me nr. 201/24 prot., datë 09.02.2026 (protokolluar në KLSH me nr. 714/9 prot., datë 12.02.2026), ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

...Nga ana e jonë, në cilësinë e subjektit mbikëqyrës, paraqitet ky observacion në të cilin jemi munduar, sadopak të vlerësojmë e argumentojmë se diferencat e pasqyruara në Akt Konstatimin Nr.5, pavarësisht vlerës që ato përfaqësojnë (afro 0,04% të vlerës totale të situacionuar), ato, më se shumti janë diferenca që burojnë e mund të bëhen rëndom nga pasaktësitrat që mbartin vetë metodat praktike të vlerësimit e të realizimit të matjeve të volumit të punimeve në objekte të hapura në terren.

Konkretisht:

-Në lidhje me zërin Nr. 6 , ... Punime gërmimi me ekskavator... sipas auditit rezultojnë rreth 70 m3 gërmime tepër, ose rreth 2 % e një sasisë prej afro 2,700 m3 të situacionuar, Kjo diferencë e vogël mund të vije edhe për shkak të mesatarizimit jo perfekt të dy sipërfaqeve të profilave tërthor njeri pas tjetrit.

Dhe, në rastin konkret, ato pak diferenca, dukshëm vijnë nga një mesatarizim jo i saktë i sipërfaqeve të seksioneve tërthor, njeri pas tjetrit. (Shpesh edhe në metodikat apo udhëzimet që përshkruhen edhe në manualët e preventivimit thuhet se, në vlerësimin e punimeve të gërmimit, seksionet tërthor duhet të merren sa më afër njëri tjetrit, për t’ju afruar saktësisë së krejt volumit (i cili mund rezultojë të jetë më i madh ose me i vogël).

Në manuale të ndryshëm është e shkrojtur që në punimet e gërmimit pasaktësitë deri në $(2 \div 3) \%$ jene të pranueshme.

Sidoqoftë, në rastin konkret këto volume mund të ishin justifikuar (kompensuar) edhe duke marrë në konsideratë një gërmim faktik, të pa vjelë në situacione. Është fakt që gërmimi i themeleve, në zonat perimetrale, ku do të zhyten bazamentet e betonit, që praktikisht është realizuar, duhet të llogaritet në formë trapezi pasi, ndryshe nuk mund të qëndrojë një kanal (themeli) në një thellësi deri në 2 m, pa një skarpatë minimum 1:0,5 .

-Në lidhje me zërin Nr. 10 (An 01) ,.....Mbushje me gurë masiv në pragun e daljes së kaskadës, nga konkluzionet e auditit të KLSH-se thuhet se në sasinë 998.6 m³ janë raportuar 49.3 m³ mbushje më tepër nga fakti.

-Edhe këtu, ka disa ndryshime relativisht të vogla që nuk janë marrë, apo nuk janë vlerësuar nga auditit njëllor, me çka është pasqyruar e vlerësuar në librezën e masave. Siç e përshkruajnë edhe Audituesit këtu gjithë sipërfaqja e zënë nga masivi i mbushjes me gurë, për të bërë më të kuptueshme përlllogaritjet, është ndarë në 5 blloqe dhe, nga auditit, dy nga këto blloqe, janë llogaritur me lartësi (ose trashësi) prej 2,8 m kurse një bllok i tretë është llogaritur me lartësi 1,9 m .

-Ndërkohë që në vizatimet dhe në librezat e masave, është bërë e njëjta ndarje në blloqe, porse lartësia (ose trashësia) është llogaritur të jetë respektivisht 2,96 dhe 1,95 m.

Edhe këtu duhet mbajtur në konsideratë, se referuar dimensioneve në vizatime por edhe vlerave të dimensioneve që janë marrë në konsideratë nga Audituesit kanë një ndryshim që kryesisht vjen nga matja jo e sakte e lartësisë ose kreut të blloqeve me gurë. Praktikisht, kreu i blloqeve me gurë nuk mund të jetë në të njëjtin nivel. Dhe kjo duket e vihet re edhe në vizatimet e paraqitura në librezë të masave ku lartësia është pasqyruar H deri 3m dhe H deri 2 m .(është me ndikim pozitiv në shuarjen e energjisë një dhëmbëzim qoftë edhe me 10 cm)

-Edhe në dimensionin linear ka një mos përputhje me atë çka është audituar.

Gjatësia e linëes së blloqeve anësore me gurë është në dimensione të ndryshme që leviz nga 7,75 deri në 11,75, me një mesatare 9.75 m, ndërkohë që nga vlerësimet e bëra gjatësia mesatare e bllokut është 9.75 dhe jo 8-9 m siç është marrë në përlllogaritjet e volumeve. Për sa me sipër, pas këtyre observacioneve dhe analizave të bëra mund të thuhet se faktikisht në punimet e kryera në objektin “Mbrotjtja nga Lumi Kalas (Kaskada Shelegar)”, nuk është shkaktuar ndonjë dëm ekonomik për Autoritetin Kontraktor , DUK, Fier.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Lidhur me pretendimin e mbikëqyrësit të punimeve për zërat “Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, në kanale gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë” dhe “Mbushje me gurë masivë t=2 ton/m³ në blloqe, D=0.8-1.2 m. Në derdhje të Kaskadës” se diferenca, dukshëm vijnë nga një mesatarizim jo i saktë i sipërfaqeve të seksioneve tërthor, njeri pas tjetrit. (Shpesh edhe në metodikat apo udhëzimet që përshkruhen edhe në manualët e preventivimit thuhet se, në vlerësimin e punimeve të gërmimit, seksionet tërthor duhet të merren sa më afër njëri tjetrit, për t’ju afruar saktësisë së krejt volumit (i cili mund rezultojë të jetë më i madh ose me i vogël), argumenti mbi diferencën në aspektin teknik qëndron, por në kushtet e auditimit të përputhshmërisë mbi zbatimin e punimeve të kontratës së sipërcituar, si dhe kushteve të kontratës ku volumet e preventivit janë parashikuar me matje faktike të volumeve në fakt dhe jo “lam sum” pra me çelsa në dorë, ky volum konsiderohet i pa justifikuar edhe pse me risk të vogël dhe pa efekte negative në vepër. Do ishte mirë që kushtet e auditimit të përputhshmërisë të citonit metodikat apo udhëzimet që përshkruhen edhe në manualët e preventivimit, dhe këto toleranca duhet të ishin parashikuar në Specifikimet Teknike për PZ për objektin “Mbrotjtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e

Shelegarit) dhe vetëm në këtë rast, audituesi do të merrte në konsideratë observacionin e paraqitur. Sa më sipër trajtuar, argumentet e paraqitura në observacion teknikisht merren në konsideratë, duke përjashtuar nga përgjegjësia mbikëqyrësin e punimeve, për shkak të vlerës së punimeve nën materialitetin e auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Th. S., në cilësinë e Titullarit të DUK Fier.

VI. Kontrata për punë publike me objekt: “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastër”, DUK Fier, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastër”. REF-71883-06-07-2023		
14. Lidhja e kontratës. nr. 144/16-7 prot., datë 03.08.2023 OE “2.” SHPK	15. Vlera e kontratës VI e prev ofertues 47,280,009 lekë me TVSH.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 16,746,360 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 19,257,115 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 11,306,432 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 47,279,907 lekë pa TVSH VI përf e realizuar 47,279,907 lekë me TVSH	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 07.11.2024 Përfundimi punimeve: 13.12.2024	19. Zgjatja e kontratës Afati 5 (pesë) muaj.
20. Mbikëqyrësi i punimeve VOE “V. Dh. & S. SHPK”	Licenca MK.0096/4 & MK.0944	Kontratë me nr. 171/12 prot., datë 24.07.2023
21. Kolaudatori i punimeve PF “N.L.”	Licenca Nr: MK.0642/2	Urdhër 356/11-1 prot., datë 20.12.2024
22. Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me datë 20.12.2024 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “2.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “V. Dh. (PF) & S. SHPK” SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. N. L..	23. Akt i marrjes në dorëzim: -Me me nr. --- prot., datë 20.12.2024 protokolluar në DUK Fier, është mbajtur akt marrje në dorëzim e përkohshme e punimeve të objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “2.” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve BOE “V. Dh. (PF) & S. SHPK” SHPK, kolaudatori i punimeve PF Ing. N. L..	

U konstatuan problematikat si vijon.

Përshkrimi i situatës.

1. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **DUK Fier**, në vlerën **265,584 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera

	Punime ndërtimi vepra arti (Mure gabion)							0
Zëri 1 (3.97/ b)	Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m3, për mbrojtjen	m ³	150	11,589	11,589	10,589	1,000	150,000
Zëri 3(An. 1).	FV Gabion me gurë 2x1.5x1m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø3.2mm)	m ³	4,000	896	896	Realizuar me çmim 3,871 lekë	-	115,584
Totali në lekë pa TVSH								265,584

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve BOE “PF” V. Dh. & OE “S.” SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezat e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

2. Nga Autoriteti Kontraktor DUK Fier për objektin “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastër” u konstatua se, **nuk është kryer oponenca teknike** për projektin e zbatimit me

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6; VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të Përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe Mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të Punimeve”, neni 41, pika 1, germa (c), si dhe VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen

oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”. Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Drejtori (i komanduar) AK DUK Fier Z. E. K..

Për sa është trajtuar në aktin e konstatimit, nga shoqëria mbikëqyrëse “V. Dh. P.F & S. SHPK”, është paraqitur observacion me nr. 201 prot., datë 05.12.2025, si dhe ridërguar përsëri nëpërmjet DUK Fier me nr. 201/24, datë 10.02.2026, protokolluar në KLSH me nr. 201/24, datë 12.02.2026, ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

-Lidhur me zërin e punimeve “Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m³, për mbrojtjen”, ju bëjmë me dije se punimet janë realizuar në përputhje me PZ, preventivin e rishikuar dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK dhe konkretisht:

Ne Azhornimin topografik të profilat gjatesor, në paraqitjen grafike dhe analitike të tij (tabelare) jepen të dhënat :

- Kuotat dhe vija e tokës are (sipas projektit dhe azhornimit topografik).
- Kuotat dhe vija e aksit të piketimit (sipas projektit dhe azhornimit topografik).
- Kuotat dhe vija e tabanit të skolieres (kuote projekti për zërin “Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m³ për mbrojtjen”, sipas projektit dhe azhornimit topografik).
- Kuotat dhe vija e kreut të skolieres (sipas azhornimit topografik).
- Kuotat dhe vija e Kreut të murit gabion (sipas projektit dhe azhornimit topografik).
- Pjerresia e Kreut të murit gabion. (sipas projektit dhe azhornimit topografik).
- Thellesia e gërmimit (për krijimin e trasese së skolieres, sipas azhornimit topografik).

Ne Azhornimin topografik të profilave tërthore, në paraqitjen grafike dhe analitike të tyre (tabelare) jepen të dhënat:

Kuotat dhe vija e tokës are (sipas azhornimit topografik).

- Kuotat dhe vija e Projektit (kreu i përfunduar sipas azhornimit topografik).
- Për çdo pikete është dhënë tabela e zerave dhe volumeve përkatëse të kryera :
 - Sg – Siperfaqja e gërmimit.
 - Smbpas – Siperfaqja e mbushjes pas murit gabion.
 - Smbpaa – Siperfaqja e mbushjes para skolieres.
 - Smbpas – Siperfaqja e mbushjes pas murit gabion.
 - Sgure – Siperfaqja e mbushjes me gure të skolieres.

Kontrolli dhe verifikimi nga ana e jone i sasise së volumeve të zerit të punës “Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m³ për mbrojtjen”, është bërë bazuar në azhornimet topografike, duke verifikuar dhe matur volumet e gërmimit për çdo profil tërthor. Për shkak të konfiguracionit të thyer të seksionit të zerit të punës “Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m³ për mbrojtjen”, matja e siperfaqeve të gërmimit për çdo profil tërthor, është bërë në programin AutoCad.

Bashkangjitur janë Azhornimet topografike të profilat gjatesor e të profilave tërthore.

-Lidhur me zërin e punimeve “FV Gabion me gurë 2x1.5x1m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø 3.2 mm” mbikëqyrësi i punimeve sqaron se:

Nisur nga Akt Konstatimi i paraqitur verejme së audituesi i është referuar analizës së zerit “Gabiona me rrjete teli të zing, gure kave 1x1x1.5m” me nr. An. 3.340 të “Manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tij”, “Manuali nr. 3” miratuar me Vendimin Nr. 629, datë 15.07.2015.

Në fakt, Analiza teknike e zerit të punës, të ofertuar nga Sipermarresi me numur analize “An. 2”, “F+v. gabion me gure, 2x1.5x1.0 m, me rrjete xingato me elektrosaldim Ø 3.2 mm” nuk është e njëjte me atë që Akt Konstatimi i referohet. Projektuesi, në hartimin e preventivit, për këtë zë punë ka hartuar me parë një analizë të vecante çmimi (me volumet dhe çmimet përkatëse) dhe e ka paraqitur në preventive me numur analize “An.2”.

Ø3.2mm)

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbas shqyrtimit me kujdes të observacionit, sqarojmë si vijon:

1. Në takimin me mbikëqyrësin e punimeve janë pranuar problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit. Verejmë se në observacionin e paraqitur, nuk janë dhënë argumente bindëse mbi ndryshimin e sipërfaqeve të seksionit tërthor dhe të kuotave për pikën 1, 2 dhe 9, piketa të cilat









janë pasqyruar për ilustrim për të kuptuar diferencën e sipërfaqeve dhe të volumeve.

Për ilustrim po pasqyrojmë, si vijon:

-Piketa 1 me sip. gjermimi 10.25 m² (projekti fillestar), kuota e tokës 194.04 m dhe kuota projekti 191.05 m, ku ndërkohë në projektin e rishikuar sip. gjermimi jepet 14.57 m² (projekti rishikuar), me kuota e tokës 194.04 m dhe kuota projekti 196.5 m.

-Sqarojmë se referuar PZ fillestar dhe PZ të rishikuar (As Built) në përgjithësi për të gjitha seksionet tërthore të gjermimit për gjatësinë e rrugës 1550 ml, situata është e njëjtë.

Sa më sipër trajtuar, nga sipërmarrësi i punimeve, është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt në vlerën **150,000 lekë pa TVSH** (1,000 m³ x 150 lekë).



Sa më sipër trajtuar, argumentet e paraqitura në observacion nuk merren në konsideratë.

-Lidhur problematikën e konstatuar për zërin e punimeve “FV Gabion me gurë 2x1.5x1m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø 3.2 mm”, në takimin me mbikëqyrësin e punimeve është pranuar problematika e konstatuara nga grupi i auditimit dhe, ndërkohë sqarohet se si zëri me An.3340 i Manualit teknik nr. 629 si dhe zëri “An.2”, “F.V Gabion me gurë 2x1.5x1m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø 3.2 mm” në strukturën e analizës teknikisht është parashikuar vendosja e hekurit Ø 6mm. Nga auditimi se nuk është realizuar nën zëri Aksesorë xingato, lidhjet e përforcimet Ø 6 mm në vlerën 129 lekë (1.7 kg Fe x 76 lekë/kg), për çdo metër kub gabion 2x1.5x1 m, por është realizuar në blloqe mur gabioni. kjo sipas tabelës së mëposhtme. **Sa më sipër trajtuar, argumentet e paraqitura në observacion nuk merren në konsideratë.**

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit të KLSH-së nga shoqëria mbikëqyrëse “V. Dh. P.F & S. SHPK”, është paraqitur observacion me shkresë nr. xxx prot., datë xxxx (Protokolluar në KLSH me nr. xxx prot., datë xxx ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendim i subjektit përmbledhurazi:

Kontrolli i Larte i Shtetit me shkresën nr. 714/7 prot, date 30.01.2026 ka derguar ne Drejtorine e Ujitjes dhe Kullimit, Fier, “Projekt Raportin e Auditimit per Objektivin “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Kepuceve, Gjirokaster”.

Nga shqyrtimi i Projekt Raportit të derguar, konstatojme se Audituesi i Objektivit, pa argumentuar dhe pa kundështuar, nuk ka marrë në konsideratë asnjë nga pretendimet e argumentuara e arsyetuara të Mbikëqyrësit të Punimeve të paraqitura ne Observacionin e dërguar me nr. 201 prot date 05.12.2025.

...Në Projekt Raport, nuk gjejmë asnjë kundërshti, argument apo koment të pretendimeve tona të paraqitura në Observacionin e dërguar nga Mbikëqyrësi i Punimeve me nr. 201 prot., datë 05.12.2025.

...Sa më sipër, efektet e Projekt Raportit të Auditimit për Objektivin “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Kepuceve, Gjirokaster”, dërguar në DUK Fier, nuk duhet të merren në konsideratë pasi janë të pa argumentuara...

1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Lidhur me pretendimin e mbikëqyrësit të punimeve për zërin “Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m3, për mbrojtjen” qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me qëndrimin e shprehur me nr. 201 prot., datë 05.12.2025, duke sqarohet se, diferenca në volum për zërin e sipërcituar është për shkak të mos rakordimit të kuotave të projektit dhe vijës së tokës nga projekti i ndryshuar krafasuar me projektin bazë fillestar, të vënë në dispozicion të grupit të auditimit.

-Lidhur me pretendimin për zërin “FV Gabion me gurë 2x1.5x1m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø 3.2 mm”, sqarohet se në takimin me mbikëqyrësin e punimeve është dakortësuar mbi realizimin ne mospërputhje me specifikimet teknike të pranuar nga OE fitues dhe në deklaratën mbi përmbushjen e tyre. Sa më sipër trajtuar, argumentet e paraqitura në observacion nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit të KLSH-së nga shoqëria mbikëqyrëse “V. Dh. P.F & S. SHPK”, është paraqitur observacion protokolluar në DUK Fier me nr. 201/24 prot., datë 09.02.2026 (protokolluar në KLSH me nr. 714/9 prot., datë 12.02.2026), ku në mënyrë të përmbledhur janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendim i subjektit:

Kontrrolli i Larte i Shtetit me shkresen nr. 714/7 prot, date 30.01.2026 ka derguar ne Drejtorine e Ujitjes dhe Kullimit, Fier, "Projekt Raportin e Auditimit per Objektivin "Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Kepuceve, Gjirokaster".

Nga shqyrtimi i Projekt Raportit të derguar, konstatojme se Audituesi i Objektivit, pa argumentuar dhe pa kundështuar, nuk ka marrë në konsideratë asnjë nga pretendimet e argumentuara e arsyetuara të Mbikqyresit të Punimeve të paraqitura ne Observacionin e dërguar me nr. 201 prot date 05.12.2025.

...Në Projekt Raport, nuk gjejmë asnjë kundërshti, argument apo koment të pretendimeve tona të paraqitura në Observacionin e dërguar nga Mbikëqyrësi i Punimeve me nr. 201 prot., datë 05.12.2025.

...Sa më sipër, efektet e Projekt Raportit të Auditimit për Objektivin "Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Kepuceve, Gjirokaster", dërguar në DUK Fier, nuk duhet të merren në konsiderate pasi janë të pa argumentuara...

1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

-Lidhur me pretendimin e mbikëqyrësit të punimeve si dhe DUK Fier, për zërin "Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m3, për mbrojtjen" qëndrimi i grupit të auditimit është i njëjtë me qëndrimin e shprehur me nr. 201 prot., datë 05.12.2025, duke sqarojmë se, diferenca në volum për zërin e sipërcituar është për shkak të mos rakordimit të kuotave të projektit dhe vijës së tokës nga projekti i ndryshuar krafasuar me projektin bazë fillestar, të vënë në dispozicion të grupit të auditimit.

-Lidhur me pretendimin për zërin "FV Gabion me gurë 2x1.5x1m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø 3.2 mm", sqarojmë se në takimin me mbikëqyrësin e punimeve është dakortësuar mbi realizimin ne mospërputhje me specifikimet teknike të pranuar nga OE fitues dhe në deklaratën mbi përmbushjen e tyre. Sa më sipër trajtuar, argumentet e paraqitura në observacion nuk merren në konsideratë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. E. K.**, në cilësinë e ish Drejtor (i komanduar).

2. **Z. V. Dh. dhe Z. V. A.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:

Nga auditimi i **6 (gjashtë)** kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale **455,176,080.80 lekë me TVSH**, u konstatuan problematikat si vijon:

► Në **5 (raste)** raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **1,161,114 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, **Kreu III, neni 7**, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, **respektivisht:**

- **Vlera 178,200 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Bypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit" me nr. 144/6-11 prot., datë 24.07.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor DUK Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "F." SHPK.

- **Vlera 379,995 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman" me nr. 179/17 prot., datë 16.08.2024 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor "Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit" Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "M." SHPK.

- **Vlera 129,970 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: “Mbrojtja nga lumi i Kalasë- (Kaskada e Vanës)” me nr. 162/15 prot., datë 05.08.2024 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve bashkimit të përkohshëm të shoqërive “S.” SHPK & OE “K.” SHPK.

- **Vlera 207,365 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: “Mbrojtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e Shelegarit)” me nr. 130/16 prot., datë 12.07.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE “N.” SHPK & OE “R.” SHPK.

- **Vlera 265,584 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastër” me nr. 144/16-7 prot., datë 03.08.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë sipërmarrëse “2.” SHPK.

► Në **6 (gjashtë) raste**, nga auditimi i projektit të zbatimit për objektet përkatësisht:

- “Baypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit” me kontratë me nr. 144/6-11 prot., datë 24.07.2023, fituar nga shoqëria “F.” SHPK me vlerë të kontratës 32,249,273 lekë me TVSH,

- “Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman” me kontratë me nr. 179/17 prot., datë 16.08.2024, fituar nga shoqëria “M.” SHPK me vlerë të kontratës 130,407,566 lekë me TVSH,

- “Mbrojtja nga lumi i Kalasë- (Kaskada e Vanës)” me kontratë me nr. 162/15 prot., datë 05.08.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE “S.” SHPK & OE “K.” SHPK, vlerë të objektit 83,899,617.48 lekë me TVSH.

- “Riparimi i Argjinaturës mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint” me kontratë me nr. 210/15 prot., datë 16.08.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve OE “S.” SHPK me vlerë të objektit 103,031,204.22 lekë me TVSH.

- “Mbrojtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e Shelegarit)” me nr. 130/16 prot., datë 12.07.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve bashkimit të përkohshëm të shoqërive “N.” SHPK & OE “R. C.” SHPK me vlerë të objektit 49,308,411.10 lekë me TVSH.

- “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastër” me nr. 144/16-7 prot., datë 03.08.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë sipërmarrëse “2.” SHPK me vlerë të objektit 47,280,009 lekë me TVSH,

u konstatua se: Nga Autoriteti Kontraktor DUK Fier nuk është kryer Oponencë Teknike, veprim ky në mospërputhje me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, me VKM Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

► Në **1 (një) rast**, nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike me objekt “Baypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit”, është lidhur kontrata për kolaudimin e punimeve

me nr. 144/6-24 prot., datë 12.08.2024 ndërmjet DUK Fier, përfaqësuar nga Drejtori z. Th. S. dhe Ing. M. H. dhe Ing. N. L., ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë përfunduar me datë 15.05.2024, pra, kontrata nuk është lidhur brenda 30 ditëve nga njoftimi i përfundimi të punimeve të ndërtimit, por rreth 3 (tre) muaj me vonesë.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, nenet 12 dhe 15.

Në total janë konstatuar 8 raste, pra procedura prokurimi (6 prej të cilave nga auditimi i zbatimit të kontratave të punimeve dhe 2 nga auditimi i procedurës së prokurimit), për projektet e të cilave nuk është kryer oponenta teknike, sipas listës në vijim:

- 1- “Bypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit” me kontratë me nr. 144/6-11 prot., datë 24.07.2023, me vlerë të kontratës 32,249,273 lekë me TVSH;
- 2- “Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman” me kontratë me nr. 179/17 prot., datë 16.08.2024, me vlerë 130,407,566 lekë me TVSH;
- 3- “Mbrojtja nga lumi i Kalasë- (Kaskada e Vanës)” me kontratë me nr. 162/15 prot., datë 05.08.2024, vlerë 83,899,617 lekë me TVSH;
- 4- “Riparimi i Argjinaturës mbrojtëse të Kolektorit K17 Butrint”, me kontratë me nr. 210/15 prot., datë 16.08.2024, vlerë 103,031,204 lekë me TVSH.
- 5- “Mbrojtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e Shelegarit)” me kontratë me nr. 130/16 prot., datë 12.07.2024, vlerë 49,308,411 lekë me TVSH.
- 6- “Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastrë”, me kontratë me nr. 144/16-7 prot., datë 03.08.2023, vlerë 47,280,009 lekë me TVSH;
- 7-“Mbrojtje e kanalit në dalje të hidrovorit Nr 3, Darzezë, Fier”, me kontratë me nr. 185/15 prot, datë 13.08.2024, vlerë 33,470,450 lekë me TVSH.
- 8-“Shkarje në kanal in ujitës VMK 2, me kontratë të lidhur më 06.08.2024, vlerë 45,335,052 me TVSH. *disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, nenet 12 dhe 15.*

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i planeve të punës së veprimtarisë, korrespondencave dhe relacionet e sektorëve me përgjegjës të sektorit teknik dhe drejtorin e Drejtorisë së Kullimit dhe Ujitjes Fier, kërkesat e rregullores së institucionit dhe të Udhëzimit nr. 12, datë 30.12.2019 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”, rezultoi se nuk janë formalizuar në shkresë standarde të aprovuara nga titullari. Planet e punës të paraqitura nga përgjegjësit e sektorëve janë në formate të ndryshme, të dërguara me e-mail, jo të protokolluara dhe në ndonjë rast pa firmën e titullarit. Planet e veprimtimit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve të ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytjet, digave, hidrovorëve dhe makinerisë së rëndë nuk parashikonin qartë punimet, verifikimet dhe grafikun e kryerjes. Informacionet e sektorëve për ndjekjen e punimeve dhe mirëmbajtjeve ishin të përgjithshme, pa specifikime, detaje teknike dhe përpilim të

akteve të kontrollit. Këto parregullsi janë në kundërshtim me Rregulloren nr.397 prot., datë 14.10.2019, të miratuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtori i institucionit të marrë masa për hartimin e dokumenteve standarde në lidhje me veprimtarinë e institucionit. Nga grupet e kontrollit dhe inspektimit në teren mbi gjendjen e objekteve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, të merren masa që të hartohen raporte mbi gjendjen e objekteve nga përmytjet, ku të përshkruhet situata, masat e marra dhe rekomandime për përmirësime të situatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier administron dhe ka të evidentuara në pasqyrat financiare, në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 18 asete, si zyrat, ofiçinat, hidrovorët etj., të cilat nuk janë të pajisura me certifikatë pronësie, pasi për këto pasuri nuk janë marrë masa për regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, duke mos u vërtetuar me dokument pronësie pasuria e institucionit për këtë llogari në emër të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, në kundërshtim me VKM nr. 1108 datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 54-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier dhe Sektori Juridik, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrin masa për regjistrimin në ASHK dhe pajisjen me certifikatë pronësie, hartë treguese, kartelë pasurie, për 18 aseteve të llojit ndërtesa, zyra, ofiçina, hidrovorë etj.

Deri në datën 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në pasqyrat financiare të vitit 2024 ka vlerën 38,730,520 lekë dhe përfshin garancitë e ngurtësuar të punimeve prej 5%, nga të cilat 6,495,372 lekë i takojnë garancive për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve. Subjektet kontraktore nuk kanë bërë kërkesë për vlerën e ngurtësuar. Gjithashtu nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier nuk janë marrë masa për të bërë njoftimin e subjekteve kontraktor për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme prej 106,564 lekë, e cila është e ngurtësuar që nga ish-Bordi i Kullimit Vlorë. Për këtë vlerë Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier nuk disponon informacion për emërtimin e investimit me të cilin lidhen fondet e ngurtësuar, si dhe as të dhëna për subjektet kontraktor, si emri i subjektit, NIPTI, etj., pasi këto vlera janë të mbartura nga pasqyrat financiare të ish-Bordit Vlorë, pa shpjegimet e duhura. Konkretisht të dhëna për subjektet kontraktor dhe 5 investimet për të cilat është ende i ngurtësuar në Thesar fondi 6,495,372 lekë, në llogari të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier janë si vijon:

Subjekti “Sh.” për tre investime si vijon:

-VLF pjesa e II, për vlerën e ngurtësuar prej 3,031,623 lekë;

-Mbrojtje nga Lumi i Kalasës, për vlerën e ngurtësuar prej 2,400,042 lekë;

-Rikonstruksioni i urës Varibob, për vlerën e ngurtësuar prej 2,400,042 lekë.

-Subjekti “K.” për investimin me objekt “Mbrojtje nga lumi Vjosë në Bishan, krahu i majtë bashkia Vlorë”, për vlerën e ngurtësuar 499,807 lekë.

-Subjekti "A." për investimin me objekt "Riparimi i digës Vlashuk (pjesët Elektro-mekanike)", për vlerën e ngurtësuar 511,319 lekë.

Për fondet e ngurtësuar prej 106,564 lekë për garanci punimesh 5%, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier nuk ka të dhëna për emërtimin e investimit, emrin e kontraktorit, etj., pasi këto vlera janë të mbartura nga pasqyrat financiare të ish-Bordit Vlorë, pa shpjegimet e duhura, si dhe nuk ka pasur kërkesa në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Fier nga subjektet përkatëse për ç'ngurtësimin e këtyre fondeve. Veprimet e mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", Kap. III, pikat 30, 50. dhe Ligjin 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, 9, 12.

(*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për njoftimin e kontraktorëve "Sh." SHPK (për 3 objektet ku ka kryer investime), subjektin "K." SHPK dhe "A." SHPK, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të bërë të mundur kthimin e fondeve të garancisë për 5 objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim, në vlerën totale prej 6,495,372 lekë, si vijon:

Subjekti "Sh." SHPK për tre investime si vijon:

-VLF pjesa II, për vlerën e ngurtësuar prej 3,031,623 lekë;

-Mbrojtje nga Lumi i Kalasë, për vlerën e ngurtësuar prej 2,400,042 lekë;

-Rikonstrukcioni i urës Varibob, për vlerën e ngurtësuar prej 2,400,042 lekë.

-Subjekti "K." për investimin me objekt "Mbrojtje nga lumi Vjosë në Bishan, krahu i majtë Bashkia Vlorë", për vlerën e ngurtësuar 499,807 lekë.

-Subjekti "A." për investimin me objekt "Riparimi i digës Vlashuk (pjesët elektro-mekanike)", për vlerën e ngurtësuar 511,319 lekë.

3.2. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa (për aq sa është e mundur), për evidentimin e kontraktorve dhe investimeve për të cilat ekziston e ngurtësuar në thesar vlera 106,564 lekë, e cila është e mbartur nga pasqyrat financiare të ish-Bordit Vlorë dhe nuk ka të dhëna për to. Në vijim bazuar në dokumentacionin e siguruar të përcaktohet destinacioni i vlerës së ngurtësuar prej 106,564 lekë.

Deri në datën 30.09.2026

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditim i pagave të personelit u konstatua se:

-Llogaria 600 "Shpenzime personeli dhe shpërblime", në ditarët e pagave dhe në pasqyrën e performancës financiare ka vlerën 127,349,819 lekë, ndërsa vlera vjetore e kësaj llogarie në sistemin e tatimeve (e-filing) është raportuar në vlerën 125,525,874 lekë, me diferencë midis tyre prej 1,823,945 lekë. Ky fenomen është edhe në llogarinë 601 "Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", e cila në ditarët e pagave dhe pasqyrat financiare ka vlerën 19,349,269 lekë, ndërsa në sistemin e tatimeve (e-filing) është raportuar në vlerën 21,015,389 lekë, me diferencë midis tyre prej 1,666,120 lekë. Mos përputhja midis të dhënave në pasqyrat financiare dhe të dhënave në sistemin e tatimeve (e-filing), vjen për arsye se llogaritja e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në listë pagesat mujore është bërë mbi bazën e pagës reale të punonjësit, e cila është më e vogël se paga minimale e lejuar, ndërsa në sistemin e-filing llogaritja e sigurimeve është bërë e sekt, pra mbi vlerën e pagës minimale të lejuar, e cila ka qenë më e lartë se paga reale e punonjësit. -Për punëmarrësit mbështetës me kontratë me kohë të pjesshme, me kohëzgjatje ditore të punës prej 6 orë, në listë pagesën mujore për efekt të përcaktimit të pagës neto, llogaritjet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nuk janë bërë mbi vlerën e pagës minimale, por mbi pagën bruto 6

orë, vlerë e cila është më e vogël se vlera e pagës minimale, ndërsa në deklarin e sistemit të tatimeve, llogaritjet për efekt të përcaktimit të vlerës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, janë bërë mbi vlerën e pagës minimale (Sipas formularit Esig-25). Kjo ka sjellë që sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguhen në vlerën e saktë, por paga neto e punonjësve të llogaritet më e lartë se paga e duhur. Shuma totale e paguar tepër punonjësve për periudhën janar 2024-qershor 2025, ka vlerën 286,469 lekë. Këto veprime janë në mospërputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 5 dhe 6 të Udhëzimit nr.8 të MFE, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 23 datë 09.12.2014 të MFE “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa që vlerat mujore të llogarisë 600 “Shpenzime personeli dhe shpërblime” dhe llogarisë 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në librat e kontabilitetit dhe në pasqyrat financiare, të jenë të barabarta me vlerën që deklarohet në sistemin e tatimeve (e-filing). Nëpunësi zbatues të marrë masa që të sistemojë pagën neto për punonjësit të cilët e kanë marrë me diferenca të vogla.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, është e mbivlerësuar në vlerën 89,455,493 lekë, llogaria 215 “Mjete transporti”, është mbivlerësuar në vlerën 1,216,118 lekë, pasi për këto llogari janë aplikuar normat e amortizimit 5% në vend të normës 20%.

Për aktivet e llogarisë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, është aplikuar norma e amortizimit 5% duke llogaritur një vlerë amortizimi prej 325,751 lekë, ndërkohë që për këto aktive nuk duhej të llogaritej amortizim dhe duhet të ishte zbatuar procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit. Këto parregullsi janë në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 të MFE “Për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare”, i ndryshuar, si dhe pikën 109 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 të MFE “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 31-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, nëpërmjet korigjimeve të normave të amortizimit të aplikuara gabim në vitet e mëparshme, si dhe në vijim të aplikojë normat e duhura të amortizimit për këto llogari, me qëllim që vlera neto aktiveve në pasqyrat financiare të jetë e saktë. Gjithashtu, për llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” të ndërpritet llogaritja e amortizimit dhe të merren masa për zbatimin e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit, konformë rregullave përkatëse për këtë qëllim.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja e magazinës së materialeve sipas inventarit fizik të bërë në fund të vitit 2024 dhe librave të magazinës, ka vlerën 13,349,029 lekë, por vlera e llogarisë 31 “Materiale”, në pasqyrat financiare ka vlerën 15,349,029 lekë dhe nuk rakordon me vlerën e mësipërme të gjendjes së magazinës, për shkak të regjistrimit të gabuar të vlerës në pasqyrat financiare.

Pra llogaria 31 “Materiale në pasqyrat financiare është mbivlerësuar “në mënyrë të gabuar me vlerën 2,000,000 lekë. Këto parregullsi janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018

të MFE “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 5 dhe 6.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nën punësi zbatues të marrë masa të sistemojë në pasqyrat financiare llogarinë 31 “Materiale”, sipas librave të magazinës dhe gjendjes fizike të materialeve, me qëllim që pasqyrat financiare të pasqyrojnë vlerën e saktë të aktiveve të kësaj llogarie.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2025

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtje e kanalit në dalje të hidrovorit nr. 3, Darzezë, Fier”, zhvilluar në vitin 2024, me fond limit 28,745,937 lekë, u konstatua se në kriteret e veçanta për kualifikim, seksioni i licencave profesionale, për realizimin e punimeve është kërkuar licenca N.P-9-B “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime” dhe licenca N.P-9-B “Punime topogjeodezike”, të cilat i përkasin vlerave të punimeve prej 21 deri në 50 milion lekë, duke u tejkaluar vlera e punimeve që parashikohen në preventiv lidhur me zërat për të cilat janë të nevojshme këto 2 licenca.

E njëjta situatë është konstatuar edhe në procedurën e prokurimit me objekt “Mbrojtja nga lumi i Kalasë (Kaskada e Shelegarit)”, me fond limit 43,300,377 lekë, zhvilluar në vitin 2024, ku janë kërkuar tre licencave të kategorisë B (N.P-9-B “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime”, N.S-9-B “Punime Strukturore speciale”, N.S-18-B “Punime topogjeodezike”, niveli i të cilave tejkalon vlerën reale të punimeve të cilat lidhen me nevojën për këtë lloj licence. Mos përputhja e nivelit të licencave të kërkuara me vlerën e zërave të punimeve në preventiv, është në kundërshtim me nenin 77 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; pikën 4 dhe 6 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; kërkesat e VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja 4.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.a, faqe 55-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Njësia e prokurimit të marrë masa që në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim të dokumenteve të tenderit, seksioni i licencave profesionale për realizimin e punimeve, vendosja e kërkesave për licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, të bëhet në përputhje me vlerën e zërit të punimeve që lidhet drejtpërdrejtë me licencën profesionale të kërkuar, sipas preventivit të punimeve dhe jo mbi bazën e vlerës totale të tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 10 procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, u konstatua se në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për argumentimin e kriterëve të kapacitetit teknik, lidhur me numrin e punonjësve, profesionet përkatëse të tyre, numrin dhe llojin e makinerive, etj., janë dhënë argumentime ligjore, por jo argumentime teknike, duke mos shpjeguar dhe argumentuar teknikisht lidhjen e kriterit të vendosur me zërat përkatës të preventivit, volumin dhe grafikun e punimeve, kapacitetin e mjeteve, etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mos përputhje me nenin 39, 40, 41, 78, pika 2, të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.a, faqe 55-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Njësia e prokurimit të marrë masa të dokumentoj argumentimin teknik të kriterëve të vendosura, për numrin e punonjësve të kërkuar, specialitet e kërkuara, lidhjen e kriterit

me zërin përkatës të preventivit, grafikun dhe volumin e punimeve, kapacitetin mbajtës të mjeteve, etj

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projekteve të zbatimit, në 8 (tetë) raste, me qëllim kontrollin e projektit për përputhshmërinë me detyrën e projektimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet dhe legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, nuk është kryer oponencë teknike, veprim në mospërputhje me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”, nenin 41, pika 1.c, të VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.a & 2.4.c, faqe 55-96 & 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa që për të gjitha projektet e ndërtimit të objekteve publike, të kryej oponencën teknike pranë instituteve shtetërore, ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria përkatëse që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, me qëllim për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi dhe në përputhje me rregullat teknike të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën për punë publike me objekt “Baypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit”, është lidhur kontrata për kolaudimin e punimeve nr. 144/6-24 prot., datë 12.08.2024, rreth 3 (tre) muaj me vonesë, ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë përfunduar më datën 15.05.2024. Pra kontrata nuk është lidhur brenda 30 ditëve nga njoftimi i përfundimi të punimeve, por rreth 3 (tre) muaj me vonesë duke sjellë vonesa në marrjen në dorëzim të investimit nga autoriteti kontraktor, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, nenin 12, pika 4.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.c, faqe 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masa që për çdo kontratë për punë publike, të emërojë kolaudatorin apo grupin e kolaudimit brenda 30 ditëve nga njoftimi i përfundimi të punimeve të ndërtimit, duke vlerësuar kolaudimin e investimit në përputhje me projektin e zbatimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi dhe në përputhje me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “Riparim i argjinaturës së majtë të Lumit Seman” si dhe procedurës “Shkarje në kanal in ujitës VMK-2”, të realizuara në vitin 2024, u konstatuan mangësi si më poshtë:

-Në lidhje me projektin e hartuar, rezulton se nuk ka një akt-marrje në dorëzim të projektit nga një komision, në mënyrë që të verifikohet nëse i përmban të gjithë elementet e nevojshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi. Veprimet e kryera janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, neni 21; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 5, 8, 9, 16, 19, 22.

-Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VMN), rezulton se nuk është hartuar dhe paraqitur raporti paraprak i këtij vlerësimi. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas hartimit të raportit merr vendimin përfundimtar për miratimin e projektit ose vijimin me vlerësimin e thelluar të ndikimit në mjedis. Mangësia e mësipërme është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, neni 7; si dhe VKM-së nr. 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimin të ndikimit në mjedis”, Shtojcës 2 “Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis”.

-Me sugjerim të APP, autoriteti kontraktor ka bërë ndryshime në dokumentet e tenderit në ditën e 8 të afatit të dorëzimit të ofertave, moment i cili përkon me fillimin e gjysmës së dytë të afatit prej 15 ditë të dorëzimit të tyre, por nuk është shtyrë afati i dorëzimit të ofertave me qëllim që operatorëve ekonomikë t’u jepej kohë e mjaftueshme për përgatitjen e tyre, edhe pse ndryshimet kanë përfshirë një numër të konsiderueshëm kriteresh. Mos zgjatja e afatit të dorëzimit të ofertave, ulë kohën në dispozicion të operatorëve ekonomik për ofertim, duke ndikuar kështu edhe në uljen e pjesëmarrjes së tyre, për shkak të mos pasjes së një kohe optimale në dispozicion, dhe është në kundërshtim me nenin 75, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

-Nga shqyrtimi i kriterëve të DT, rezultoi se nuk është kërkuar që për materialet kryesore, përfshirë dherat dhe zërat e tjerë me funksion strukturor ose mbrojtës, të kërkohen specifikime teknike të detajuara, si prova laboratorike paraprake/raporte testimi të kryera sipas standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, përpara hapjes së ofertave/gjatë zhvillimit të procedurës. Gjithashtu dhe gjatë zbatimit të kontratës duhet të ishte përcaktuar frekuenca e testimit apo numri i testeve që duhet të kryhen për materialet e përdorura, si numri i provave për njësi vëllimi, apo numri i provave për një sasi të caktuara materiale, sipas standardeve përkatëse referuese, duke rritur rrezikun që të përdoren materiale që nuk përmbushin standardet e kërkuara, ose që nuk lidhen qartësisht me lotin/serinë e materialit të përdorur. Këto mangësi janë në mos përputhje me nenin 74, nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; neni 39, neni 78, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Në përbërje të njësisë së prokurimit u konstatua mungesa e një specialisti të fushës, e cila ka ndikuar në hartimin jo të saktë të kriterëve dhe ka sjellë nevojën e sugjerimeve të shumta të dërguara nga APP për rishikim të tyre, mangësi në mospërputhje me neni 74, pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.a, faqe 55-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të projekteve, pas përfundimit të punës nga projektuesi, me qëllim vlerësimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së tij, duke siguruar se projekti është i rregullt dhe përmban të gjithë elementët e nevojshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.2. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor në bashkëpunim me sektorin teknik dhe projektuesin, të sigurojë që projekti t’i nënshtrohet procesit të vlerësimin të ndikimit në mjedis (VNM). Raporti paraprak i vlerësimin të ndikimit në mjedis duhet të hartohet dhe të paraqitet pranë

Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në mënyrë që prej saj të mund të merret vendimi përfundimtar për miratimin e projektit, ose dërgimin e tij në procedurë të VNM-së së thelluar.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.3. Rekomandimi: Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit, për çdo ndryshim të kryer në dokumentet e tenderit, veçanërisht në rastet kur ndryshimet realizohen midis gjysmës së parë dhe fillimit të gjysmës së dytë të afatit të dorëzimit të ofertave dhe kur ato përfshijnë ndryshime të rëndësishme të kriterëve, të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave, me qëllim sigurimin e kohës së nevojshme për përgatitjen e ofertave nga ana e OE, si dhe garantimin e një pjesëmarrjeje sa më të gjerë të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.4. Rekomandimi: Njësia e prokurimit të përfshijë në kriteret e dokumenteve të tenderit kërkesën që operatorët ekonomikë të paraqesin prova laboratorike paraprake/raporte testimi në përputhje me specifikime teknike për materialet kryesore të objektit të prokurimit, përpara hapjes së ofertave/gjatë zhvillimit të procedurës, si dhe gjatë fazës së zbatimit të kontratës, duke garantuar verifikimin e cilësisë së materialeve në fazën e ofertave dhe në fazën e zbatimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.5. Rekomandimi: Titullari i AK, të sigurojë përfshirjen e një eksperti të fushës në përbërjen e njësisë së prokurimit, sipas natyrës dhe llojit të procedurës, me qëllim hartimin e saktë të kriterëve teknike të dokumenteve të tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e planifikimit dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të vogla u konstatua se në 2 procedura për shërbimin e internetit ka parregullsi në formulimin e ofertës ekonomike, në afatin e kërkuar për dorëzimin e ofertës, si dhe në përpilimin e termave të pagesës. Në procedurën për riparimin e filtrimeve filluar më datë 04.09.2024, u konstatuan parregullsi në ftesën për ofertë ku mungonin sasitë për të cilat do të ofertohej si sasitë e betonit dhe suvatimit, si dhe në kapacitetet teknike janë kërkuar licenca dhe mjete jo të justifikuara për punët që do të realizoheshin.

Në procedurën për riparime dhe shërbime në hidrovorin e Butrintit, Sarandë, filluar më datë 10.12.2024, në kërkesat teknike për të vërtetuar disponibilitetin e mjeteve si vinça, torno, reparte servisi dhe reparte avolzhimi, është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë fatura tatimore blerje ose kontrata qiraje bashkë me inventarin e konfirmuar nga tatimet ku të figurojnë të gjitha pajisjet. Gjithashtu janë kërkuar nga operatori ekonomik certifikatë për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë BS OHSAS 18001:2015 dhe certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015. Kriete të tilla janë jo thelbësore dhe jo në përpjesëtim me vlerën e kontratës për procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 40, “Kërkesat e veçanta” të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin nr. 710, datë 24.11.2021).

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me pikat 7-9 të Udhëzimit nr. 5, datë 05.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar dhe tregojnë mungesë të njohurive të legjislacionit të prokurimeve nga punonjësit përkatës.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.b, faqe 55-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtori i institucionit të marrë masa për trajnimin e punonjësve lidhur me procedurat e prokurimit publik, për aftësimin e tyre dhe realizimin e procedurave të blerjeve me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e Kontrollit të Lartë të Shtetit, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, nga Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,161,114 lekë pa TVSH**, sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “*Baypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit*” me nr. 144/6-11 prot., datë 24.07.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë “F.” ShPK me vlerë të objektit 32,249,273 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 2 (dy) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve, përkatësisht: [Zëri 2 (3.96/b). Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.25 m³, në kanale me gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë, Zëri 4(3.243/1). Shtresë betoni C16/20, t=15 cm. (Struktura të holla monolite)], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, në vlerën **178,200 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.c, faqe 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa për arkëtimin e vlerës **178,200 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria “F.” ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 144/6-11 prot., datë 24.07.2023 me objekt “*Baypass i hidrovorit Terbuf dhe portobarazhi i Kularit*”.

Deri në datën 31.07.2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “*Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman*” me nr. 179/17 prot., datë 16.08.2024 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë “M.” ShPK me vlerë të objektit 139,407,566 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 4 (katër) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërin e punimeve, [Zëri 5. Gërmim me shkarkim në tokë eks. 0.5 m³, për seksionimin e argjinaturës], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, në vlerën **379,995 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.c, faqe 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa për arkëtimin e vlerës **379,995 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga shoqëria “M.” ShPK për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 179/17 prot., datë 16.08.2024 me objekt “Riparim i argjinaturës së majtë të lumit Seman”.

Deri në datën 31.07.2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “Mbrotjtja nga lumi i Kalasë - (Kaskada e Vanës)” me nr. 162/15 prot., datë 05.08.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE “S.” ShPK & OE “K.” ShPK vlerë të objektit 83,899,617.48 lekë me TVSh dhe afat të realizimit të kontratës 160 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërin e punimeve, [Gabiona me rrjet teli të zinguar e gur kave 1x1x1 m.] me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, në vlerën **129,970 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.c, faqe 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa për arkëtimin e vlerës **129,970 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive “S.” ShPK & OE “K.” ShPK për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 162/15 prot., datë 05.08.2024 me objekt “Mbrotjtja nga lumi i Kalasë - (Kaskada e Vanës)”.

Deri në datën 31.07.2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “Mbrotjtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e Shelegarit)” me nr. 130/16 prot., datë 12.07.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kanalizimit” Fier dhe, sipërmarrësit të punimeve bashkimit të përkohshëm të shoqërive “N.” ShPK & OE “R.” ShPK me vlerë të objektit 49,308,411.10 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 6 (gjashtë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve, përkatësisht: [Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi >2m, prani uji ~2m, kategoria IV, me shk në tokë, Zëri 10(An.01). Mbushje me gurë masivë t=2 ton/m³ në blloqe, D=0.8-1.2 m. Në derdhje të Kaskadës], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, në vlerën **207,365 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.c, faqe 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa për arkëtimin e vlerës **207,365 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht prej bashkimit të përkohshëm të shoqërive “N.” ShPK & OE “R.” ShPK, për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 130/16 prot., datë 12.07.2024 me objekt “Mbrotjtja nga Lumi Kalase-(Kaskada e Shelegarit)”.

Deri në datën 31.07.2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “*Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastër*” me nr. 144/16-7 prot., datë 03.08.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor “Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit” Fier dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë “2.” ShPK, me vlerë të objektit 47,280,009 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 5 (pesë) muaj nga fillimi i punimeve, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve, përkatësisht: [Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 0.25 m3, për mbrojtjen; FV Gabion me gurë 2x1.5x1m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø3.2mm)], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, në vlerën **265,584 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.c, faqe 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa për arkëtimin e vlerës **265,584 lekë pa TVSH**, përfituar padrejtësisht nga shoqëria “2.” ShPK, për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 144/16-7 prot., datë 03.08.2023, me objekt “*Mbrojtja nga Lumi Drinos, Fabrika e Këpucëve, Gjirokastër*”.

Deri në datën 31.07.2026

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “c” dhe “e” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 9 të kontratës individuale të punës, **i rekomandojë** Drejtorit të Ujitjes dhe Kullimit Fier, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. E. K., me detyrë përgjegjësi i Sektorit Teknik Fier;
2. Z. B. K., me detyrë përgjegjësi i Sektorit Hidrovor-Makinerive;
3. Z. F. D., me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Lushnje;
4. Z. V. H., me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Vlorë;
5. Z. O. Sh., me detyrë përgjegjës i Sektorit Teknik Sarandë dhe Gjirokastër, për mangësi në hartimin e planeve të punës, planet e veprimit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve të ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytjet, digave, hidrovoreve dhe makinerisë së rëndë, mangësi në informacionet e sektorëve për ndjekjen e punimeve dhe mirëmbajtjeve, veprime në mos përputhje me kërkesat e Rregulloren e institucionit nr.397 prot., datë 14.10.2019, Udhëzimin nr. 12, datë 30.12.2019 i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “*Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit*”. (*Trajtuar më gjerësisht në pikën 2.2, faqe 13-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
6. Znj. A. N. me detyrë përgjegjës i Sektorit të Financës, për pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare, për llogaritjen e gabuar të pagave për punonjësit me kontratë pune dhe ndalesave në pagë, mos marrjen e masave të plota për likuidimin e kreditorve, në mospërputhje me kërkesat e Ligjit 10296, të MF “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 12, Udhëzimin nr.8 të MFE, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika nr.5, 6, si dhe pikat nr.30, 50 të kapitullit III, Udhëzimin nr. 23 datë 09.12.2014 të MFE “Për

mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar.
(Trajtuar më gjerësisht në pikën 2.3, faqe 19-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHËTETIT